



VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE - FEMICIDI NË SHQIPËRI 2024

Përfshirë vrasjet e mbeturanë tentativë, plagosjet e rënda me dashje dhe shkaktimi i vetëvrasjes



VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE - FEMICIDI NË SHQIPËRI 2024

Përfshirë vrasjet e mbeturanë tentativë, plagosjet
e rënda me dashje dhe shkaktimi i vetëvrasjes

Tiranë, dhjetor 2025

Ky raport u përgatit nga Avokati i Popullit me mbështetjen e UN Women Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, i financuar nga Qeveria së Suedisë.

Autore Znj. Lindita Cakoni

Rishikoi Znj. Agustela Nini-Pavli, eksperte, UN Women
Znj. Vilma Shurdha dhe znj. Brunilda Dervishaj, nga Zyra e Avokatit të Popullit
Znj. Alba Agolli dhe znj. Majlinda Nesturi, nga UN Women

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
HYRJE	15
I. Qëllimi i raportit dhe lidhja me raportin e parë 2021-2023	17
II. Metodologjia, burimet e të dhënave, mbledhja, përpunimi dhe analizimi i tyre	17
KREU I: FEMICIDI DHE DHUNA EKSTREME NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI: FENOMENI, KUADRI LIGJOR DHE JURISPRUDENCA NDËRKOMBËTARE	20
1.1 Pasqyrë e fenomenit të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri	21
1.2 Analizë e kuadrit ligjor mbi veprat penale të vrasjes së grave dhe vajzave (femicidit), vrasjes së mbetur në tentativë, plagosjes së rëndë me dashje dhe shkaktimit të vetëvrasjes	22
1.3 Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi femicidin dhe format e tjera të rënda të dhunës ndaj grave	26
KREU II: VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE/FEMICIDI NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2024 NË NDËRTHURJE ME GJETJET E RAPORTIT TË PARË (2021-2023)	28
2.1 Roli i Avokatit të Popullit në adresimin e nevojave për ndërhyrje në funksion të parandalimit të femicidit dhe dhunës ndaj grave	29
2.2 Përmbledhje mbi rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave dhe femicidit në Shqipëri të ndodhura gjatë vitit 2024	43
2.3 Analizë e rasteve të vrasjes së grave dhe vajzave, të dhëna mbi viktimat, autorët dhe ngjarjet	48
KREU III: RASTET E TENTATIVËS PËR VRASJE, PLAGOSJES SË RËNDË ME DASHJE DHE SHKAKTIMIT TË VETËVRASJES NDAJ GRAVE/VAJZAVE	52
3.1 Analizë e rasteve të vrasjeve të mbetura në tentativë, plagosjeve të rënda me dashje dhe e vetëvrasjes si formë ekstreme e reagimit ndaj dhunës	53
3.2 Analizë e rasteve të shkaktimit të vetëvrasjes në kontekstin e dhunës ndaj grave	57
3.3 Historiku i dhunës ndaj viktimave dhe roli i institucioneve përgjegjëse në mbështetjen e viktimave përpara dhe pas ngjarjes	60

KREU IV: ROLI I BASHKIVE DHE INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE NË TRAJTIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT	61
4.1 Përmbledhje e informacionit të sjellë nga bashkitë mbi trajtimin e rasteve para dhe pas ngjarjes	66
4.2 Roli i institucioneve shëndetësore në identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve	66
4.3 Pasojat e krimeve të rënda ndaj grave dhe vajzave përtej viktimave të drejtpërdrejta	68
KREU V: HETIMI DHE GJYKIMI I KRIMEVE NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE: VRASJET, TENTATIVAT PËR VRASJE, PLAGOSJET E RËNDA DHE SHKAKTIMI I VETËVRASJES	69
5.1 Roli i policisë dhe prokurorisë në hetimin e krimeve ndaj grave dhe vajzave dhe identifikimin e motiveve gjinore	70
5.2 Analiza e vendimeve gjyqësore sipas veprave penale objekt monitorimi	70
5.3 Monitorimi i seancave gjyqësore	73
KREU VI: REKOMANDIME	77
6.1 Rekomandime të tjera në vijim të rekomandimeve të raportit të parë	78
6.2 Rekomandime të përgjithshme	79
6.3 Rekomandime specifike	81
SHTOJCA	85
Raste studimore	86
Intervista me të mbijetuarat dhe familjarët e viktimave	96
LITERATURA	101

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhuna në familje
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEGJFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KLJGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVV	Njësitë e vetëqeverisjes vendore
OJF	Organizata jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
PMF	Punonjësi për mbrojtjen fëmijëve
PP	Prokuroria e Përgjithshme
UM	Urdhër mbrojtjeje
UMM	Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje
UMPMM	Urdhër paraprak i mbrojtjes së menjëhershme
UN WOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport, i përgatitur nga Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të Observatorit për Femicidet, paraqet një analizë të thelluar dhe shumëplanëshe mbi fenomenin e dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri gjatë vitit 2024¹. Ky dokument përbën vijimin e raportit “Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri (2021-2023)”² dhe zgjeron fushën e monitorimit dhe analizës, duke përfshirë, krahas vrasjeve të grave dhe vajzave dhe rasteve të femicidit, edhe forma të tjera të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave, të cilat lidhen drejtpërdrejt me dhunën me bazë gjinore.

Raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi shkallën dhe format e dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave të evidentuara gjatë vitit 2024, të analizojë reagimin institucional ndaj këtyre rasteve, si dhe të identifikojë boshllëqet ekzistuese në kuadrin e mbrojtjes dhe parandalimit. Duke ndërthurur analizën statistikore, shqyrtimin e rasteve konkrete, vlerësimin e ndërhyrjes institucionale, si dhe kontekstin ligjor dhe social, raporti shërben si një instrument i rëndësishëm për adresimin e problematikave të konstatuara dhe për evidentimin e nevojës për ndërhyrje të koordinuara, në funksion të parandalimit të dhunës dhe forcimit të mekanizmave mbështetës për gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna.

OBJEKTI I RAPORTIT Ky raport bazohet në gjetjet e paraqitura në raportin fillestar, duke ndjekur gjithashtu shembujt e disa vendeve evropiane, që kanë ngritur Observatorë për Femicidet, si struktura të posaçme për monitorimin e vrasjeve me bazë gjinore. Në këtë kuadër, vëmendja e raportit aktual shtrihet përtej rasteve të vrasjeve të grave dhe vajzave³, duke përfshirë edhe forma të tjera të dhunës ekstreme ndaj grave.

Për këtë arsye, përveç femicideve të ndodhura gjatë vitit 2024, raporti trajton edhe:

- ⦿ rastet e vrasjeve të mbetura në tentativë,
- ⦿ veprat penale të plagosjes së rëndë me dashje (sipas nenit 88 të Kodit Penal),
- ⦿ rastet e shkakimit të vetëvrasjes (sipas nenit 99 të Kodit Penal).

1. Ngritja e Observatorit për femicidet dhe përgatitja e raporteve periodike u trajtua si rast suksesi në Takimin Global “Mbi matjen e vrasjeve për shkak të gjinisë Femicidit/Feminicidit”. Takimi u zhvillua në korrik 2025 dhe mblodhi përfaqësues nga organizata ndërkombëtare, shtete dhe institucione që kanë një angazhim të drejtpërdrejtë në matjen dhe trajtimin e femicidit dhe dhunës me bazë gjinore.

2. Shih Raportin në <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

3. Analiza e vrasjeve të grave dhe vajzave në Shqipëri dhe identifikimi i rasteve të femicidit kryhet në përputhje me kuadrin statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (që njihet edhe si “femicid/feminicid”), përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women). Dokumenti mund të gjendet në adresën: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical_framework_femicide_2022.pdf

Qëllimi i këtij zgjerimi është të ofrojë një kuptim më të plotë të dukurisë së dhunës ndaj grave, duke mos u ndalur vetëm te rastet më të rënda me pasoja fatale, por duke marrë në shqyrtim edhe format e dhunës që përbëjnë rrezik serioz dhe tregojnë dështime sistematike në parandalim dhe mbrojtje.

METODOLOGJIA DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE bazohet në një qasje të kombinuar, e cila ndërthur burime të të dhënave parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore janë siguruar nëpërmjet komunikimeve zyrtare me institucionet përgjegjëse, përfshirë Policinë e Shtetit, prokuroritë, gjykatat, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet shëndetësore. Po ashtu, janë përfshirë të dhëna të mbledhura nga monitorimi i seancave gjyqësore, analiza e vendimeve gjyqësore dhe shqyrtimi i raportimeve mediatike. Të dhënat dytësore janë marrë nga studime dhe raporte ekzistuese, kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat trajtojnë fenomenin e femicidit dhe dhunës me bazë gjinore në perspektiva të ndryshme analitike dhe kontekstuale.

STRUKTURA Raporti përfshin hyrjen, e cila trajton rëndësinë e analizimit të çështjeve që lidhen me krimet ndaj grave, qëllimin e raportit dhe lidhjen e tij me raportin e mëparshëm 2021-2023, pasqyrën e fenomenit të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri dhe metodologjinë mbi mbledhjen, përpunimi dhe analizimi i të dhënave.

Kreu I: Ky kapitull trajton fenomenin e dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, kuadrin ligjor shqiptar, përfshirë veprat penale të vrasjes së grave dhe vajzave, vrasjes së mbetur në tentativë, plagosjes së rëndë dhe shkaktimit të vetëvrasjes. Kapitulli përfshin jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke evidentuar standardet ndërkombëtare dhe praktikën e drejtësisë europiane në trajtimin e femicidit dhe dhunës ekstreme ndaj grave.

Kreu II paraqet një përmbledhje të rasteve të vrasjeve të grave dhe vajzave, përfshirë ato që përbëjnë femicid, të ndodhura gjatë vitit 2024. Këto të dhëna analizohen në ndërthurje me rastet e trajtuara në raportin e mëparshëm për periudhën 2021-2023, me qëllim ofrimin e një panorame krahasuese dhe vlerësimin e ecurisë së fenomenit. Më tej, kapitulli vijon me analizën e hollësishme të rasteve të vrasjes së grave dhe vajzave, ku përfshihen të dhëna mbi viktimat, autorët dhe rrethanat e ngjarjeve. Një pjesë të rëndësishme në këtë kapitull zë pasqyrimi i rolit të Avokatit të Popullit në adresimin e nevojave për ndërhyrje institucionale, në funksion të parandalimit të femicidit dhe dhunës ndaj grave, bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e raportit të parë.

Kreu III fokusohet në analizën e rasteve të vrasjeve të mbetura në tentativë dhe të plagosjeve të rënda me dashje, të ndodhura gjatë vitit 2024. Ky kapitull paraqet të dhëna mbi viktimat, autorët dhe rrethanat e ngjarjeve, duke përfshirë edhe analizën e historikut të dhunës së ushtruar ndaj viktimave përpara kryerjes së veprës penale.

Po ashtu, trajtohet roli i institucioneve përgjegjëse në mbështetjen e të mbijetuarave, si në fazën paraprake ashtu edhe pas ngjarjes, duke evidentuar praktikën e ndjekura dhe mangësitë e konstatuara në përgjigjen institucionale.

Kreu IV trajton rolin e bashkive dhe institucioneve shëndetësore në përgjigjen ndaj rasteve të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave, duke u ndalur si në ndërhyrjet me karakter parandalues, ashtu edhe në veprimet e ndërmarra pas ngjarjes. Kapitulli përfshin gjithashtu analizën e pasojave të krimeve të rënda përtej viktimave të drejtpërdrejta, duke përfshirë ndikimin afatgjatë të fëmijët, familjarët dhe komuniteti i gjerë.

Kreu V analizon rolin e policisë dhe prokurorisë në hetimin e krimeve ndaj grave dhe vajzave, me fokus në identifikimin e motiveve gjinore që qëndrojnë pas këtyre veprave penale. Kapitulli vijon me shqyrtimin e vendimeve gjyqësore që lidhen me çështjet objekt shqyrtimi. Një vend të veçantë në këtë kapitull zë pasqyrimi i gjetjeve të dala nga monitorimi i seancave gjyqësore, i cili shërben për të vlerësuar qasjen e institucioneve gjyqësore në raport me standardet e duhura për trajtimin e dhunës me bazë gjinore.

Kreu VI paraqet një sërë rekomandimesh të përgjithshme dhe specifike drejtuar institucioneve kryesore përgjegjëse, të cilat fokusohen në dy drejtime kryesore:

- ⊙ Masat për parandalimin e femicidit dhe krimeve të tjera ndaj grave, përmes forcimit të mekanizmave mbrojtës dhe mbështetës, identifikimit në kohë të rasteve që paraqesin rrezik, si dhe reagimit të shpejtë dhe të koordinuar nga strukturat përkatëse.
- ⊙ Masat që duhet të ndërmerren gjatë hetimit dhe gjykimit të krimeve ndaj grave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë analizës së historikut të dhunës ndaj viktimës dhe identifikimit të motiveve të lidhura me gjininë, si dhe përfshirjes së autorëve në programe rehabilitimi gjatë vuajtjes së dënimit.

Në shtojcë janë përfshirë pesë raste studimore që lidhen me veprat penale objekt shqyrtimi në kuadër të këtij raporti. Gjithashtu, janë përfshirë intervista me të mbijetuarat e krimeve dhe familjarët e tyre, të cilat ndihmojnë në pasqyrimin e përvojës njerëzore përtej të dhënave statistikore dhe mbështesin analizën cilësore të raportit.

GJETJET KRYESORE STATISTIKORE TË RAPORTIT⁴:


Në kuadër të këtij raporti **janë shqyrtuar gjithsej 18 raste** të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave të ndodhura gjatë vitit 2024, të cilat përfshijnë 5 vrasje të kryera, 6 raste të vrasjes së mbetur në tentativë, 3 raste të plagosjes së rëndë me dashje dhe 4 raste të shkaktimit të vetëvrasjes.

4. Gjetje mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të përcjella nga Avokati i Popullit në kuadër të raportit të parë, të publikuar për periudhën 2021-2023 si dhe gjetjet që lidhen me rolin dhe reagimin e institucioneve kryesore përgjegjëse dhe organeve proceduese parashtrihen në fund të analizave përkatëse përgjatë raportit.

Nga analiza e rrethanave të kryerjes së veprave penale që lidhen me vrasjen e grave dhe vajzave dhe në përputhje me kuadrin statistikor të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara⁵, rezulton se **tre nga pesë vrasjet e ndodhura klasifikohen si femicide**. Në dy raste gratë janë vrarë nga bashkëshortët e tyre, ndërsa në rastin e tretë, një grua e moshuar është vrarë së bashku me bashkëshortin nga një fqinj i tyre, ky rast kategorizohet si femicid bazuar në rrethanat konkrete dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Dy rastet e mbetura përfshijnë vrasjen e grave nga djemtë e tyre, të cilët sipas të dhënave të raportuara rezultojnë me probleme të shëndetit mendor⁶. Këto ngjarje, ndonëse nuk përfshihen drejtpërdrejt në kategorinë e femicidit sipas përkufizimit standard, mbeten pjesë e analizës së përgjithshme për shkak të lidhjes së tyre me dhunën në marrëdhëniet familjare.

DHUNA EKSTREME NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE 2024



5. Kuadri statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (që njihet edhe si “femicid/feminicid”), përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave. Dokumenti mund të gjendet në adresën: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical_framework_femicide_2022.pdf;


Sipas këtij kuadri femicidi përkufizohet si:

“Vrasje me dashje e grave, e kryer nga partnerë intimë, anëtarë të tjerë të familjes, ose persona të njohur apo të panjohur, bazuar në mënyrën e kryerjes ose në kontekste që tregojnë kryerjen e krimin për motive gjinore”.

6. Problemet e shëndetit mendor të autorëve ishin të dokumentuara nga autoritetet kompetente.

Numri i femicideve ka shënuar një ulje të ndjeshme gjatë vitit 2024, me vetëm tre raste të regjistruara, krahasuar me tetë raste në vitin 2023, pesë raste në vitin 2022 dhe njëmbëdhjetë raste në vitin 2021. Kjo tendencë rënëse përbën një zhvillim pozitiv, megjithatë interpretimi i saj kërkon një analizë të kujdesshme për të evidentuar nëse ka përmirësim në parandalim, ndërgjegjësim dhe reagim institucional.

Në përputhje me këtë rënie, norma e femicidit për vitin 2024 rezulton të jetë 0.25 për 100.000 gra dhe vajza, duke reflektuar një ulje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2023, kur kjo normë ishte 0.84 për 100.000.



Gjatë vitit 2024, u regjistruan **6 raste të vrasjes së grave dhe vajzave të mbetura në tentativë**. Nga këto raste, dy janë kryer nga bashkëshortët e viktimave, një nga ish-i dashuri, një nga babai, një nga një familjar i afërt dhe një nga një person i panjohur për viktimën. Po ashtu, u evidentuan **tre raste të plagosjes së rëndë me dashje**: një rast i kryer nga bashkëshorti i viktimës, një nga djali i saj me probleme të shëndetit mendor dhe një rast i kryer nga dy vajza të njohura nga viktima.

Në lidhje me veprën penale **të shkaktimit të vetëvrasjes**, janë identifikuar **katër raste** në të cilat viktimat kanë humbur jetën dhe autorët janë proceduar penalisht. Në dy raste, autorë të proceduar kanë qenë bashkëshortët e viktimave, ndërsa në një rast, i fejuari i viktimës dhe në një rast tjetër, i dashuri i saj.

Sa i takon vendndodhjes gjeografike të ngjarjeve, rezulton se krimet janë kryer në qytete dhe zona të ndryshme të vendit. **Në 10 nga 18 rastet e trajtuara** në këtë raport (rreth 56%), **krimet janë kryer në zona rurale**.

Kjo analizë nxjerr në pah se femicidet prekin më së shumti zonat rurale, ku është regjistruar shumica e rasteve (56%), duke evidentuar se izolimi gjeografik, qasja më e kufizuar në shërbime mbështetëse dhe mekanizma mbrojtës, si dhe normat tradicionale sociale, mund të rrisin rrezikun e dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave në këto zona.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME MBI RASTET DHE AUTORËT

Në 18 rastet objekt shqyrtimi, janë identifikuar gjithsej **19 autorë** të dyshuar ose të proceduar penalisht, përfshirë si individë të veçuar, ashtu edhe si bashkëautorë në një rast të vetëm.

Të dhënat e paraqitura në kapitujt vijues ofrojnë një pasqyrë të detajuar mbi profilin e viktimave dhe autorëve, historikun e dhunës, motivet e identifikuar, mjetet e përdorura në kryerjen e veprave penale, si dhe ecurinë procedurale të secilit rast. Kjo analizë synon të kontribuojë në kuptimin më të thelluar të dinamikave të dhunës ekstreme me bazë gjinore dhe përgjigjes institucionale përkatëse.

Në **17 raste**, autorë të dyshuar të krimeve ishin burra dhe djem, ndërsa në një rast, bashkëautore ishin dy vajza. Në 9 raste, autorët janë dënuar me vendim nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm. Në dy prej këtyre rasteve, vendimi është ankimuar nga autorët në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në 3 raste, çështjet ndaj autorëve të dyshuar janë ende në shqyrtim gjyqësor, ndërsa 7 raste vijojnë të jenë në fazën e hetimit.

Në 3 raste, autorët u vetëvranë ose humbën jetën menjëherë pas kryerjes së krimit⁷. Në lidhje me masat e sigurisë, në 14 raste autorët u proceduan me masën “arrest në burg”, ndërsa në dy raste u vendos masa “arrest në shtëpi” dhe “detyrim paraqitjeje”.

Sa i përket motiveve të krimeve, rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, dhuna ekstreme ndaj grave dhe vajzave është ushtruar për arsye që lidhen me përpjekjen për të vendosur kontroll mbi viktimën, xhelozinë, mospranimin e ndarjes, si dhe hakmarrjen.

Krimet që përfshijnë vrasjen, tentativën për vrasje dhe plagosjen e rëndë me dashje janë kryer me një shkallë të lartë mizorie, përmes përdorimit të armëve të zjarrit, mjeteve të mprehta, mjeteve të forta, lëndëve djegëse, si dhe përmes dhunës fizike të drejtpërdrejtë.

Në 5 nga 18 rastet objekt shqyrtimi, rezulton se **viktimat kishin kërkuar ndihmë më parë** pranë strukturave të policisë, por institucionet përkatëse kishin dështuar të ndërhyjnë në mënyrë efektive për të parandaluar ngjarjet.

7. Në një rast vrasje, autori u vetëvra menjëherë pas ngjarjes. Në një rast tjetër vrasje, autori humbi jetën si pasojë e dhunës së ushtruar nga i biri ndaj tij në kushtet e tronditjes së fortë psikike. Në rastin e tretë babai qëllon me armë të bijën me qëllimin për ta vranë dhe më pas u vetëvra.

Sa i përket historikut të dhunës ndaj viktimave, nga të dhënat e mbledhura rezulton se në 3 nga 5 rastet e vrasjes së grave, viktimat ishin dhunuar më parë nga autorët e krimit. Në dy rastet e mbetura, mungojnë të dhëna të konfirmuara për dhunë të mëparshme, pasi çështjet vijojnë të jenë ende në fazën hetimore.

Në 4 nga 6 rastet e vrasjeve të mbetura në tentativë, viktimat kishin qenë më parë objekt dhune nga ana e autorëve. Po ashtu, në dy nga tre rastet e plagosjeve të rënda me dashje, viktimat kishin përjetuar më parë dhunë nga autorët e krimit.

Në të 4 rastet e identifikuara si shkaktim i vetëvrasjes, nga të dhënat e mbledhura rezulton se viktimat kishin qenë më parë të dhunuara nga autorët.

Në total, **në 13 nga 18 rastet e shqyrtuara** (rreth **72%**), është konstatuar se viktimat ishin subjekt i dhunës së vazhdueshme nga autorët përpara kryerjes së veprës penale. Gjithashtu, nga analiza rezulton se **7 nga 19 autorët kishin qenë më parë të dënuar** për vepra të ndryshme penale.

Hetimi dhe gjykimi i çështjeve të përfunduara është kryer brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në çështjet e gjykuara me vendim të formës së prerë dënimet e vendosura ndaj autorëve kanë qenë në përputhje me parashikimet e kuadrit penal në fuqi. Megjithatë, përveç aspektit ndëshkues, mbetet e rëndësishme që në vendimet gjyqësore të parashikohet edhe detyrimi për përfshirjen e autorëve në programe rehabilitimi gjatë vuajtjes së dënimit. Këto masa mund të luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e përsëritjes së krimeve dhe në ndryshimin e qëndrimeve e sjelljeve të dhunshme në periudhën afatgjatë.

Nga të dhënat e raportit rezulton se viktimat e krimeve kanë qenë nëna të **33 fëmijëve** në total, ku 9 prej këtyre fëmijëve ishin nën moshën 18 vjeç. Në një rast tragjik, **3 fëmijë** humbën jetën së bashku me nënën e tyre, e cila ndërmori aktin e vetëflijimit në rrethana të rënda psikologjike dhe sociale.

HYRJE

Viti 2024 përbën një periudhë me angazhim të shtuar për institucionin e Avokatit të Popullit, me theks të veçantë në rritjen e transparencës, forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe adresimin e problematikave sociale me ndikim të lartë, në veçanti dhunën me bazë gjinore dhe fenomenin e femicidit⁸.

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje përfaqësojnë disa nga sfidat më të mëdha dhe më komplekse me të cilat përballet shoqëria shqiptare. Vrasjet e grave për shkak të gjinisë, të njohura ndërkombëtarisht si femicide, përbëjnë një formë ekstreme të dhunës sistematike, e rrënjosur thellë në normat kulturore dhe shoqërore. Këto akte nuk përfaqësojnë thjesht veprime kriminale individuale, por reflektojnë pabarazi strukturore gjinore, dështime të vazhdueshme të institucioneve shtetërore dhe një klimë shoqërore të karakterizuar nga indiferenca dhe heshtja kolektive.

Femicidi pasqyron në thelb pabarazitë gjinore strukturore, mangësitë në sistemin institucional për mbrojtjen efektive të viktimave, si dhe shpesh një klimë heshtjeje apo indiference shoqërore përballë dhunës me bazë gjinore.

Femicidi është një çështje sistemike që tejkalon kufijtë kombëtarë dhe prek të gjitha vendet në shkallë të ndryshme⁹. Sondazhi më i fundit i zhvilluar në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, nga Eurostat, Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) dhe Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), tregon se dhuna ndaj grave mbetet një fenomen i përhapur në mënyrë shqetësuese. Sipas të dhënave, mesatarisht një në tre gra kanë përjetuar një formë dhune gjatë jetës së tyre. Në përgjithësi, shkalla e përhapjes rezulton të jetë shumë e ngjashme me atë të matur një dekadë më parë, në sondazhin e parë të këtij lloji¹⁰.

Po ashtu, krimet e tjera të rënda ndaj grave dhe vajzave – të cilat përfaqësojnë forma të përshkallëzuara të dhunës janë tregues se shtetet dhe shoqëritë evropiane vazhdojnë të përballen me sfida serioze në garantimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen efektive të jetës dhe dinjitetit të grave.

Praktika e Shqipërisë për ngritjen dhe funksionimin e Observatorit të Femicidit

8. Shih raportin vjetor të Avokatit të Popullit të vitit 2024, faqe 270, Link: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/raporte-speciale-1/>;

9. Nëpërmjet vendimit të dhënë në prill 2025, mbi çështjen *N.D kundër Zvicrës*, e cila lidhet me detyrën e Zvicrës për të mbrojtur një grua nga tentativa për vrasje dhe tortura nga ish-partneri i saj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka pranuar për herë të parë se femicidi është një çështje sistemike që tejkalon kufijtë dhe prek të gjitha vendet.

10. Shih raportin, i cili mund të aksesohet në: <https://knowledge.unwomen.org/sites/default/files/2025-11/femicides-in-2024-global-estimates-of-intimate-partner-family-member-femicides-en.pdf>, faqe 14.

është trajtuar si një rast studimor¹¹ në raportin e përbashkët të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe UN Women, me titull *“Femicidi në 2024 – Vlerësimet Globale mbi femicidin nga partnerët intimë dhe anëtarët e familjes”*. Të dhënat e raportit tregojnë se, në nivel global, rreth 50,000 gra dhe vajza janë vrarë gjatë vitit 2024 nga partnerët e tyre intimë ose nga anëtarë të tjerë të familjes. Mesatarisht, 137 gra dhe vajza në ditë kanë humbur jetën në mbarë botën nga dora e një partneri ose e një të afërmi të ngushtë¹².

Raporti i dytë, i përgatitur nga Avokati i Popullit në kuadër të Observatorit për Femicidet, ndërtohet mbi përvojën dhe gjetjet e raportit të mëparshëm, duke zgjeruar fushën e monitorimit dhe analizës. Krahas vrasjeve të grave dhe vajzave për shkak të gjinisë, ky raport përfshin edhe forma të tjera të dhunës ekstreme ndaj grave¹³, të cilat shpesh përbëjnë faza pararendëse ose pasoja të drejtpërdrejta të të njëjtit sistem dhune.

Hartimi i këtij raporti vjen si përgjigje ndaj nevojës për një analizë të thelluar, të pavarur dhe të bazuar në të dhëna të dokumentuara mbi mënyrën se si fenomeni i dhunës ekstreme ndaj grave manifestohet dhe adresohet në Shqipëri.

Ky raport synon të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit institucional dhe shoqëror lidhur me përmasat dhe pasojat e dhunës me bazë gjinore, të evidentojë boshllëqet ekzistuese në mekanizmat e mbrojtjes dhe parandalimit, të analizojë praktikatat institucionale në trajtimin e rasteve konkrete dhe të identifikojë sfidat sistematike që pengojnë reagimin efektiv. Njëkohësisht, raporti synon të nxisë zhvillimin e një qasjeje të integruar dhe të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave publike për mbrojtjen e grave dhe vajzave.

Në përputhje me mandatin kushtetues si garant i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Avokati i Popullit e konsideron këtë raport si pjesë integrale të përpjekjeve për të nxitur një reagim të koordinuar, të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës ndaj një fenomeni që kërcënon jo vetëm jetën, por edhe dinjitetin e grave dhe vajzave në Shqipëri.

Përmes këtij raporti synohet jo vetëm dokumentimi sistematik i rasteve të dhunës ekstreme ndaj grave, por edhe forcimi i kulturës së përgjegjshmërisë institucionale dhe i angazhimit publik. Kjo qasje synon të kontribuojë në ndalimin e dhunës me bazë gjinore dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të barabartë dhe më të sigurt për të gjithë qytetarët, pa dallim.

11. Shih raportin, i cili mund të aksesohet në: <https://knowledge.unwomen.org/sites/default/files/2025-11/femicides-in-2024-global-estimates-of-intimate-partner-family-member-femicides-en.pdf>, faqe 14.

12. Shih raportin : <https://knowledge.unwomen.org/sites/default/files/2025-11/femicides-in-2024-global-estimates-of-intimate-partner-family-member-femicides-en.pdf>

13. Vrasjet e mbetura në tentativë, plagosjet e rënda me dashje dhe rastet e vetëvrasjeve.

Raporti është konceptuar si një instrument advokimi dhe reflektimi, që synon të mbështesë zhvillimin e politikave më efektive për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave. Në thelb, ai përfaqëson një thirrje të qartë për veprim të menjëhershëm, të koordinuar dhe të qëndrueshëm në të gjitha nivelet e shtetit dhe shoqërisë, me qëllim garantimin e të drejtës së grave për jetë, siguri dhe dinjitet.

1. QËLLIMI I RAPORTIT DHE LIDHJA ME RAPORTIN E PUBLIKUAR NË VITIN 2024

Qëllimi i raportit është të analizojë dhe të dokumentojë rastet e dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave, përfshirë vrasjet për shkak të gjinisë (femicidet), vrasjet e mbetura në tentativë, plagosjet e rënda me dashje, si dhe rastet e shkaktimit të vetëvrasjes. Përmes kësaj analize, synohet identifikimi i problematikave dhe boshllëqeve në reagimin institucional lidhur me parandalimin e dhunës, femicideve dhe suicideve¹⁴. Raporti synon gjithashtu të ofrojë rekomandime konkrete për forcimin e mekanizmave të parandalimit të krimeve ndaj grave dhe vajzave, si dhe për përmirësimin e përgjigjes institucionale në mbështetje të viktimave dhe familjarëve të tyre.

Lidhja me raportin e publikuar në vitin 2024 – Ky raport përfaqëson vazhdimin e punës analitike të ndërmarrë në raportin e mëparshëm, i cili trajtoi rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave gjatë periudhës 2021–2023. Në vijim të kësaj analize, raporti aktual mbështetet në kuadrin statistikor të Kombeve të Bashkuara dhe ruan koherencën metodologjike me raportin pararendës, duke ofruar një pasqyrë të thelluar mbi ecurinë e fenomenit. Njëkohësisht, ai zgjerohet në trajtimin e formave të tjera të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave, me qëllim pasurimin e kuptimit dhe rritjen e ndikimit në fushën e politikëbërjes dhe advokimit.

2. METODOLOGJIA DHE BURIMET E TË DHËNAVE

Për realizimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna si të natyrës parësore, ashtu edhe dytësore. Të dhënat parësore janë mbledhur nëpërmjet kërkesave zyrtare drejtuar institucioneve përgjegjëse, si dhe përmes monitorimit të drejtpërdrejtë të proceseve gjyqësore që lidhen me rastet e dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave. Nga ana tjetër, të dhënat dytësore janë siguruar përmes analizës së literaturës ekzistuese, duke përfshirë studime të mëparshme mbi femicidin dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri dhe më gjerë.

14. Fjala suicid vjen nga latinishtja: “sui” (vetvetja) + “caedere” (të vrasësh) = të vrasësh veten.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave parësore

Të dhënat parësore u siguruan përmes:

- ⊙ analizimit të materialeve të mbledhura nga strukturat kompetente në rrugë zyrtare,
- ⊙ shqyrtimit të kërkesave për gjykim dhe vendimeve gjyqësore mbi veprat penale që lidhen me vrasjet e grave dhe vajzave, vrasjet e mbetura në tentativë, plagosjet e rënda me dashje si dhe shkaktimin e vetëvrasjes,
- ⊙ monitorimit të seancave gjyqësore për këto çështje,
- ⊙ intervistave, dhe
- ⊙ analizimit të shkrimeve në media.

Mbledhja e të dhënave u realizua falë bashkëpunimit me institucionet kryesore përgjegjëse, si:

- ⊙ strukturat e Policisë së Shtetit,
- ⊙ prokuroritë e rretheve gjyqësore,
- ⊙ gjykatat e rretheve gjyqësore,
- ⊙ institucionet e pushtetit vendor, dhe
- ⊙ institucionet shëndetësore.

Në lidhje me mbledhjen e informacionit, është ndjekur e njëjta praktikë si gjatë përgatitjes së raportit të parë. Për rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, janë kërkuar të njëjtat kategori të dhënash¹⁵ nga institucionet e përmendura më sipër, me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë metodologjike dhe krahasueshmërisë së të dhënave. Ndërkohë, për rastet e tjera që janë përfshirë për herë të parë në këtë raport, si plagosjet e rënda me dashje dhe rastet e shkaktimit të vetëvrasjes, informacioni është kërkuar në përputhje me specifikat dhe karakteristikat konkrete të këtyre ngjarjeve.

Veprat penale objekt monitorimi dhe analizimi

Në këtë raport janë shqyrtuar veprat penale të parashikuara në nenin 76 **“Vrasja me dashje”**, nenin 77 **“Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër”**, nenin 78 **“Vrasja me paramendim”**, nenin 79 **“Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”** dhe nenin 79/c **“Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”**, duke përfshirë edhe rastet e **vrasjeve të mbetura në tentativë si dhe plagosjet e rënda me dashje dhe rastet e shkaktimit të vetëvrasjes**, në të cilat viktimat kanë qenë gra dhe vajza. Të gjitha këto vepra penale hetohen dhe gjykohen në shkallë të parë nga Prokuroritë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Juridiksionit të Përgjithshëm.

15. Shih Raportin në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>, faqe 14.

Shtrirja kohore

Gjurmimi dhe analizimi i rasteve të përfshira në këtë raport është kryer për periudhën janar-dhjetor 2024. Ndërsa monitorimi i seancave gjyqësore është zhvilluar gjatë vitit 2025 dhe ka përfshirë çështjet penale që lidhen me veprat objekt shqyrtimi të raportit, të cilat në atë periudhë ndodheshin në shqyrtim pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Kufizimet e metodologjisë

Bazuar në analizën e informacionit dhe dokumentacionit të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore, në lidhje me rastet e përfshira në këtë raport, Avokati i Popullit ka vijuar komunikimin zyrtar me drejtoritë vendore të policisë dhe me bashkitë ku viktimat kishin vendbanimin. Paralelisht, është kërkuar informacion edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me fokus në rolin e institucioneve shëndetësore në trajtimin e këtyre rasteve. Vlen të theksohet se shumica e institucioneve të kontaktuara kanë shfaqur gatishmëri për bashkëpunim dhe kanë ofruar informacion të dobishëm në lidhje me çështjet që lidhen me femicidin.

Megjithatë, janë evidentuar disa problematika që lidhen me procesin e dhënies së informacionit, si:

- ⦿ vonesa në dërgimin e përgjigjeve,
- ⦿ mosdhënia e informacionit të kërkuar sipas përmbajtjes së kërkesave,
- ⦿ ofrimi i përgjigjeve formale, të cilat nuk mbështeten me informacion të detajuar apo të plotë,
- ⦿ mosrakordimi i informacionit ose informacion i pa saktë,
- ⦿ mungesa e të dhënave të unifikuara.

Në rastet e mosrakordimit të informacionit, është kërkuar informacion shtesë si dhe është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me personat e kontaktit pranë institucioneve përgjegjëse për të siguruar saktësi dhe përpuethshmëri në të dhënat e mbledhura.

KREU I

FEMICIDI DHE DHUNA EKSTREME NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI: FENOMENI, KUADRI LIGJOR DHE JURISPRUDENCA NDËRKOMBËTARE

1.1

Pasqyrë e Fenomenit të Dhunës Ekstreme ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri

“ Çdo akt të dhunës me bazë gjinore që rezulton, ose ka gjasa të rezultojë, në dëm fizik, seksual ose mendor ose në vuajtje për gratë, përfshirë kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private”.

Përkufizimi për dhunën ndaj grave nga Kombet e Bashkuara

“Dhuna ekstreme” ndaj grave i referohet formave më të rënda të dhunës me bazë gjinore që sjell pasoja të rënda që shkojnë deri te humbja e jetës. Sipas të dhënave të publikuara nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, Shqipëria po përballet me një rritje të rasteve të dhunës ekstreme ndaj grave, veçanërisht në kontekstin familjar dhe të marrëdhënieve intime. Bazuar në raportin e parë “Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri 2021-2023”¹⁶, rezulton se gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithsej 13 viktima gra dhe vajza, nga të cilat 11 janë vrarë nga bashkëshortët, ish-bashkëshortët, partnerët apo anëtarë të familjes. Ndërkohë, sipas të dhënave të mbledhura për vitin 2024, janë evidentuar 5 raste të vrasjes së grave¹⁷.

Bazuar në studime të ndryshme të kryera mbi dhunën ndaj grave në Shqipëri¹⁸, rezulton se shkaqet kryesore të kësaj dhune lidhen me disa faktorë kryesorë të cilët lidhen kryesisht me patriarkalizmin dhe normat tradicionale gjinore dhe varësinë ekonomike të grave, që u vështirëson atyre largimin nga marrëdhëniet abuzive. Gjithashtu, identifikohen masat joefikase për parandalimin e dhunës dhe ndëshkimin e autorëve, niveli i ulët i ndërgjegjësimit publik, si dhe faktorë shtesë si përdorimi i alkoolit dhe substancave narkotike. Megjithëse Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor për mbrojtjen dhe mbështetjen e grave dhe vajzave ndaj dhunës, zbatimi i këtij kuadri në praktikë vijon të paraqesë vështirësi, për shkak të një sërë sfidash strukturore dhe institucionale, të cilat do të analizohen më në hollësi në vijim të këtij raporti.

16. Shih Raportin në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

17. Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, të vitit 2024, shkalla e lartë e vazhdueshme e vrasjeve të grave për frymë mbetet një shqetësim serioz. Raporti evidenton punën e Avokatit të Popullit në monitorimin dhe raportimin e rasteve të femicidit nëpërmjet Observatorit për Femicidet. Raporti mund të aksesohet në: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf;

18. Shih: “Vrojtim Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri” INSTAT (2018), Raport i Avokatit të Popullit mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020-shtator 2021.

1.2

Analizë e kuadrit ligjor mbi veprat penale të vrasjes së grave dhe vajzave (femicidit), vrasjes së mbetur në tentativë, plagosjes së rëndë me dashje dhe shkaktimit të vetëvrasjes

1. VRASJA E GRAVE DHE VAJZAVE (FEMICIDI)

Gjatë viteve të fundit, legjislacioni penal shqiptar është përafëruar me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë dispozita që synojnë të garantojnë mbrojtje të veçantë për gratë, vajzat dhe të miturit. Megjithatë, femicidi nuk është ende i njohur si vepër penale e veçantë në Kodin Penal, dhe vrasjet e grave dhe vajzave trajtohen në kuadrin e përgjithshëm të veprave penale kundër jetës¹⁹. Ky element gjinor pasqyrohet vetëm në mënyrë të tërthortë në nenin 50 të Kodit Penal, i cili parashikon motivimin për shkak të gjinisë apo marrëdhënieve familjare si rrethanë rënduese²⁰.

Megjithëse kuadri ligjor aktual përfshin elementë të rëndësishëm të harmonizuar me standardet ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, mungesa e njohjes së femicidit si një vepër penale e veçantë vijon të kufizojë identifikimin, analizën dhe parandalimin efektiv të këtij fenomeni në Shqipëri. Në projekt-Kodin e ri Penal, i cili ndodhet në fazë shqyrtimi, vrasja e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë është parashikuar si një nga format e vrasjeve të kryera në rrethana cilësuese²¹, duke përbërë një hap të rëndësishëm drejt adresimit më të plotë të motivimit gjinor si element penalisht i rëndësishëm.

Në praktikën legjislative evropiane, vetëm një numër i kufizuar shtetesh e kanë sanksionuar femicidin si vepër penale më vete²². Së fundmi, në nëntor 2025, parlamenti italian miratoi një ligj për njohjen e femicidit si një kategori penale më vete, duke e institucionalizuar në mënyrë eksplicite këtë formë të dhunës me bazë gjinore²³.

19. Nenet 76, 77, 78, 79 dhe 79/c të Kodit Penal.

20. Informacion më i detajuar sa i përket legjislacionit penal mbi vrasjen e grave dhe vajzave në Shqipëri është përfshirë në raportin e parë mbi vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidin në Shqipëri 2021-2023, faqe 18.

21. Aktualisht është në proces hartimi i Kodit të ri Penal si dhe i një ligji gjithëpërfshirës për të trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë dhe dhunën të lehtësuar nga teknologjia.

22. Shih raportin mbi vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidin në Shqipëri 2021-2023, faqe 18.

23. Kjo dispozitë parashikon: “Kushdo që shkakton vdekjen e një gruaje, kur akti është kryer si akt urrejtjeje, diskriminimi, nënshtrimi, ose si akt kontrolli, posesioni ose dominimi sepse ajo është grua, ose në lidhje me refuzimin e saj për të krijuar apo ruajtur një marrëdhënie emocionale, ose si akt i synuar për të kufizuar liritë e saj individuale, dënohet me burgim të përjetshëm.”

2. VRASJA E MBETUR NË TENTATIVË

Sipas nenit 22 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, tentativa për të kryer një vepër penale përbën krim nëse vepra për të cilën bëhet tentativa është e dënueshme me ligj²⁴. Në rastin e vrasjeve të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 79 dhe 79/c, të cilat janë objekt shqyrtimi kur këto vepra mbeten në fazën e tentativës, autori përgjigjet penalisht sipas nenit 22 të Kodit Penal²⁵. *Në rastin e tentativës, gjykata cakton një dënim më të ulët se ai që parashikohet për veprën e kryer, por jo më pak se një e treta e minimumit të parashikuar nga ligji për veprën e kryer.*

Në shumë raste të dhunës ndaj grave, tentativa për vrasje është rezultat i një marrëdhënieje të mëparshme abuzive dhe lidhet ngushtësisht me faktorë si kontrolli i dhunshëm, xhelozia, ndarja apo kërkesa për divorc e iniciuar nga viktimja. Këto rrethana nënvizojnë nevojën për një analizë të thelluar të motiveve me bazë gjinore gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit të këtyre veprave penale.

3. PLAGOSJA E RËNDË ME DASHJE

Neni 88 i Kodit Penal rregullon veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, e cila konsiston në shkaktimin e dëmtimeve serioze që cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin fizik ose rrezikojnë jetën e viktimës. Parashikimi ligjor sipas nenit 88 të Kodit Penal është si më poshtë:

“Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur është kryer kundër disa personave, kundër personit që është bashkëshort, ish -bashkëshort, bashkëjetues apo ish -bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Kur plagosja kryhet në rrethana më të rënda, ajo dënohet më ashpër. Këto rrethana janë:

1. Kur kryhet kundër disa personave.
2. Kur kryhet ndaj një personi me lidhje të ngushtë personale:
 - ⊙ Bashkëshort/i ose ish-bashkëshort/i,
 - ⊙ Bashkëjetues/e ose ish-bashkëjetues/e,
 - ⊙ Gjini e afërt (fëmijë, prindër, vëllezër, motra),
 - ⊙ Krushqi e afërt (vjuhërr, kunatë, etj.).

24. “Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij”.

25. Nenin 76 “Vrasja me dashje”, nenin 77 “Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër”, nenin 78 “Vrasja me paramendim”, nenin 79 “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe neni 79/c “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”.

3. Kur sjell si pasojë vdekjen - edhe pse qëllimi nuk ka qenë vrasja, dëmtimi ka përfunduar me humbje jete.

Paragrafi i dytë i nenit 88 synon të theksojë rrezikshmërinë e shtuar të veprës penale kur ajo kryhet në kontekstin e marrëdhënieve familjare, ndaj më shumë personave, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen. Qëllimi i këtij parashikimi është të forcojë mbrojtjen për viktimat e dhunës në familje dhe në marrëdhënie të ngushta afërsie, duke i veçuar këto raste si më të rënda në krahasim me plagosjet e zakonshme.

4. SHKAKTIMI I VETËVRASJES

Neni 99 i Kodit Penal parashikon përgjegjësi penale për çdo person që, përmes veprimeve të paligjshme, nxit ose shtyn një tjetër drejt vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje. Qëllimi i kësaj dispozite është të sanksionojë dhe të dënojë shkaktimin e vetëvrasjes ose tentativës së saj si pasojë e keqtrajtimit që ka ndikuar në cenimin e rëndë të dinjitetit e personit, veçanërisht kur kryhet në rrethanat e varësisë, lidhjeve familjare ose intime.

Parashikimi ligjor sipas nenit 99 të Kodit Penal është si më poshtë:

“Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në varësi apo nga personi me të cilin ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Ky nen mbron:

- ⊙ Jetën dhe integritetin psikologjik të individit;
- ⊙ Dinjitetin njerëzor, sidomos brenda marrëdhënieve të varësisë apo atyre familjare;
- ⊙ Lirinë për të jetuar, në mënyrë të pavarur nga presionet, poshtërimet apo trajtimet që çenojnë mirëqënien e individit.

Subjekti i veprës:

- ⊙ Autori është personi që ka një raport varësie me viktimën (p.sh. punëdhënës ndaj punëmarrësit, mësues ndaj nxënësit, kujdestar ndaj të miturit, etj.), ose
- ⊙ Personi me të cilin viktimë ka marrëdhënie familjare apo bashkëjetese, si bashkëshorti/ja, partneri/ja, ish-bashkëshorti/ja etj.
- ⊙ Kjo rrethanë e veçantë i jep veprës një dimension të dhunës strukturore dhe me ndikim të zgjatur psikologjik.

Sjellja penalisht e dënueshme:

- ⊙ Trajtim i keq sistematik, që mund të përfshijë:
 - Dhunë psikologjike të përsëritur,
 - Izolim social,
 - Kontroll abuziv,
 - Poshtërim publik apo privat.
- ⊙ Sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, si:
 - Fyerje të vazhdueshme,
 - Ulje e vlerësimit të vetes,
 - Përçmim i vazhdueshëm në mjedisin familjar apo profesional.

Pasojat:

- ⊙ Shkaktimi i vetëvrasjes, pra vdekja e viktimës ka ardhur si pasojë e veprimeve të autorit;
- ⊙ Ose tentativa e vetëvrasjes, pra një akt i ndërmarrë nga viktimja që synon vdekjen por që nuk realizohet plotësisht (p.sh. ndërhyrja e një personi tjetër, dështimi i mjetit të përdorur, etj.).

Dënimi:

Parashikohet një dënim me burgim nga 3 deri në 7 vjet, që është relativisht i lartë për një vepër që, në thelb, synon të përshkruajë ndikimin psikologjik dhe moral të dhunës së padukshme por sistematike.

Ky nen është thelbësor për rastet ku vetëvrasja e grave është pasojë e dhunës psikologjike dhe poshtërimit të vazhdueshëm në marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës.

Në praktikë, shumë gra i japin fund jetës pas një periudhe të gjatë:

- ⊙ Dhunë psikologjike,
- ⊙ Kërcënimesh,
- ⊙ Izolimi nga familja dhe miqtë,
- ⊙ Mungese mbështetjeje institucionale.

Ky nen aplikohet rrallë në praktikë, për shkak të:

- ⊙ Vështirësive në provimin e lidhjes shkakësore midis sjelljes së autorit dhe vetëvrasjes,
- ⊙ Mungesës së kapaciteteve për të dokumentuar dhunën sistematike psikologjike,
- ⊙ Paaftësisë së sistemit të drejtësisë për të hetuar rastet e vetëvrasjes si rezultat i dhunës me bazë gjinore.

1.3

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi femicidin dhe format e tjera të rënda të dhunës ndaj grave

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka zhvilluar një jurisprudencë të konsoliduar, e cila lidh rastet e femicidit dhe dhunës ndaj grave me shkelje serioze të të drejtave themelore të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht nenet 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), dhe 14 (ndalimi i diskriminimit). Kjo jurisprudencë mbështetet në parimin e përgjegjësisë pozitive të shteteve për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar aktet e dhunës, si dhe për të garantuar mbrojtje efektive dhe mbështetje për viktimat.

GJEDNJ ka dhënë një sërë vendimesh të rëndësishme në çështje që lidhen me vrasjen e grave (femicidin) dhe dhunën me bazë gjinore. Megjithëse termi “femicid” nuk është gjithmonë i përfshirë formalisht në tekstin e vendimeve, përmbajtja e shumë prej tyre ka në thelb vrasjen e grave nga partnerë apo ish-partnerë, shpesh pas një historie të gjatë dhune, të cilën autoritetet shtetërore nuk kanë arritur ta parandalojnë.

Në çështjen *De Giorgi v. Italy (1998)*²⁶, një ngjarje me dhunë të përsëritur, që përfundoi në vrasje, viktimat kishin paraqitur ankesa të shumta për dhunë, por autoritetet italiane nuk e ndaluan autorin. Ai e vrau atë më pas. GJEDNJ vlerësoi që autoritetet kishin informacion dhe duhej të vepronin.

Jurisprudenca e mëvonshme e Gjykatës thekson detyrimet pozitive të shteteve për të parandaluar dhunën, duke zbatuar të ashtuquajturin “testi Osman”. Ky test është zhvilluar në çështjen *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*²⁷ (1998) dhe përcakton se autoritetet kanë detyrimin të ndër marrin masa operative parandaluese kur ato e dinë ose duhet të dinë për ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm ndaj jetës ose integritetit fizik të një personi, që buron nga veprimet e një personi tjetër. Kjo qasje është përshtatur dhe aplikuar në rastet e dhunës së përsëritur në marrëdhëniet familjare ose intime, duke e vendosur theksin tek nevoja për një reagim proaktiv të institucioneve shtetërore, në përputhje me detyrimet që burojnë nga neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për jetën).

Çështja Opuz kundër Turqisë (2009)²⁸ është një ndër rastet më të njohura dhe themelore në jurisprudencën e GJEDNJ lidhur me femicidin. Në këtë vendim, Gjykata

26. GJEDNJ 1998 [https://hudoc.echr.coe.int/tkp197/vieë.asp#{%22fulltext%22:\[%22De%20Giorgi%20v.%20Italy%22\],%22itemid%22:\[%22001-4346%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/tkp197/vieë.asp#{%22fulltext%22:[%22De%20Giorgi%20v.%20Italy%22],%22itemid%22:[%22001-4346%22]})

27. Vendimi i plotë gjendet në: [https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:\[%22Osman%20v.%20United%20Kingdom%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:[%22Osman%20v.%20United%20Kingdom%22]})

28. GJEDNJ (2009), Opuz kundër Turqisë, Vendimi: <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-92945>

konstatoi se dhuna e përsëritur nga bashkëshorti, e cila përfundoi me vrasjen e nënës së paditëses, përbënte shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën), nenit 3 (ndalimi i trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese), dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky ishte vendimi i parë në të cilin Gjykata e njohu dhunën në familje si një formë diskriminimi gjinor, duke vendosur një precedent të rëndësishëm për trajtimin e dhunës me bazë gjinore në të drejtën evropiane.

Në vendimin e saj të prillit 2025 në çështjen **N.D. kundër Zvicrës**²⁹, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pranoi për herë të parë në mënyrë eksplicite se femicidi përbën një problem sistemik, i cili tejkalon kufijtë kombëtarë dhe prek të gjitha shoqëritë. Rasti kishte të bënte me dështimin e autoriteteve zvicerane për të mbrojtur një grua nga tentativa për vrasje dhe trajtim çnjerëzor nga ish-partneri i saj, i cili më parë ishte dënuar për vrasje dhe përdhunim. Paditësja nuk ishte informuar për historikun kriminal të tij, dhe autoritetet nuk kryen një vlerësim të duhur të rrezikut, as nuk ndërmoren masa parandaluese adekuate. GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 2 të Konventës (e drejta për jetën), duke vlerësuar se shteti nuk kishte përmbushur detyrimin pozitiv për të mbrojtur jetën e individit ndaj një rreziku të njohur dhe të menjëhershëm. Autoritetet nuk kishin përdorur instrumentet ligjore të disponueshme për të parandaluar veprimin e dhunshëm, pavarësisht rrethanave që nënvizonin rrezikun real ndaj jetës së viktimës.

Kjo çështje u mbështet në një linjë tashmë të konsoliduar të jurisprudencës së GJEDNJ mbi dhunën në familje, veçanërisht në çështjen historike **Kurt kundër Austrisë**³⁰, ku Gjykata theksoi se autoritetet shtetërore kanë detyrimin të kryejnë një vlerësim të rrezikut që të jetë autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës (paragrafi 186). Më tej, kjo çështje vendosi edhe standardin e kujdesit të veçantë (special diligence) në rastet ku fëmijët janë të përfshirë në situata dhune familjare, duke kërkuar nga autoritetet nivel më të lartë përgjegjshmërie dhe vëmendjeje. Vendimi *N.D. kundër Zvicrës* jo vetëm që e konfirmon këtë linjë jurisprudence, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e mëtejshëm të jurisprudencës së Gjykatës lidhur me **femicidin** si fenomen me natyrë sistematike dhe dimension gjinor. Efekti praktik i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e legjislacionit dhe praktikës kombëtare, sidomos në çështjet që prekin të drejtat themelore, përfshirë dhunën ndaj grave, diskriminimin gjinor dhe femicidin.

Vendimet e GJEDNJ jo vetëm që përcaktojnë standarde minimale detyruese për shtetet anëtare, por gjithashtu nxisin përmirësime konkrete në legjislacion dhe në mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e viktimave. Nëpërmjet jurisprudencës së saj, GJEDNJ ka vendosur precedentë që detyrojnë shtetet të ndërmarrin masa efektive për parandalimin e vrasjeve të grave dhe për garantimin e mbrojtjes së tyre.

29. GJEDNJ (2025), N.D kundër Zvicrës, Vendimi: <https://hudoc.echr.coe.int/tkp197/viewasp#%7B%22fulltext%22:%5B%22N.D.%20v.%20S%26eitzerland.%22%5D,%22itemid%22:%5B%222002-14450%22%5D%7D>

30. GJEDNJ (2015), Kurt kundër Austrisë, Vendimi: <https://hudoc.echr.coe.int/tkp197/vieë.asp?i=001-184709>

KREU II

VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE/FEMICIDI NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2024

2.1

Roli i Avokatit të Popullit në adresimin e nevojave për ndërhyrje në funksion të parandalimit të femicidit dhe dhunës ndaj grave

Në përmbushje të misionit të tij kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka luajtur një rol thelbësor në monitorimin, evidentimin dhe adresimin e problematikave që lidhen me dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje dhe fenomenin e femicidit në Shqipëri. Me një fokus të veçantë në forcimin e mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave, institucioni ka theksuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërinstitutional, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe zhvillimit të një qasjeje të koordinuar dhe të ndjeshme gjinore në mbështetje të viktimave.

Bazuar në gjetjet e raportit të parë “Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri (2021–2023)”, Avokati i Popullit ka adresuar një sërë rekomandimesh ndaj institucioneve kryesore përgjegjëse përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe të gjitha bashkitë e vendit, me qëllim përmirësimin e përgjigjes institucionale dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës ndaj dhunës dhe femicidit.

Institucioni vlerëson faktin që rekomandimet janë pranuar nga shumica e autoriteteve përkatëse, të cilat kanë raportuar mbi masat e ndërmarra në planin afatshkurtër dhe afatgjatë për zbatimin e tyre. Analiza në vijim përfshin vlerësimin e përgjigjeve të marra, duke analizuar nivelin e zbatueshmërisë, mangësitë e evidentuara, si dhe hapat e mëtejshëm të nevojshëm për forcimin e reagimit shtetëror ndaj dhunës me bazë gjinore.

Kjo qasje synon të rrisë ndërgjegjësimin institucional dhe publik, si dhe të nxisë reflektim dhe veprim të mëtejshëm në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave. Në funksion të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, Avokati i Popullit ka zhvilluar takime me përfaqësues të secilit prej institucioneve të adresuara, për të mbështetur përpjekjet drejt një zbatimi më të plotë dhe efektiv të tyre.

MBI REKOMANDIMIN E ADRESUAR PËR MSHMS³¹

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përfaqëson institucionin përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e politikave kombëtare në fushën e parandalimit dhe trajtimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ajo luan një rol kyç në hartimin e strategjive afatgjata, programeve të posaçme dhe akteve nënligjore që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes së viktimave, si dhe në rritjen e kapaciteteve institucionale për adresimin efektiv të rasteve të dhunës.

Në raportin e parë u evidentuan disa problematika që lidhen kryesisht me mungesën e kapaciteteve të nevojshme, si në aspektin e burimeve njerëzore të trajnuara, ashtu edhe në infrastrukturën e specializuar. Po ashtu, u konstatua mungesë financimi të qëndrueshëm për qendrat strehimore dhe programet rehabilituese, si dhe nevoja për përmirësim të vazhdueshëm të koordinimit ndërinstitutional. Të gjitha këto sfida ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mbrojtjes dhe mbështetjes që u ofrohet viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në këtë kuadër, në muajin qershor 2025, Avokati i Popullit i drejtoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rekomandimin: *“Për marrjen e masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,³² në drejtim të trajtimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përfshirë femicidin”*.

Në përgjigjen e përcjellë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është paraqitur informacion lidhur me secilën prej çështjeve të adresuara nëpërmjet këtij rekomandimi:

- 1. Rritja e efektivitetit të funksionimit të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) në të gjitha bashkitë e vendit** - MSHMS përmes Drejtorisë së Barazisë Gjinore³³, ka ndërmarrë masa për konsolidimin dhe forcimin e vëmendjes institucionale ndaj çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, raportohet se në bashkëpunim me UNDP janë zhvilluar një sërë trajnimesh me anëtarët e MKR-ve dhe në mënyrë të veçantë me koordinatorët vendorë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- 2. Zhvillimi i trajnimeve dhe mbikëqyrjen e sektorit të shëndetësisë** - MSHMS raporton se ka nisur një cikël trajnimesh me sektorin e shëndetësisë me mjekë dhe infermierë si dhe me psikologë e punonjës socialë me qëllim rritjen e rolit të profesionistëve në trajtimin dhe referimin e rasteve.

31. Rekomandimi i plotë mund të aksesohet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/e-drejta-e-grave/rekomandime-n-kuadr-t-observatorit-mbi-femicidet-1138/>

32. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndryshoi emërtimin në Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pas riformatimit të Qeverisë si rezultat i zgjedhjeve parlamentare 2025.

33. Krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.205, datë 23.10.2024.

Pavarësisht zhvillimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të sektorit shëndetësor, Avokati i Popullit vlerëson se ndërhyrjet për forcimin e rolit të profesionistëve të shëndetësisë në trajtimin e dhunës me bazë gjinore duhet të ndërmerren në disa nivele.

Së pari është e nevojshme që në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi të nxiten mekanizmat që lidhen me: a) standardizimin e procedurave të ndërhyrjes nga ana e institucioneve shëndetësore në rastet e dyshuara apo të konfirmuara të dhunës dhe b) hartimin e udhëzuesve të brendshëm për raportim, dokumentim, mbrojtjen e viktimës dhe referimin tek institucionet përkatëse si policia, qendrat e mbrojtjes sociale etj.

Së dyti, të sigurohet që rastet të mos mbeten të pa raportuara dhe viktimat të mos përjetojnë riviktimizim gjatë ndërveprimit me sistemin shëndetësor. Institucionet shëndetësore kanë një rol kyç në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, duke qenë shpesh pika e parë ku viktimat kërkojnë ndihmë. Për këtë arsye, ato duhet të garantojnë që asnjë rast i dyshuar apo i evidentuar të mos mbetet i paraportuar, duke ndjekur me rigorozitet protokollet e referimit dhe mekanizmat ndërinstytucionalë të mbrojtjes. Po aq e rëndësishme është që institucionet shëndetësore të veprojnë në mënyrë që viktimat të mos përjetojnë riviktimizim gjatë marrjes së shërbimit, kjo nënkupton një qasje të ndjeshme ndaj traumës, respektimin e privatësisë, shmangien e pyetjeve apo procedurave të panevojshme dhe sigurimin e mbështetjes psikologjike dhe emocionale.

Së treti, duhet intensifikuar puna për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me rolin e institucioneve shëndetësore në identifikimin dhe menaxhimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, për të nxitur raportimin dhe ndërtuar besim tek këto struktura. Në këtë kuadër, për rritjen e rolit të institucioneve shëndetësore në trajtimin e dhunës në familje, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e brendshme, të përmirësohet bashkëpunimi ndërsektorial dhe të zhvillohet një qasje e sistematizuar, e koordinuar dhe e orientuar drejt mbrojtjes së dinjitetit dhe të drejtave të viktimave.

3. Organizimi vazhdueshëm i fushatave ndërgjegjësuere - MSHMS ka raportuar mbi organizimin e një sërë fushatash ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës, organizatat ndërkombëtare si UN Women dhe UNDP, si dhe organizatat vendase. Këto aktivitete zhvillohen kryesisht në kuadër të fushatës globale “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave”, me rastin e 8 Marsit, si dhe në data të tjera simbolike.

Fushatat ndërgjegjësuere përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm në parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, pasi synojnë informimin e publikut, dhe nxitjen e reagimit shoqëror ndaj dhunës me bazë gjinore. Përmes mesazheve të strukturuar dhe aktiviteteve të fokusuara, ato kontribuojnë në rritjen e njohurive mbi format e dhunës, mekanizmat ligjorë të mbrojtjes dhe shërbimet në dispozicion të viktimave

4. **Rritja e financimit të projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social** - MSHMS raporton se vitet e fundit ka financuar ngritjen e katër shërbimeve emergjente për viktimat e dhunës e bazë gjinore dhe dhunës në familje në bashkitë Kukës, Berat, Durrës dhe Gjirokastër³⁴. Gjatë viteve 2026-2028 MSHMS parashikon ngritjen e qendrave të reja të emergjencës, në bashkitë me numër më të lartë rastesh.
5. **Ngritja qendrave/programeve rehabilituese për dhunuesit të cilat të përfshijnë edhe varësinë nga droga, alkoli si dhe problemet e shëndetit mendor** - MSHMS raporton se po punohet në drejtim të fuqizimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor si dhe po punohet në drejtim të transformimit të qendrave Shëndetësore në Qendra Socio-Shëndetësore duke zgjeruar ekipin e Qendrës Shëndetësore edhe me profesionistë me formim psiko-social.

Ngritja e qendrave dhe programeve rehabilituese për dhunuesit paraqet një komponent të rëndësishëm të qasjes së integruar ndaj parandalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Trajtimi i sjelljeve abuzive nuk mund të fokusohet vetëm tek ndërhyrjet ndëshkuese, por kërkon adresimin e shkaqeve të thella që shpesh lidhen me varësinë nga droga, alkooli, apo me probleme të shëndetit mendor. Iniciativa e MSHMS për të fuqizuar shërbimet komunitare të shëndetit mendor dhe për të transformuar qendrat shëndetësore në Qendra Socio-Shëndetësore është një hap domethënës drejt këtij qëllimi, pasi ofron një infrastrukturë më gjithëpërfshirëse, ku përfshihen edhe profesionistë me formim psiko-social.

6. **Marrjen e masave për krijimin e një fondi social për mundësimin e mbështetjes financiare dhe materiale për fëmijët e prekur nga femicidi**- MSHMS raporton se fëmijët e prekur për shkak të vrasjes së nënave të tyre, përfshihen në kategorinë e përfituesve të programeve të mbështetjes sociale, së bashku me fëmijët viktimë apo dëshmitarë të dhunës dhe abuzimit, si dhe ata pa kujdes prindëror.

Në analizën e kryer nga Observatori mbi trajtimin e rasteve të të miturve të prekur nga femicidi, është evidentuar nevoja për ndërhyrje të menjëhershme institucionale, përmes sigurimit të paketave *ad hoc* të mbështetjes financiare dhe materiale, të cilat duhet të jenë të përshtatura me nevojat specifike të secilit fëmijë. Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar mbështetje të vazhdueshme deri në përfitimin e pensionit familjar apo ndihmës ekonomike, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

34. Të katër këto strehëza emergjente kanë qenë objekt inspektimi, përgjatë periudhës janar 2023- maj 2025, ku rekomandimet kryesore të adresuara lidhen me përmirësimin e infrastrukturës duke e përshtatur edhe për personat me aftësi të kufizuara, përmirësimin e rregullores së brendshme, plotësimin e organikës me figura profesionale si punonjësi social, planifikim në buxhet për nevojat që paraqiten, etj.

MBI REKOMANDIMIN E ADRESUAR PËR POLICINË E SHTETIT³⁵

Policia e Shtetit përfaqëson një hallkë kyçe në reagimin e menjëhershëm dhe efektiv ndaj rasteve të dhunës në familje, duke qenë institucioni i parë me të cilin përballen rastet në nevojë për mbrojtje. Strukturat policore mbajnë përgjegjësi për garantimin e sigurisë së viktimës, mbledhjen dhe dokumentimin e provave, hartimin e akteve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes (UMM/UM), si dhe inicimin e procedurave ligjore kundër autorit të dhunës.

Çështjet e adresuara nëpërmjet rekomandimit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) *“Për marrjen e masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të policisë së Shtetit në drejtim të trajtimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë femicidin”*, synojnë forcimin e rolit të Policisë së Shtetit në parandalimin, evidentimin, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional për një qasje më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Përgjigja zyrtare e përcjellë nga Policia e Shtetit trajton në mënyrë përmbledhëse çështjet e adresuara nga Observatori, duke ofruar informacion mbi veprimet e ndërmarra, planet ekzistuese dhe angazhimet institucionale të parashikuara. Megjithatë, siç do të vërehet në analizën më poshtë, rezulton se të dhënat e raportuara janë kryesisht përshkruese, ndërkohë që mungon pasqyrimi i qartë i rezultateve të arritura, treguesve të matshëm të zbatimit dhe impaktit konkret të masave të ndërmarra. Në këtë kontekst, evidentohet nevoja për forcimin e zbatimit efektiv të detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor dhe nënligjor, si dhe për ngritjen e mekanizmave të qëndrueshëm të monitorimit dhe vlerësimit të performancës institucionale në fushën e parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe të femicidit.

- ⊙ **Rekomandim mbi rishqyrtimin e procedurave mbi kryerjen e vlerësimit të riskut dhe lëshimin e Urdhrave për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM)**, me qëllim marrjen e masave konkrete në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit, jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe me kuadrin ligjor të brendshëm: vlerësojmë se përgjigja e kthyer nga DPPSH është formale pa një përgjigje të drejtpërdrejtë. Përgjigja e përcjellë rezulton formale dhe nuk i përgjigjet drejtpërdrejt kërkesave të ngritura në rekomandim, duke u kufizuar në informimin për ngritjen e një grupi pune për shqyrtimin e ndryshimeve ligjore.

Megjithëse iniciativat për rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore, vlerësohet se marrja e masave të mëtejshme për garantimin e një reagim të shpejtë dhe të përshtatshëm ndaj situatave të rrezikut për jetën dhe integritetin e viktimave është e domosdoshme.

35. Rekomandimi mund të aksesohet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/e-drejta-e-grave/rekomandime-n-kuadr-t-observatorit-mbi-femicidet-1138/>;

Në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- ⊙ Vënien në lëvizje të mekanizmave, që nxisin koordinim më të mirë të punës me strukturat e tjera përgjegjëse anëtare të MKR-ve, për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, me qëllim shmangien e rrezikut të menjëhershëm dhe trajtimin e rasteve në mënyrë shumëdisiplinore.
- ⊙ Trajtimin në mënyrë të përbashkët dhe brenda një kohe të shkurtër të rasteve nga anëtarët e MKR-ve, që nga momenti i raportimit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, adresimin e nevojave fillestare të viktimave, monitorimin respektimit të urdhrave të mbrojtjes deri në rehabilitimin e plotë të viktimave.
- ⊙ Riadresimin e nevojës për ndjekjen në mënyrë paralele të procesit për lëshimin e UMM/UM-së dhe procedimit penal të dhunuesit, duke vlerësuar se urdhri i mbrojtjes i shërben jo vetëm mbrojtjes së integritetit të viktimës por edhe procesit të rehabilitimit të saj.

Është përcjellë informacion mbi punën që kryen policia në drejtim të adresimit të këtyre çështjeve dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera përgjegjëse. DPPSH ka përgatitur dhe dërguar pranë strukturave vendore të policisë, Planin e Veprimit nr.1971, datë 28.02.2025 “Për masat që duhet të merren nga strukturat e policisë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, për vitin 2025. Gjithashtu evidentohet fakti se është dhënë porosi e posaçme nga DPPSH në lidhje me bashkëpunimin me strukturat vendore në kuadër të trajtimit të rasteve.

1. **Referimi i rasteve pranë institucioneve shëndetësore me qëllim mbështetjen me ndihmë mjekësore dhe psikologjike si dhe pajisjen me raportin e posaçëm mjekësor:** Sipas informacionit të përcjellë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 3039/1, datë 01.07.2025, ju ka rikujtuar strukturave vendore të policisë detyrimin ligjor për të informuar viktimat e dhunës në lidhje me të drejtën e tyre për t’u drejtuar pranë institucioneve shëndetësore për ndihmë mjekësore dhe psikologjike, si dhe për t’u pajisur me raportin e posaçëm mjekësor.
2. **Rritja e efikasitetit në drejtim të identifikimit të rasteve dhe veprimit me iniciativë për të kërkuar lëshimin e UMM/UM-ve në rastet kur konstatohet dhunë:** lidhur me trajnimet e zhvilluara për punonjësit e policisë, me fokus në identifikimin e rasteve të dhunës dhe masat procedurale që duhen ndërmarrë në rastet e raportimit të dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, vihet re se mungon informacion mbi rastet kur strukturat e policisë kanë vepruar me iniciativë, pa pasur një kallëzim paraprak, në përputhje me detyrimet ligjore.
3. **Mbledhja, përditësimi dhe unifikimi i të dhënave mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore,** duke krijuar modele tip të regjistrave elektronikë për mbajtjen dhe evidentimin e tyre: në lidhje me këtë rekomandim është përcjellë informacion

mbi sistemin REVALB³⁶ dhe mbledhjen e të dhënave që kryehet nga policia. Të dhënat për autorët dhe viktimat janë të ndara sipas veprave penale, përkatësisë gjinore, moshës, vendbanimit dhe lidhjes së autorit me viktimën.

4. **Ngritja e strukturave të specializuara pranë komisariateve të policisë**, të cilat të kenë si përgjegjësi kryesore trajtimin e çështjeve që lidhen me dhunën me bazë gjinore, përfshirë femicidin, përbën një aspekt thelbësor të forcimit të reagimit institucional. Në këtë kuadër, është përcjellë informacion nga Policia e Shtetit se ndodhet në proces rishikimi të strukturës organizative, dhe se, në kuadër të këtij procesi, do të vlerësohet dhe analizohet mundësia e ngritjes së njësive të dedikuara për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë komisariateve të policisë

MBI REKOMANDIMIN E ADRESUAR PËR PROKURORITË³⁷

Në kuadër të përpjekjeve institucionale për parandalimin dhe ndëshkimin efektiv të dhunës me bazë gjinore dhe femicidit, një rol të rëndësishëm luajnë prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat përbëjnë një hallkë kyçe në zinxhirin e drejtësisë penale. Rekomandimi i drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme synon orientimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të praktikës hetimore dhe ndjekjes penale të rasteve të dhunës ndaj grave drejt një qasjeje më të ndjeshme gjinore, përmes analizës sistematike të motivit të krimit, forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe garantimit të aksesit real dhe të barabartë të viktimave në sistemin e drejtësisë. Po ashtu, rekomandimi thekson nevojën për një standard të unifikuar procedural në të gjitha prokuroritë e vendit, duke synuar jo vetëm ndëshkimin efektiv të autorëve, por edhe mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimave, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe detyrimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme lidhet me:

“Marrjen e masave nga Prokuroria e Përgjithshme për nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm, i cili të orientojë të gjitha prokuroritë në vend që të angazhohen në përmirësimin e mëtejshëm të praktikës së trajtimit të çështjeve që lidhen me femicidin dhe dhunën ndaj grave”, nëpërmjet:

- ⊙ Kryerjes së analizës së hollësishme të historikut të dhunës ndaj viktimave dhe motivit gjinor që lidhet me kryerjen e veprës penale;
- ⊙ Analizimit të historikut të dhunës ndaj viktimës dhe motiveve të vrasjes edhe në rastet kur kërkohet pushimi i çështjes për shkak se autorët kanë humbur jetën pas ngjarjes apo gjatë kryerjes së hetimeve;

36. Sistemi REVALB është një sistem elektronik dhe mbarëkombëtarë për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave për rastet e dhunës, me fokus të veçantë tek dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Ai menaxhohet nga Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës me Bazë Gjinore në çdo bashki.

37. Rekomandimi i plotë mund të aksesohet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/e-drejta-e-grave/rekomandime-n-kuadr-t-observatorit-mbi-femicidet-1138/>

- ⊙ Prioritizimit të sigurisë së viktimës në rastet kur hetohen çështje të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke koordinuar punën me koordinatorët vendorë dhe anëtarët e tjerë të MKR-ve;
- ⊙ Pajisjes së viktimave të dhunës në familje me prova shkresore, siç është akti i ekspertimit mjeko-ligjor apo ekstrakte të tjera të dosjes, nëpërmjet një procedurë lehtësisht të aksesueshme nga viktimat;
- ⊙ Vendosjen e urave të komunikimit dhe ndarjes së informacionit ndërmjet institucioneve të ndryshme, si policia, gjykatat civile dhe penale, shërbimet mbështetëse për viktimat, MKR-të etj.

Në përgjigje të rekomandimeve të adresuara, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë informacion lidhur me trajtimin me përparësi të rasteve të dhunës ndaj grave, si dhe mbi masat e ndërmarra për forcimin e procesit hetimor, përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor që përcakton standardet dhe udhëzimet për garantimin e të drejtave të viktimave të krimit. Ndër të tjera, është theksuar angazhimi për ndëshkueshmëri të rreptë ndaj krimeve të kryera ndaj grave dhe vajzave.

Në këtë kuadër, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 17, datë 16.09.2020, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje”. Ky udhëzim synon unifikimin e praktikës procedurale në të gjitha prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, duke garantuar që hetimi dhe ndjekja penale të realizohen brenda afateve të arsyeshme, në mënyrë efikase, me kërkesa për masa ndëshkuese efektive, proporcionale dhe parandaluese, në përputhje me objektivin e parandalimit të këtyre veprave penale.

Gjatë takimit të zhvilluar pranë Prokurorisë së Përgjithshme me datën 13.10.2025 u parashtrua nevoja për ndryshimin e këtij Udhëzimi me qëllim përfshirjen e dispozitave të veçanta për hetimin dhe gjykimin e rasteve të vrasjes së grave dhe vajzave dhe femicidit. Në këtë kuadër Prokuroria shprehu gatishmërinë për rishikimin e këtij udhëzimi me qëllim adresimin më të plotë dhe efektiv të rasteve të femicidit dhe vrasjeve të grave e vajzave.

Në zbatim të nenit 68 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, raportohet se në çdo prokurori janë emëruar koordinatorë të specializuar, me formim në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të ngjashme, me qëllim garantimin e asistencës së nevojshme për viktimat e krimit. Në funksion të lehtësimit të aksesit në drejtësi dhe nxitjes së raportimit të rasteve të dhunës, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur në faqen e saj zyrtare materiale informuese, broshura dhe modele aktesh, të cilat synojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe viktimave për të drejtat dhe procedurat përkatëse.

MBI REKOMANDIMIN E ADRESUAR PËR GJYKATAT³⁸

Në funksion të forcimit të mekanizmave institucionalë për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe femicidit, gjykatat përbëjnë një hallkë thelbësore në garantimin e aksesit në drejtësi, mbrojtjen efektive të viktimave dhe sigurimin e një ndëshkueshmërie të drejtë dhe proporcionale ndaj autorëve të veprave penale.

Avokati i Popullit, përmes Observatorit për Femicidet, i ka drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor rekomandimin: *“Për marrjen e masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të Gjykatave në drejtim të trajtimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përfshirë femicidin”*, me qëllim orientimin e mëtejshëm të praktikës gjyqësore drejt një trajtimi më të ndjeshëm gjinor, më të unifikuar dhe më efikas të çështjeve që lidhen me dhunën ndaj grave dhe femicidin. Këto rekomandime synojnë të forcojnë analizën e motiveve gjinore, garantimin e mbrojtjes së integritetit fizik dhe psikologjik të viktimave, parandalimin e riviktimizimit gjatë procesit gjyqësor, si dhe nxitjen e aplikimit të masave rehabilituese ndaj autorëve të dhunës, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Rekomandimet e përcjella lidhen me:

- ⊙ Mbajtjen e të dhënave të sinkronizuara për të pandehurit, autorët dhe viktimat;
- ⊙ Krijimin e një praktike të unifikuar në lidhje me analizën e motivit gjinor në çështjet që lidhen me të gjitha format e dhunës ndaj grave;
- ⊙ Marrjen e masave në lidhje me krijimin e mundësive për pyetjen e të mbijetuarave nga dhuna dhe trashëgimtarëve të viktimave në ambiente të ndryshme nga ambienti ku ndodhet autori, në funksion të shmangies së riviktimizimit të tyre;
- ⊙ Trajtimin me vëmendje të shtuar të çështjeve, që lidhen me dhunën ndaj grave duke i kushtuar vëmendjen e duhur përshtatjes së llojit të dënimit me nivelin e rrezikshmërisë së autorit, si dhe duke parashikuar në vendim detyrimin që dhunuesi të marrë pjesë në programe rehabilituese gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit;
- ⊙ Kryerjen e një analize të thelluar mbi historikun të dhunës dhe motivet e krimit në çdo rast, duke e shtrirë marrjen e informacionit edhe tek strukturat e tjera përgjegjëse;
- ⊙ Trajtimin me vëmendje të shtuar të nevojave për mbrojtje të viktimës edhe në rastet e mosparaqitjes së saj gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, duke caktuar masa mbrojtëse që mundësojnë mbrojtjen e integritetit dhe adresimin e nevojave të saj.

Në përgjigje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka informuar mbi hapat e ndërmarra në drejtim të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të unifikuara, duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë dhe rëndësinë që paraqet trajtimi i çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë rastet e femicidit.

38. Rekomanimi mund të aksesohet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/e-drejta-e-grave/rekomandime-n-kuadr-t-observatorit-mbi-femicidet-1138/>

Në këtë kontekst, KLGJ ka përcjellë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm përmbajtjen e rekomandimeve, me qëllim marrjen në konsideratë të çështjeve të adresuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, në funksion të një qasjeje më të ndjeshme gjinor dhe më efikase në trajtimin e këtyre rasteve

MBI REKOMANDIMIN E ADRESUAR PËR BASHKITË³⁹

Duke marrë në konsideratë rolin thelbësor që u takon njësive të vetëqeverisjes vendore në parandalimin, identifikimin dhe menaxhimin efektiv të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, përfshirë format më ekstreme si femicidi, është e domosdoshme forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe qartësimi i përgjegjësi të tyre funksionale në këtë fushë.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit ka adresuar një sërë çështjesh nëpërmjet rekomandimit: *“Për marrjen e masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të institucioneve të vetëqeverisjes vendore në drejtim të trajtimit dhe adresimit të çështjeve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore përfshirë femicidin”, drejtuar 61 (gjashtëdhjetë e një) bashkive të vendit. Rekomandimi thekson nevojën për krijimin e strukturave ndërlidhëse mes viktimave dhe institucioneve të tjera, forcimin e burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimin e mekanizmave të reagimit dhe mbështetjes, si dhe një angazhim më proaktiv në mbrojtjen ligjore dhe mbështetjen afatgjatë të viktimave dhe fëmijëve të prekur nga femicidi.*

Çështjet e ngritura në Rekomandim lidhen me marrjen e masave për:

- ⊙ Krijimin e modelit të institucioneve të cilat shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet nevojave të viktimave dhe strukturave të tjera përgjegjëse.
- ⊙ Ngritjen e burimeve materiale dhe njerëzore me qëllim përgjigjen në kohë dhe pa vonesa ndaj çdo rasti dhune në nevojë për ndihmë dhe mbështetje, duke asistuar policinë që në momentin e parë të raportimit të dhunës, si dhe duke ndjekur hap pas hapi rastin deri në përfundim të procesit rehabilitues.
- ⊙ Rritjen e kontributit të tyre në lidhje me paraqitjen e kërkesës për lëshimin e UMM/UM-së me kërkesën e viktimës, por edhe kryesisht, në rastet kur konstatohet dhunë.
- ⊙ Rishqyrtimin e standardeve në lidhje me monitorimin e Urdhrave të Mbrojtjes duke i kushtuar vëmendje vlerësimit rast pas rasti të nevojave për ndërhyrje, në drejtim të parandalimit të shkeljes së Urdhrave të Mbrojtjes dhe përshkallëzimit të dhunës.
- ⊙ Ngritjen e burimeve njerëzore dhe materiale me qëllim adresimin në kohë të nevojave emergjente dhe afatgjata të fëmijëve dhe trashëgimtarëve të viktimave të femicidit.

39. Rekomandimi mund të aksesohet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebsite/media/Rekomandim%20Bashkite-%20Observatori%20per%20femicidet.pdf>;

Në përgjigje të këtij rekomandimi, kanë reaguuar institucionalisht 59 bashki të vendit. Në përgjithësi, këto përgjigje janë përqendruar në ofrimin e informacionit mbi çështjet e adresuara në mënyrë të drejtpërdrejtë në rekomandim. Megjithatë, janë konstatuar raste kur disa bashki nuk i janë përmbajtur në mënyrë të plotë kërkesave të rekomandimit, duke ofruar informacion të përgjithshëm, kryesisht mbi funksionimin e Mekanizmave të koordinuar të referimit (MKR) dhe shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Po ashtu, në disa raste, përgjigjet janë kufizuar vetëm në një ose disa nga çështjet e ngritura, pa adresuar tërësisht përmbajtjen e rekomandimit.

Janë evidentuar gjithashtu raste kur përgjigjet e bashkive janë formale në përmbajtje, duke u kufizuar në pranimin deklarativ të rekomandimit dhe shprehjen e angazhimit për zbatimin e tij, pa paraqitur të dhëna konkrete mbi masat e ndërmarra. Po ashtu, janë konstatuar përgjigje që nuk korrespondojnë plotësisht me kërkesat e rekomandimit ose që paraqesin paqartësi në përmbajtje, duke vështirësuar vlerësimin e situatës reale në nivel vendor.

Nga të dhënat e administruara rezulton se në të gjitha bashkitë e vendit është ngritur Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR), megjithatë, standardet e funksionimit të tij variojnë ndjeshëm nga një bashki në tjetrën. Bazuar në informacionin e përcjellë, disa bashki kanë treguar një nivel më të lartë të konsolidimit të MKR-së dhe të përpjekjeve për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe burimeve materiale, si dhe në ushtrimin e një roli më proaktiv nga ana e koordinatorëve vendorë në identifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës, përfshirë ndjekjen e zbatimit të urdhërave të mbrojtjes. Ndër këto bashki evidentohej: Tirana, Kamza, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Lezha, Korça, Vlora, Pogradeci dhe Gjirokastra.

Në përgjithësi, raportimet evidentojnë një bashkëpunim të mirë ndërmjet koordinatorëve vendorë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të dhunës me bazë gjinore. Trajtimi i rasteve realizohet në koordinim të ngushtë me policinë, ndërkohë që punonjësit përgjegjës pranë bashkive ofrojnë mbështetje gjatë procedurave në komisariate dhe kontribuojnë në monitorimin e zbatimit të urdhërave të mbrojtjes. Megjithatë, ndonëse ky bashkëpunim ekziston në praktikë, vihet re se përfshirja efektive dhe asistenca e koordinatorëve vendorë gjatë trajtimit të rasteve në ambientet e komisariateve vijon të përbëjë një sfidë të vazhdueshme, e cila kërkon adresim të menjëhershëm përmes qartësimit të roleve institucionale dhe forcimit të kapaciteteve operacionale.

Në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë që u atribuohen bashkive në mbështetjen e viktimave të dhunës, veçanërisht përmes hartimit dhe paraqitjes së kërkesave për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes së Menjëhershme dhe/ose Urdhrit të Mbrojtjes (UMM/UM), si edhe ndërmarrjes së veprimeve me iniciativë në rastet kur konstatohet

dhunë, rezulton se ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet angazhimit të deklaruar institucional dhe zbatimit praktik të këtyre kompetencave. Megjithëse bashkitë shprehin gatishmëri për të asistuar viktimat kur paraqitet nevoja, të dhënat e mbledhura tregojnë se ndërhyrjet konkrete dhe numri i rasteve të asistuara në praktikë mbeten dukshëm të kufizuara, duke ngritur shqetësime mbi efektivitetin real të rolit të tyre në mekanizmin e mbrojtjes së viktimave. Sa i përket monitorimit të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, evidentohet se bashkitë aplikojnë praktika të ndryshme dhe jo të unifikuara. Ndonëse në nivel deklarativ pranohet se procesi i monitorimit kryhet, nga analiza jonë rezulton se ky proces zhvillohet në mënyrë formale dhe nuk përmbush në mënyrë të plotë standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, duke cenuar efektivitetin e masave mbrojtëse dhe qëllimin parandalues të tyre.

Në lidhje me ngritjen dhe konsolidimin e burimeve njerëzore dhe materiale, me qëllim adresimin në kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme të nevojave emergjente dhe afatgjata të fëmijëve dhe trashëgimtarëve të viktimave të femicidit, rezulton se informacioni i ofruar nga bashkitë mbetet kryesisht në nivel përshkruar dhe i përgjithshëm. Ky informacion fokusohet kryesisht në rolin formal të Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë bashkive, aty ku këto struktura janë funksionale, si dhe në përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, pa u shoqëruar me të dhëna konkrete mbi kapacitetet reale, burimet në dispozicion dhe ndërhyrjet e realizuara në praktikë.

Sa i përket mbështetjes emergjente materiale apo financiare për këtë kategori fëmijësh, konstatohet se ajo është e kufizuar, sporadike dhe me karakter të përkohshëm, duke u përqendruar kryesisht në ofrimin e pakove ushqimore dhe mjeteve shkollore. Nga analiza e përgjigjeve institucionale rezulton se asnjë prej bashkive nuk ka të parashikuar në mënyrë të institucionalizuar mekanizma të qartë, të strukturuar dhe afatgjatë mbështetjeje për fëmijët dhe trashëgimtarët e viktimave të femicidit, çka dëshmon mungesën e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për garantimin e mbrojtjes sociale dhe mirëqenies së tyre në vijimësi.

Disa nga sfidat kryesore me të cilat përballen pjesa më e madhe e bashkive lidhen me:

- ⊙ mungesën ose pamjaftueshmërinë e programeve rehabilituese të specializuara, si për viktimat ashtu edhe për autorët e dhunës, të cilat kufizojnë mundësinë e ndërhyrjeve të qëndrueshme dhe efektive;
- ⊙ mungesën e qendrave të emergjencës ose kapacitetet e kufizuara të strukturave ekzistuese, të pamjaftueshme për të përballuar nevojat reale në raste urgjente;
- ⊙ burimet financiare dhe njerëzore të kufizuara, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, shtrirjen dhe vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara;
- ⊙ vështirësitë në menaxhimin e rasteve që shoqërohen me probleme të shëndetit mendor, për shkak të mungesës së shërbimeve të specializuara dhe bashkëpunimit ndërinstitutional;

- ⊙ mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm për strehimin afatgjatë të viktimave, përtej zgjidhjeve të përkohshme;
- ⊙ financimin e pamjaftueshëm dhe mungesën e qëndrueshmërisë së shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, duke i bërë ato të varura nga projekte afatshkurtra;
- ⊙ vështërsitë në trajtimin e rasteve kur autorët e dhunës janë përdorues të drogës dhe/ose alkoolit, për shkak të mungesës së programeve të rehabilitimit dhe trajtimit të varësisë;
- ⊙ mungesën e ndihmës juridike dytësore për viktimat e krimit dhe familjarët e tyre⁴⁰, çka kufizon aksesin efektiv në drejtësi;
- ⊙ lëvizjen e shpeshtë të stafit dhe nevojën për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme, të cilat ndikojnë në ruajtjen e kapaciteteve institucionale dhe cilësinë e ndërhyrjeve.

Praktika pozitive:

Disa nga praktikat pozitive të identifikuar gjatë analizës së informacionit të sjellë nga bashkitë lidhen me:

Koordinimin e punës ndërmjet bashkisë dhe komisaritit të policisë dhe trajtimi i përbashkët i rasteve.

- ⊙ Prej disa vitesh në *Bashkinë Elbasan* funksionon kalendari i gatishmërisë, i cili përbëhet nga punonjës të Drejtorisë së Shërbimit Social të cilët qëndrojnë në gatishmëri për të asistuar rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare edhe jashtë orarit zyrtar përgjatë shtatë ditëve të javës. Veprimi me iniciativë i punonjësve përgjegjës në identifikimin e rasteve në nevojë për mbrojtje nga Bashkia Elbasan dhe shoqërimi i viktimave në polici për ndjekjen e procedurave për pajisjen me UMM/UM. Identifikimi i rasteve kryhet nga Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin, policia vihet në lëvizje edhe kur viktimat nuk është e vendosur për të raportuar. Për çdo rast të pajisur me UM/UM kryhet një vlerësim në lidhje me nevojat e viktimës dhe rrezikut të përshkallëzimit të dhunës.
- ⊙ Pjesëmarrja e Koordinatorit Vendor pranë *Bashkisë Gjirokastrë* gjatë trajtimit të rastit në polici.
- ⊙ Raportohet se në *Bashkinë Maliq* aplikohen procedura të qarta për sinjalizimin, reagimin dhe ndarjen e përgjegjësive në rastet kur dhuna mund të përshkallëzohet në femicid, dhe ku evidentohet fakti se në këtë proces kryeplaku i fashatit ka rol të rëndësishëm.

40. Bazuar në analizën e performancës vjetore 2024 të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, rezultoi se 46% e përfituesve janë në pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie dhe në 53% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si viktimat e dhunës, përfitues të skemave sociale, etj, ndërsa 1% e tyre janë kategori e papërcaktuar. Në këtë raport nuk jepen të dhëna mbi numrin e viktimave të dhunës në familje të mbështetura me ndihmë juridike dytësore (përfaqësim falas në gjykatë dhe përjashtim nga tarifat gjyqësore).

MBËSHTETJA E FËMIJËVE DHE TRASHËGIMTARËVE TË VIKTIMAVE TË FEMICIDIT

Në funksion të mbështetjes së fëmijëve dhe trashëgimtarëve të viktimave të femicidit, *Bashkia Elbasan* ka ndërmarrë një sërë masash për të adresuar nevojat emergjente dhe afatgjata të tyre. Raportohet se ofrohet strehim i përkohshëm, asistencë ekonomike, ndihmë psikosociale dhe ligjore. Po ashtu, *Bashkia Korçë*, ka siguruar mjetet e nevojshme për të adresuar emergjencat për të ndihmuar familjet e viktimave në mënyrë të menjëhershme dhe afatgjatë.

Marrja e informacionit mbi lirimimin e dhunuesve nga burgu

Raportohet se *Shërbimi Social i Bashkisë Vlorë* mban kontakte të vazhdueshme me Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Vlorë dhe njoftohet në çdo rast kur dhunuesi lirohet nga burgu. Ndërsa Koordinatori Vendor i *Bashkisë Pogradec* i kushton vëmendje të veçantë rasteve të lirimimit nga burgu të dhunuesve;

Ngritja e Njësive për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NJVNR)⁴¹

Në disa prej bashkive të cilat kanë sjellë informacion, janë ngritur dhe funksionojnë Njësitet për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NJVNR), në nivel njësisht administrative. Në disa prej bashkive ngritja e këtyre njësive është në proces.

Gjetje mbi zbatimin e rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse

Bazuar në analizën e përgjigjeve institucionale të administruara në kuadër të rekomandimeve të përcjella nga Avokati i Popullit, në vijim të Raportit të parë mbi femicidin, rezulton se institucionet përgjegjëse, në parim, i kanë pranuar rekomandimet dhe kanë referuar masa të ndërmarra ose të planifikuara, duke sinjalizuar një disponueshmëri institucionale për të përmirësuar reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore dhe ndaj fenomenit të femicidit.

Megjithatë, nga vlerësimi i përmbajtjes së përgjigjeve dhe i natyrës së masave të raportuara, konstatohet se zbatimi i rekomandimeve mbetet i pabarabartë, fragmentar dhe, në një masë të konsiderueshme, i fokusuar në ndërhyrje me karakter procedural ose formal, si hartimi i planeve, zhvillimi i trajnimeve, organizimi i tryezave të punës apo nismave në proces konceptimi, pa u shoqëruar në mënyrë të mjaftueshme me rezultate të prekshme dhe të verifikueshme në terren.

Në këtë kuptim, vihet re një hendek ndërmjet angazhimit të deklaruar dhe efektit real mbrojtës, në mungesë të standardizimit të praktikave, si dhe të mekanizmave të qëndrueshëm të monitorimit, raportimit periodik dhe llogaridhënies për zbatimin e masave.

41. Ngritja e Njësive për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NJVNR) në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr. 121, datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".

Veçanërisht problematike paraqiten boshllëqet e evidentuara në veprimin proaktiv dhe parandalues, në koordinimin ndërinstytucional me funksionim të rregullt dhe efektiv, si dhe në përdorimin në kohë dhe pa vonesa të instrumenteve ligjore ekzistuese, të cilat synojnë vlerësimin e rrezikut, ndërhyrjen emergjente dhe vendosjen e masave mbrojtëse për viktimat. Po ashtu, garantimi i mbështetjes së menjëhershme dhe afatgjatë për viktimat, si dhe për fëmijët e prekur nga rastet e femicidit, rezulton i paunifikuar, jo gjithmonë i koordinuar dhe i varur nga kapacitete të pabarabarta në nivel vendor, duke cenuar parimin e aksesit të barabartë në shërbime, mbrojtje dhe rehabilitim.

Në tërësi, pavarësisht referimeve për masa të ndërmarra dhe angazhimeve të shprehura, reagimi institucional vlerësohet ende i pamjaftueshëm për të garantuar një mbrojtje reale, të unifikuar dhe efektive, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Për rrjedhojë, mbetet e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të kalojnë nga qasjet kryesisht deklarative dhe procedurale drejt zbatimit të verifikueshëm dhe të matshëm, të mbështetur në koordinim funksional, standarde të qarta ndërhyrjeje, monitorim të vazhdueshëm dhe përgjegjshmëri konkrete për rezultatet, me synim parandalimin e humbjes së jetës dhe garantimin e sigurisë së grave dhe vajzave.

2.2

Përmbledhje mbi rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave dhe femicidit në Shqipëri të ndodhura gjatë vitit 2024 në ndërthurje me rastet e trajtuara në raportin e parë (2021-2023)


Megjithëse, në krahasim me tre vitet paraardhëse⁴², konstatohet një rënie e numrit të grave dhe vajzave të vrara, vrasjet e grave dhe vajzave/femicidit, si dhe format e tjera të krimeve të rënda ndaj grave, vijojnë të përbëjnë një shqetësim serioz në Shqipëri. Ky tregues pasqyron një problematikë të thellë shoqërore dhe institucionale, e cila nuk mund të vlerësohet vetëm përmes ndryshimeve statistikore, por kërkon analiza të vazhdueshme dhe ndërhyrje të qëndrueshme në nivel parandalues, mbrojtës dhe ndëshkues.

Sipas të dhënave statistikore zyrtare, norma e femicidit në Shqipëri është vlerësuar në 0.84 për 100.000 gra dhe vajza gjatë vitit 2023. Ndërkohë, për vitin 2024 kjo normë ka shënuar një rënie të ndjeshme, duke arritur në 0.25 për 100.000 gra dhe


42. Bazuar në raportin paraardhës rezulton se gjatë viteve 2021-2023, në Shqipëri u vranë 32 gra dhe vajza, ku në vitin 2021 u regjistruan 12 raste të vrasjes së grave dhe vajzave, në vitin 2022 u regjistruan 7 viktima gra dhe vajza dhe në vitin 2023 u regjistruan 13 raste të vrasjes së grave dhe vajzave.

vajza. Pavarësisht këtij përmirësimi në aspektin sasior, fenomeni i dhunës ekstreme ndaj grave mbetet shqetësues, duke evidentuar nevojën për forcimin e përgjigjes institucionale, përmirësimin e mekanizmave të parandalimit dhe garantimin e një mbrojtjeje efektive për gratë dhe vajzat në rrezik.

VRASJET GRAVE DHE VAJZAVE DHE FEMICIDET NË SHQIPËRI



NORMA E FEMICIDIT NË SHQIPËRI 2021-2024 (PER 100,000 POPULLATE GRA DHE VAJZA)



Sipas publikimit të INSTAT “Burra dhe Gra 2025⁴³”, nga gjithsej 40 vrasje me dashje të evidentuara gjatë vitit 2024, rreth 22,5 % e tyre, konkretisht 10 raste, kanë ndodhur për shkak të marrëdhënies familjare, në kuptim të nenit 79/c të Kodit Penal. Paralelisht, të dhënat statistikore tregojnë se gjatë këtij viti kanë raportuar raste dhune në familje 1.456 gra, duke evidentuar një përqendrim të lartë të rasteve në Qarkun e Tiranës, i cili përbën 41,1 % të totalit të grave të dëmtuara nga dhuna në familje. Ky qark ndiqet nga Qarku i Durrësit me 15,2 % dhe Qarku i Fierit me 8,3 %, çka tregon shpërndarje të pabarabartë territoriale të fenomenit dhe nevojën për ndërhyrje të targetuara në zonat me incidencë më të lartë.

Në të njëjtën linjë, sipas të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme, pesha specifike e veprës penale “Vrasje për shkak të marrëdhënies familjare” brenda grupit të veprave penale “Krimet kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2024 vlerësohet në 4,25 %, duke shënuar një rritje të lehtë prej 0,11 % krahasuar me vitin 2023⁴⁴. Ky zhvillim sinjalizon se, pavarësisht ndryshimeve të përgjithshme në numrin total të vrasjeve, rreziku i dhunës ekstreme në kontekstin familjar vijon të mbetet i pranishëm dhe kërkon vëmendje të shtuar institucionale.

Gjatë vitit 2024, në Shqipëri u vranë pesë gra, prej të cilave dy u vranë nga bashkëshortët e tyre, ndërsa një rast u krye nga një person i njohur për viktimën. Të tria këto raste klasifikohen si femicide, në përputhje me kuadrin statistikor të Kombeve të Bashkuara⁴⁵. Në mënyrë më specifike, dy rastet e vrasjeve të kryera nga bashkëshortët konsiderohen femicide për shkak se përbëjnë vrasje me dashje të realizuara nga partnerë intimë, ndërsa rasti i tretë kategorizohet si femicid bazuar në rrethanat konkrete dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale⁴⁶.

43. Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2025” është një publikim që paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës, të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë për monitorimin e politikave ndërsektoriale, në kuadër të arritjes së barazisë gjinore, shih: <https://www.instat.gov.al/media/aimnosvx/pressrelease-gra-dhe-burra-2025.pdf>;

44. Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2024, faqe 62; file:///C:/Users/User/Downloads/Raporti_PP_2024_permbledhes_28_03_2025_7729.pdf;

45. Në kuadrin statistikor të OKB-së për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore, femicidi përkufizohet si:

“Vrasje me dashje e grave, e kryer nga partnerë intimë, anëtarë të tjerë të familjes, ose persona të njohur apo të panjohur, bazuar në mënyrën e kryerjes ose në kontekste që tregojnë motive gjinore”.

Kuadri statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (që njihen edhe si “femicide/femicide”), përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, viti 2022, faqja 10, shih: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical_framework_femicide_2022.pdf

46. Bazuar në kuadrin statistikor të OKB, në rastet kur **vrasja është kryer nga persona të tjerë**, jashtë marrëdhënies intime apo familjare, rastet kualifikohen si femicide nëse evidentohet një apo disa nga tetë treguesuesit e motiveve të lidhura me gjininë si:

1. Historia e mëparshme e dhunës
2. Shfrytëzimi i paligjshëm
3. Rrëmbimi ose heqja e pa ligjshme e lirisë
4. Përfshirja e viktimës në Industrinë e seksit
5. Dhuna seksuale në trupin e viktimës
6. Keqtrajtimi i trupit të viktimës
7. Trupi i viktimës ishte hedhur apo asgjësuar në një hapsirë publike
8. Urrejtja ose paragjykimi ndaj grave

Këto të dhëna konfirmojnë se femicidi, ndonëse në rënie numerike, mbetet një formë ekstreme e dhunës me bazë gjinore, e lidhur ngushtë me marrëdhëniet familjare dhe sociale, dhe evidentojnë nevojën për forcimin e mekanizmave të parandalimit, mbrojtjes dhe ndërhyrjes së hershme nga institucionet përgjegjëse.

Njëra prej grave të vrara gjatë vitit 2024 ishte shtetase indoneziane, pjesë e një komuniteti të vogël indonezian që jeton në Tiranë, e cila prej disa vitesh kishte qëndruar dhe jetuar në Shqipëri së bashku me bashkëshortin e saj, shtetas amerikan. Ngjarja ndodhi në kontekstin e marrëdhënies bashkëshortore, ndërsa pas kryerjes së veprës penale autori kreu vetëvrasje. Sipas informacioneve të bëra publike nga mediat, autori dyshohet se ka pasur probleme të shëndetit mendor, faktor i cili mund të ketë ndikuar në përshkallëzimin e konfliktit dhe në realizimin e aktit fatal. Megjithatë, këto rrethana mbeten për t'u verifikuar përfundimisht përmes procedurave hetimore. Aktualisht, çështja vijon të jetë nën hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin e faktorëve kontribues dhe vlerësimin e përgjegjësive përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet procedurale të hetimit penal.

Në njërin prej rasteve të evidentuara, një grua e moshuar humbi jetën së bashku me bashkëshortin e saj, pas një konflikti të çastit, si pasojë e sulmit dhe dhunës ekstreme të ushtruar nga fqinji i tyre. Kjo ngjarje vijon të jetë objekt hetimi nga organet kompetente.

Ndërkohë, në dy raste të tjera, autorët e veprave penale ishin djem me probleme të shëndetit mendor, të vërtetuara në bazë të dokumentacionit përkatës mjeko-ligjor, të cilët kanë vrarë nënat e tyre. Në të dyja situatat, viktimat ishin kujdestaret ligjore të autorëve dhe përbënin personat e vetëm në familje që jetonin me ta dhe ofronin kujdes të vazhdueshëm. Për këto raste, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Durrës kanë vendosur caktimin e masës “Kurim i detyruar në një institucion mjekësor” ndaj autorëve, në përputhje me vlerësimet mjeko-ligjore dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Këto dy raste evidentojnë qartë nevojën për një trajtim të posaçëm dhe me vëmendje të shtuar të situatave në të cilat ekzistojnë indicie të sjelljeve agresive të personat me probleme të shëndetit mendor, veçanërisht kur këto sjellje mund të përbëjnë rrezik real dhe serioz për jetën dhe shëndetin e personave me të cilët ata bashkëjetojnë. Në këtë kontekst, bëhet e domosdoshme forcimi i mekanizmave të identifikimit të hershëm, vlerësimit të rrezikut dhe ndërhyrjes parandaluese, përmes bashkëpunimit të ngushtë ndër-institucional ndërmjet shërbimeve shëndetësore, strukturave të mbrojtjes sociale dhe organeve të rendit, me qëllim parandalimin e ngjarjeve me pasoja fatale.

Nga analiza e të dhënave të mbledhura rezulton se problematikat e shëndetit mendor, në disa prej rasteve objekt shqyrtimi, janë shfaqur si faktor kontribues në

kryerjen e akteve të dhunës ekstreme ndaj grave. Analiza eidenton se personat me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët nuk kanë përfituar mbështetje të mjaftueshme dhe të vazhdueshme nga sistemi shëndetësor dhe rrethi familjar, kanë shfaqur sjellje agresive si pasojë e izolimit social, mungesës së trajtimit të strukturuar dhe afatgjatë, si dhe përkeqësimit të gjendjes së tyre psiko-emocionale. Këta faktorë, të kombinuar, kanë rritur ndjeshëm rrezikun e përshkallëzimit të dhunës, duke krijuar kushte të favorshme për manifestimin e akteve të dhunës ekstreme ndaj personave me të cilët këta individë bashkëjetojnë.

Në njërin prej rasteve të analizuara, nga shqyrtimi i informacionit rezulton se viktimat kishin kërkuar në mënyrë të përsëritur mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit për kurimin e detyruar të të birit, i cili vuante nga probleme të shëndetit mendor dhe ushtronte dhunë ndaj saj. Pavarësisht këtyre kërkesave, ndërhyrjet kanë qenë të kufizuara dhe të përkohshme, duke u konkretizuar në hospitalizime afatshkurtra, pas të cilave autori rikthehej sërish në banesë, pa u shoqëruar me masa të qëndrueshme ndjekjeje apo monitorimi⁴⁷.

Nga analiza rezulton gjithashtu se mungojnë mekanizma proaktive për identifikimin, ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve të dhunuesve me histori psikiatrike, pavarësisht rrezikut të lartë që këta persona paraqesin për sigurinë dhe jetën e familjarëve me të cilët bashkëjetojnë. Në këtë kontekst, mungesa e diagnozës së hershme, stigma sociale ndaj çrregullimeve të shëndetit mendor, si dhe dështimi institucional për të ndërhyrë në kohë dhe me instrumente të përshtatshme, kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi të pasigurt, ku dhuna është përshkallëzuar progresivisht, deri në akte të rënda si plagosja e rëndë apo vrasja e viktimës.

Në lidhje me historikun e dhunës ndaj grave dhe vajzave të vrara, analiza e të dhënave tregon se në 4 nga 5 rastet e vrasjes, viktimat kanë qenë subjekt i dhunës së vazhdueshme nga autorët përpara ngjarjes fatale. Ky konstatim përputhet edhe me gjetjet e raportit të parë të përgatitur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili eidentoi se mbi 90 për qind e grave dhe vajzave të vrara kishin përjetuar dhunë të mëparshme nga autorët e krimin.

Megjithatë, nga shqyrtimi i rasteve në kuadër të këtij raporti rezulton se në asnjë prej tyre viktimat nuk kanë qenë të pajisura me Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme apo Urdhër Mbrojtjeje, as përpara dhe as në momentin e ndodhjes së vrasjes. Po ashtu, asnjë nga këto raste nuk rezulton të ketë qenë i trajtuar më herët nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për Dhunën në Familje (MKR)⁴⁸. Këto gjetje nxjerrin në pah boshllëqe të theksuara në identifikimin e hershëm të rrezikut, duke theksuar nevojën për ndërhyrje më proaktive dhe të koordinuara në rastet e dhunës me risk të lartë.

47. Rasti i vrasjes së shtetasës H.S nga i biri me probleme të shëndetit mendor në Kavjë.

48. MKR, organizohet dhe funksionon në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.06.2021 "Për Mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës".

2.3

Analizë e rasteve të vrasjes së grave dhe vajzave, të dhëna mbi viktimat, autorët dhe ngjarjet

TË DHËNA MBI VIKTIMAT

Në lidhje me karakteristikat e moshës së viktimave, analiza e të dhënave tregon se 4 nga 5 gratë e vrara i përkisnin grupmoshës mbi 60 vjeç, ndërsa një viktimë ishte e moshës 48 vjeç. Sa i përket kombësisë dhe shtetësisë, tre prej viktimave kishin kombësi dhe shtetësi shqiptare, ishin lindur dhe banonin në Shqipëri, një viktimë kishte kombësi greke dhe shtetësi shqiptare, ndërsa një viktimë tjetër kishte kombësi indoneziane dhe shtetësi amerikane, e cila prej disa vitesh jetonte në Shqipëri.

Në aspektin territorial, viktimat rezultojnë të kenë pasur vendbanim në Tiranë, Kavajë, Lezhë, Dropull dhe Konispol. Nga analiza e mëtejshme rezulton se tre nga pesë viktimat jetonin në zona rurale, ndërsa dy prej tyre në zona urbane. Këto të dhëna evidentojnë se femicidi prek gra të grupmoshave dhe profileve të ndryshme, si dhe shtrihet si në zona urbane ashtu edhe rurale, duke theksuar nevojën për politika parandaluese dhe mekanizma mbrojtës të përshtatur sipas kontekstit demografik dhe territorial.

Në lidhje me statusin martesor të viktimave, rezulton se tre prej tyre ishin të martuara në kohën e ngjarjes, ndërsa dy viktimat ishin të veja dhe ushtronin rolin e kujdestareve ligjore për djemtë e tyre me probleme të shëndetit mendor. Katër nga viktimat kishin fëmijë, të cilët në të gjitha rastet ishin në moshë madhore.

Sa i përket nivelit arsimor, të dhënat tregojnë se dy viktimat kishin përfunduar arsimin 4-vjeçar, dy viktimat arsimin 8-vjeçar, ndërsa një viktimë kishte arsim të lartë. Në aspektin e statusit të punësimit, katër prej viktimave ishin në pension, ndërsa një viktimë ishte në marrëdhënie aktive pune. Nga shqyrtimi i rasteve rezulton se asnjë prej viktimave nuk kishte aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, në materialet e analizuara mbi këto raste nuk evidentohej informacion lidhur me intoksikimin e viktimave nga alkooli apo lëndët narkotike, çka tregon mungesë të të dhënave që do të lidheshin me faktorë të tillë në momentin e ngjarjeve.

TË DHËNA MBI AUTORËT

Nga analiza e të dhënave mbi autorët e vrasjeve të grave rezulton se në të gjitha rastet autorët ishin burra, fakt i cili konfirmon natyrën gjinore të veprave penale në fjalë. Sa i përket moshës, tre prej autorëve i përkisnin grupmoshës mbi 60 vjeç,

ndërsa dy autorë ishin të moshës 35 dhe 55 vjeç, duke treguar se ushtrimi i dhunës ekstreme nuk kufizohet në një grupmoshë të caktuar.

Në lidhje me kombësinë dhe shtetësinë, në katër raste autorët kishin kombësi dhe shtetësi shqiptare, të lindur dhe banues në Shqipëri, ndërsa në një rast autori kishte kombësi dhe shtetësi amerikane dhe jetonte prej disa vitesh në Shqipëri.

Sa i përket statusit martesor, rezulton se tre prej autorëve ishin të martuar në kohën e ngjarjes, ndërsa dy autorë ishin beqarë. Gjithashtu, katër prej autorëve kishin fëmijë, të cilët ishin në moshë madhore.

Në lidhje me nivelin arsimor, rezulton se dy autorë kishin arsim të lartë, një autor kishte përfunduar arsimin 8-vjeçar, një autor arsimin 4-vjeçar, ndërsa një autor rezulton pa arsim.

Sa i përket statusit të punësimit dhe aftësisë së kufizuar, dy prej autorëve ishin në pension, një autor ishte në marrëdhënie pune, ndërsa dy autorë rezultojnë persona me aftësi të kufizuara për shkak të problemeve të shëndetit mendor. Në materialet e shqyrtuara nuk rezulton informacion lidhur me intoksikimin e autorëve nga alkooli apo lëndët narkotike⁴⁹.

Nga verifikimi i historikut penal rezulton se asnjë nga autorët nuk kishte qenë i dënuar më parë. Pas kryerjes së veprës penale, tre prej autorëve u ndaluan menjëherë nga organet ligjzbatuese, ndërsa dy autorë humbën jetën menjëherë pas ngjarjes⁵⁰.

Në lidhje me marrëdhënien ndërmjet autorëve dhe viktimave, në dy raste autorët ishin bashkëshortët e viktimave, në dy raste autorët ishin djemtë e viktimave dhe në një rast autori ishte person i njohur i viktimës (fqinji). Këto të dhëna tregojnë se veprat penale janë kryer kryesisht në kuadër të marrëdhënieve familjare ose sociale të afërta.

TË DHËNA MBI NGJARJET

Sa i përket vendndodhjes gjeografike të krimeve, rezulton se ngjarjet janë regjistruar në qytetet Tiranë, Kavajë, Lezhë, Dropull dhe Konispol. Në të gjitha rastet, vrasjet janë kryer në ambientet e banesave të viktimave, çka evidenton karakterin familjar dhe privat të këtyre ngjarjeve. Në lidhje me prezencën e fëmijëve të mitur gjatë kryerjes së veprave penale, nga analiza rezulton se në një prej rasteve ishte e pranishme një e mitur, mbesa e viktimës dhe autorit, e cila pas ngjarjes ka njoftuar familjarët për kryerjen e krimit.

49. Nuk rezulton që institucionet proceduese të iniciojnë kryerjen e analizave përkatëse për të vërtetuar intoksikimin e autorëve.

50. Një autor u vetëvra menjëherë pas ngjarjes, një autor humbi jetën si pasojë e dhunës së ushtruar nga i biri në kushtet e tronditjes së fortë psikike.

Mënyra e kryerjes së veprës penale dhe mjete i përdorur

Krimet janë karakterizuar nga përdorimi i një niveli të lartë dhune, si dhe nga përdorimi i mjeteve të ndryshme për kryerjen e veprës penale, përfshirë mjete të forta, mjete të mprehta dhe mjete prerëse. Këto rrethana tregojnë për intensitetin e veprimeve të ndërmarra nga autorët dhe për ekzistencën e një qëllimi të qartë për t'i shkaktuar viktimave dëmtime të rënda fizike ose për t'i privuar nga jeta.

Intensiteti shumë i lartë i dhunës së përdorur reflekton elementë të kontrollit, ndëshkimit apo hakmarrjes ndaj viktimave. Këto elemente përbëjnë tregues të rëndësishëm të rrezikshmërisë së lartë të autorëve dhe të natyrës së dhunës së ushtruar, e cila zhvillohet kryesisht në marrëdhënie të afërta familjare ose sociale.

Këto gjetje evidentojnë ekspozimin që vijojnë të kenë gratë ndaj formave ekstreme të dhunës dhe nënvizojnë nevojën për ndërhyrje më të hershme dhe më efektive parandaluese, si dhe për forcimin e mekanizmave mbrojtës dhe të vlerësimit të rrezikut.

Sa i përket kohës së ndodhjes së ngjarjeve, rezulton se ato janë regjistruar në fasha të ndryshme orare, nga ora 06:00 deri në orën 20:00.

KREU III

RASTET E TENTATIVËS PËR VRASJE, PLAGOSJES SË RËNDË ME DASHJE DHE SHKAKTIMIT TË VETËVRASJES NDAJ GRAVE/VAJZAVE

3.1

Analizë e rasteve të vrasjeve të mbetura në tentativë, plagosjeve të rënda me dashje dhe vetëvrasjes si formë ekstreme e reagimit ndaj dhunës

Objekti i analizës në këtë kre do të jenë rastet e vrasjeve të mbetura në tentativë, plagosjeve të rënda me dashje dhe shkaktimit të vetëvrasjes të kryera ndaj grave dhe vajzave.

VRASJET E MBETURA NË TENTATIVË

Vrasjet e mbetura në tentativë përfaqësojnë një nga format më ekstreme të dhunës, ku autori ka ndërmarrë veprime konkrete me qëllim kryerjen e vrasjes së një personi, por për arsye të ndryshme qëllimi nuk është realizuar plotësisht.

Gjatë vitit 2024, janë regjistruar **gjashtë raste të tentativës për vrasje** të kryera ndaj grave dhe vajzave. Në dy prej këtyre rasteve, autorët e veprës penale kanë qenë bashkëshortët e viktimave, ndërsa në një rast autori ka tentuar të vrasë ish-të dashurën e tij. Një tjetër rast përfshinte një akt dhune brenda familjes, ku babai tentoi të vraste vajzën e tij. Në një rast tjetër, viktimë e agresionit ishte bashkëshortja e xhaxhait të autorit, duke dëshmuar kështu për përhapjen e dhunës në një rreth të gjerë familjar.

Duhet theksuar se numri i rasteve të regjistruara gjatë vitit 2024 paraqet një **rritje domethënëse** krahasuar me periudhën pesëvjeçare 2015–2020, kur në total janë dokumentuar **nëntë raste** të tentativës për vrasje ndaj grave dhe vajzave⁵¹. Kjo rritje ngre shqetësime serioze mbi përkeqësimin e fenomenit të dhunës ekstreme me bazë gjinore dhe nevojën për ndërhyrje më të thelluara institucionale dhe shoqërore.

Këto raste përbëjnë indikatorë të qartë të rrezikut të menjëhershëm për jetën e viktimës, shpesh të paraprirë nga episode të përsëritura dhune, kërcënimesh apo konflikti të zgjatur.

Edhe kur viktimat mbijetojnë, pasojat fizike dhe psikologjike janë të rënda, ndërsa rreziku për përsëritje mbetet real në mungesë të ndërhyrjes së menjëhershme

51. Shih raportin “Vrasjet e Grave (Femicidi) dhe tentativë për femicid” në Shqipëri, 2017-2020, faqe 24, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare si pjesë e programit rajonal të UN Women “T’i japim fund dhunës kundër grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, ‘Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë’, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, raporti mund të gjendet në linkun: <https://www.qag-al.org/publikime/femicidi.pdf>;

mbrojtëse dhe ligjore. Tentativat për vrasje duhet të trajtohen me të njëjtin nivel serioziteti si krimet e kryera, për të parandaluar përshkallëzimin e dhunës. Viktimat kërkojnë mbrojtje të menjëhershme, trajtim mjekësor dhe mbështetje psikologjike, ndërsa autorët duhet të hetohen dhe ndiqen penalisht. Institucionet përkatëse kanë detyrimin të zbatojnë masa parandaluese dhe monitoruese për të garantuar sigurinë e viktimës dhe për të shmangur rikthimin e dhunës.

PLAGOSJET E RËNDA ME DASHJE

Plagosjet e rënda me dashje përfaqësojnë një nga format më të rënda të dhunës fizike, ku veprimi i autorit karakterizohet nga vetëdija dhe qëllimi për të shkaktuar dëmtim serioz në integritetin trupor ose shëndetin e viktimës.

Këto raste reflektojnë një nivel të lartë agresiviteti të qëllimshëm dhe përfaqësojnë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe integritetin e individit. Për pasojë, ato kërkojnë reagim të menjëhershëm institucional dhe dëshkim të rreptë sipas parashikimeve të legjislacionit penal, për të parandaluar përshkallëzimin e dhunës në forma edhe më të rënda.

Në lidhje me rastet e plagosjes së rëndë me dashje, nga analiza e të dhënave të administruara rezulton se gjatë vitit 2024 janë evidentuar tre raste të tilla, ku viktimat kanë qenë gra. Në njërin prej rasteve, djali ka plagosur rëndë nënën e tij. Sipas informacionit të sjellë nga prokuroria, autori rezulton të ketë vuajtur nga probleme të shëndetit mendor dhe më parë ka qenë subjekt i masës mjekësore “Kurim i detyruar në një institucion mjekësor”. Rasti i dytë përfshin dy motra si autore, të cilat kanë plagosur rëndë një vajzë, duke pretenduar se ajo kishte ndërhyrë në marrëdhënien intime të njëres prej tyre. Në rastin e tretë, viktima është plagosur rëndë nga bashkëshorti i saj, pas konflikteve të përsëritura në marrëdhënien martesore.

Krimet që lidhen me këto vepra penale janë kryer me një shkallë të lartë mizorie, duke u karakterizuar nga dhunë ekstreme dhe shpërfillje e plotë ndaj jetës dhe dinjitetit njerëzor. Këto veprime janë kryer me qëllim të qartë për të shkaktuar vuajtje të rënda fizike dhe/ose psikologjike të viktimës, shpesh përmes përdorimit të mjeteve prerëse, mjeteve të forta goditëse, lëndëve djegëse, apo goditjes në zona vitale të trupit. Në disa raste janë konstatuar edhe elementë torturues dhe rrethana veçanërisht të rënduara. Nga analiza rezulton se kryerja e këtyre veprave nuk ka qenë e rastësishme apo impulsive, por në shumicën e rasteve e paramenduar.

Pasojat e plagosjeve të rënda me dashje janë jashtëzakonisht të rënda dhe afatgjata, duke përfshirë dëmtime të përhershme në integritetin fizik, trauma të thella psikologjike si dhe një ndjenjë të vazhdueshme frike dhe pasigurie të viktimat. Në shumicën e rasteve, viktimat kërkojnë trajtim mjekësor të specializuar, ndërhyrje psikologjike afatgjatë si dhe mbrojtje ligjore efektive për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të dhunës.

TË DHËNA MBI VIKTIMAT/TË MBIJETUARAT NGA KRIMET

Gjatë vitit 2024, janë regjistruar gjashtë raste të vrasjeve të mbetura në tentativë dhe tre raste të plagosjes së rëndë me dashje, me viktime gra dhe vajza. Këto ngjarje përfaqësojnë forma ekstreme të dhunës me pasoja serioze për jetën dhe integritetin e viktimave, duke kërkuar trajtim të specializuar nga institucionet përgjegjëse.

Në lidhje me grupmoshën e viktimave që mbijetuan nga këto krime, të dhënat tregojnë një shpërndarje të gjerë. Tre raste i përkisnin grave mbi 60 vjeç, dy raste grave të grupmoshës 45-59 vjeç, ndërsa tre gra ishin në grupmoshën 30-44 vjeç. Një rast përfshinte një viktimë të re në grupmoshën 15-29 vjeç.

Në tetë raste, të mbijetuarat kishin lindur dhe jetonin në Shqipëri, ndërsa në një rast, e mbijetuara kishte lindur jashtë vendit dhe kishte qëndrim të përkohshëm në Shqipëri. Po ashtu, në tetë raste, të mbijetuarat kishin kombësi dhe shtetësi shqiptare, ndërsa në një rast, ato ishin me kombësi dhe shtetësi rumune. Një tjetër rast i përkiste komunitetit etniko-kulturor egjiptian.

Sa i përket vendbanimit, të mbijetuarat banonin në: Tiranë 2 raste, Lushnjë 2 raste, Fier 2 raste, Korçë 2 raste dhe Krujë 1 rast. Në katër raste, ato jetonin në zona urbane dhe në pesë raste në zona rurale.

Në lidhje me statusin martesor të të mbijetuarave, nga të dhënat rezulton se në katër raste subjektet ishin të martuara, ku në një rast bashkëshortja ndodhej në proces gjyqësor divorci në momentin e ngjarjes. Në dy raste, subjektet ishin të divorcuara, në dy raste beqare, ndërsa në një rast e mbijetuara kishte statusin e të vesë.

Në shtatë raste, të mbijetuarat ishin nëna me dy ose tre fëmijë secila, duke përbërë gjithsej gjashtëmbëdhjetë fëmijë, prej të cilëve tre rezultonin të mitur në kohën e ngjarjes. Nga verifikimet përkatëse, asnjë prej të mbijetuarave nuk ishte shtatzënë në momentin e ngjarjes.

Në lidhje me **nivelin arsimor** të të mbijetuarave, nga të dhënat rezulton se gjashtë prej tyre kishin përfunduar arsimin 8-vjeçar, dy kishin përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa për një rast nuk disponohen të dhëna mbi nivelin arsimor.

Sa i përket **statusit të punësimit**, rezulton se tre të mbijetuara ishin në marrëdhënie pune në momentin e ngjarjes, dy ishin pensioniste dhe katër rezultonin pa punë. Nga verifikimet e kryera, në asnjë nga rastet viktimat nuk kishin aftësi të kufizuara përpara ngjarjes. Megjithatë, pas ngjarjes, si pasojë e dëmtimeve fizike të shkaktuara, tre prej tyre janë konstatuar me aftësi të kufizuara fizike.

Në materialet e shqyrtuara lidhur me rastet, nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë element që të tregojë për intoksikim nga alkooli apo substanca narkotike në momentin e ngjarjes.

Gjithashtu, në asnjë nga rastet nuk rezulton që viktimat të kenë qenë më parë në kontakt apo të kenë përfituar shërbime mbështetëse nga Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) përpara ndodhjes së ngjarjes.

TË DHËNA MBI AUTORËT

Nga analiza e rasteve rezulton se këto vepra penale janë kryer nga gjithsej dhjetë autorë. Në tetë raste, autorët e krimit ishin meshkuj, ndërsa në një rast plagosja është kryer në bashkëpunim nga dy vajza.

Autorët i përkasin grupmoshave të ndryshme, ku numri më i lartë i tyre i përket grupmoshës 30–44 vjeç (4 autorë), ndjekur nga grupmoshat mbi 60 vjeç, 45–49 vjeç dhe 15–29 vjeç, secila me nga dy autorë.

Të gjithë autorët kishin kombësi dhe shtetësi shqiptare dhe ishin të lindur e banues në territorin e Republikës së Shqipërisë. Njëri prej autorëve i përkiste grupit etniko-kulturor egjiptian.

Në lidhje me statusin martesor, pesë nga autorët ishin beqarë, ndërsa katër ishin të martuar, njëri prej të cilëve ndodhej në proces divorci në momentin e ngjarjes. Katër prej autorëve kishin fëmijë, ndërsa njëri prej tyre kishte fëmijë të mitur (nën 18 vjeç). Në lidhje me nivelin arsimor të autorëve, nga të dhënat rezulton se shtatë prej tyre kishin përfunduar arsimin 8-vjeçar, dy kishin përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa një autor kishte arsim fillor (4-vjeçar).

Sa i përket statusit të punësimit, tetë nga dhjetë autorët nuk ishin në marrëdhënie pune në momentin e ngjarjes, ndërsa dy prej tyre ishin pensionistë.

Në një rast, autori ishte person me aftësi të kufizuara për shkak të problemeve të shëndetit mendor, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës mjekësor. Në dy raste të tjera, janë raportuar probleme të ngjashme shëndetësore të pretenduara nga familjarët, por që nuk janë të konfirmuara nga autoritetet përkatëse shëndetësore. Nga materialet e shqyrtuara mbi rastet, rezulton se në tre raste autorët kanë qenë nën ndikimin e substancave narkotike dhe/ose alkoolit, duke u evidentuar si përdorues të rregullt të tyre.

Gjithashtu, rezulton se pesë nga nëntë autorët kishin qenë të dënuar më parë, prej të cilëve tre për vepra penale që lidhen me dhunën në familje.

Në nëntë raste, autorët u ndaluan nga organet ligjzbatuese, ndërsa një autor u vetëvra pas ngjarjes. Shtatë prej autorëve u proceduan penalisht nën masën e sigurimit personal “arrest në burg”. Në lidhje me marrëdhënien ndërmjet autorëve dhe viktimave, rezulton se në katër raste autorët ishin partnerë intimë të të mbijetuarave

(bashkëshortë ose ish-bashkëshortë të viktimave), në tre raste ishin anëtarë të familjes së të mbijetuarave, në dy raste ishin persona të njohur dhe në një rast autori ishte person i panjohur për viktimën.

TË DHËNA MBI NGJARJET

Mënyra e kryerjes së veprës penale dhe mjeti i përdorur

Nga analiza e rasteve rezulton se mjetet e përdorura në këto vepra penale tregojnë një shkallë të lartë mizorie dhe diversitet formash të ushtrimit të dhunës. Janë evidentuar raste të sulmeve me thikë në pjesë të ndryshme të trupit dhe në fytyrë, përdorim i armëve të zjarrit dhe i armëve të gjuetisë, si dhe raste të hedhjes së lëndëve djegëse dhe vënies së flakës. Në disa raste, autorët kanë përdorur sende të forta si mjete goditjeje.

Gjithashtu, janë konstatuar edhe forma të dhunës fizike të drejtpërdrejtë, përfshirë goditje të përsëritura me grushta dhe shqelma, përdorimin e rripave apo çarçafëve për t'i penguar viktimës frymëmarrjen, si dhe akte torture që kanë zgjatur për disa ditë radhazi.

Ngjarjet janë zhvilluar në fasha orare të ndryshme të ditës dhe natës, duke filluar nga ora 03:00 e mëngjesit deri në orën 22:00 të mbrëmjes, çka tregon mungesë parashikueshmërie dhe spontaneitet në sjelljen kriminale të autorëve.

Në disa raste, motivimi i autorëve lidhet me konflikte familjare apo personale, përfshirë motive hakmarrjeje, xhelozie, ose ushtrimi kontrolli dhe izolimi ndaj viktimave si pasojë e marrëdhënieve abuzive.

Në raste të tjera, problemet e shëndetit mendor të autorëve, së bashku me mungesën e ndërhyrjes institucionale në kohën dhe mënyrën e duhur, kanë rezultuar faktorë kontribues në kryerjen e veprës penale

3.2

Rastet e shkaktimit të vetëvrasjes në kontekstin e dhunës ndaj grave

Bazuar në analizën e informacionit dhe dokumentacionit mbi rastet objekt shqyrtimi, konstatohet se rastet e shkaktimit të vetëvrasjes përbëjnë një ndër format më ekstreme dhe më të rënda të ushtrimit të dhunës. Në këto situata, viktimat detyrohet të ndërmarrë aktin e vetëflijimit si pasojë e dhunës së vazhdueshme, shantazhit, kërcënimeve, presionit psikologjik apo izolimit social të ushtruar ndaj saj nga persona të afërt ose nga mjedisi përreth.

Edhe pse akti i vetëvrasjes kryhet nga vetë individi, përgjegjësia morale dhe ligjore u takon atyre personave, sjelljet abuzive të të cilëve kanë çënuar në mënyrë të rëndë dinjitetin, integritetin, lirinë dhe shëndetin mendor të viktimës, duke e çuar atë në një gjendje dëshpërimi ekstrem dhe humbje të perceptimit për mundësi shpëtimi apo mbrojtjeje. Nga informacioni i administruar në rrugë zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) dhe nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, rezulton se gjatë vitit 2024 kanë humbur jetën si pasojë e vetëvrasjes 8 gra dhe vajza, ndërsa në 5 raste të tjera vetëvrasja ka mbetur në tentativë. Në 4 prej rasteve të vetëvrasjes, çështjet janë hetuar pa autor.

Rastet e marra në shqyrtim nga Observatori përfshijnë ato situata në të cilat viktimat kanë humbur jetën dhe janë identifikuar e proceduar autorë për veprën penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes”

Në katër rastet e analizuara, viktimat i përkisnin moshave të ndryshme, që variojnë nga moshë nën 18 vjeç deri tek grupmosha 30-44 vjeç. Në tre raste viktimat ishin të martuara dhe kishin fëmijë nën moshën 18 vjeç.

Motivet që kanë ndikuar në shkaktimin e vetëvrasjeve lidhen kryesisht me marrëdhëniet konfliktuale dhe abuzive që viktimat kishin me partnerët e tyre, përfshirë ushtrimin e formave të ndryshme të dhunës. Në dy raste viktimat ishin të punësuar në momentin e ngjarjes, ndërsa në dy raste të tjera ato nuk ishin në marrëdhënie pune.

Një element i rëndësishëm që dallohet në rastet e dhunës online, të cilat kanë paraprirë aktin e vetëflijimit në dy prej viktimave, është mungesa e ndërhyrjes së menjëhershme dhe efektive nga strukturat institucionale përgjegjëse. Pavarësisht se janë bërë raportime paraprake në lidhje me këtë formë dhune, mekanizmat mbrojtës nuk kanë arritur të sigurojnë mbrojtje të plotë dhe të parandalojnë përshkallëzimin e dhunës deri në pasojat e saj fatale.

Nga analiza e të dhënave dhe nga dëshmitë e familjarëve rezulton se viktimat kishin qenë më parë subjekte të dhunës së ushtruar nga autorët. Dhuna e vazhdueshme fizike dhe psikologjike, shoqëruar me presion të përhershëm emocional dhe izolim social, kanë qenë faktorë përcaktues që kanë ndikuar në vendimin tragjik të viktimave për të ndërmarrë aktin e vetëvrasjes

Në një prej rasteve objekt shqyrtimi, është konstatuar se autori kishte ushtruar **dhunë fizike dhe psikologjike ndaj viktimës për një periudhë mbi njëzet (20) vjet**. Të dhënat e administruara tregojnë se viktimë kishte shenja të dukshme dhune fizike në trup edhe në ditën e ngjarjes.⁵² Gjithashtu, është vërtetuar se dhuna ishte shtrirë edhe ndaj fëmijëve të mitur të çiftit, duke krijuar një mjedis të përhershëm frike dhe pasigurie në familje.

52. Vendimi nr.1109, datë 11.12.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga shqyrtimi i vendimit gjyqësor dhe deklaratimet e autorit rezulton se vajza e tyre e mitur kishte tentuar vetëvrasjen disa vite më parë, si pasojë e traumës dhe presionit të vazhdueshëm psikologjik të përjetuar brenda familjes. Ky fakt nënvizon dimensionin e thellë të dhunës, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien dhe zhvillimin emocional të fëmijëve.

Në tërësinë e tyre, rastet e analizuara pasqyrojnë një realitet të dhimbshëm dhe kompleks, ku dhuna e përsëritur në marrëdhëniet familjare, mungesa e ndërhyrjeve të hershme institucionale, izolimi social i viktimave dhe varësia e tyre ekonomike përbëjnë faktorë vendimtarë që nxisin përshkallëzimin e dhunës deri në pasoja fatale.

TË DHËNA MBI AUTORËT E SHKAKTIMIT TË VETËVRASJES

Autorët e identifikuar janë meshkuj, të grupmoshës 18-59 vjeç, me kombësi dhe shtetësi shqiptare. Pjesa më e madhe e tyre janë prindër të fëmijëve të mitur, nën moshën 18 vjeç. Sa i përket nivelit arsimor, shumica kanë përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa rezultojnë të papunë në momentin e ngjarjes. Në dy raste, është konstatuar se autorët kanë pasur precedentë penalë dhe janë dënuar më parë për vepra të tjera penale. Në të gjitha rastet, autorët kanë qenë në marrëdhënie të afërta dhe të drejtpërdrejta me viktimat, si bashkëshortë, bashkëjetues, të fejuar apo partnerë sentimentalë. Në tre raste, marrëdhënia ka qenë e formalizuar nëpërmjet martesës ligjore.

TË DHËNA MBI NGJARJET

Në katër (4) rastet e shkaktimit të vetëvrasjes, ku viktimat kanë humbur jetën dhe janë proceduar autorë për veprën penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes”, rezulton se autorët kishin ushtruar dhunë të vazhdueshme fizike dhe psikologjike ndaj tyre. Nga analiza e materialeve hetimore dhe dokumentacionit përkatës konstatohet se dhuna sistematike ka qenë faktori kryesor që ka çuar në përkeqësimin e gjendjes psiko-emocionale të viktimave dhe në vendimin e tyre për vetëfljirim.

Në njërin prej këtyre rasteve, akti i vetëvrasjes është shoqëruar edhe me vrasjen e tre (3) fëmijëve të viktimës, çka thekson dimensionin ekstrem të dhunës dhe mungesën e mekanizmave mbrojtës efektivë.

Në një rast tjetër, dhuna psikologjike është manifestuar përmes shantazhit dhe publikimit të fotove intime të viktimës në rrjetet sociale, duke përbërë një formë të re dhe veçanërisht të rëndë të dhunës psikologjike dhe emocionale, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në vendimin ekstrem të viktimës. Në një rast tjetër, është evidentuar ushtrimi i dhunës psikologjike nga autori për motive xhelozie, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në përkeqësimin e gjendjes psiko-emocionale të viktimës dhe ka shërbyer si faktor nxitës në ndërmarrjen e aktit ekstrem të vetëfljimit.

Rastet e analizuara pasqyrojnë qartë domosdoshmërinë e identifikimit të hershëm dhe trajtimit me mjete të përshtatshme të dhunës, qoftë fizike apo psikologjike, duke theksuar ndikimin e saj të thellë dhe afatgjatë në shëndetin mendor, dinjitetin dhe jetën e viktimave. Ato nënvizojnë gjithashtu nevojën urgjente për një reagim të koordinuar dhe efektiv nga institucionet përgjegjëse, në mënyrë që të parandalohet përshkallëzimi i dhunës dhe pasojat e saj të parikuperueshme.

Motivet që kanë çuar viktimat drejt aktit të vetëfljimit në këto raste lidhen kryesisht me:

- 1. Dhunën psikologjike dhe fizike** nga partnerët intimë, që ka shkaktuar vuajtje të thellë tek viktimat.
- 2. Konfliktet e vazhdueshme**, përfshirë edhe tradhëtinë bashkëshortore, që kanë intensifikuar tensionet dhe kanë përkeqësuar gjendjen emocionale të viktimave, duke rritur ndjenjat e pafuqisë dhe dëshpërimit.
- 3. Shantazhi dhe publikimi i fotove intime në rrjetet sociale**, duke shkaktuar cenim të rëndë të dinjitetit dhe reputacionit të viktimës, stigmatizim social dhe presion të lartë psikologjik.
- 4. Mungesa e mbështetjes dhe ndihmës institucionale efektive**, e cila ka kontribuar në përshkallëzimin e situatës së dhunës dhe në ndjenjën e izolimit dhe pafuqisë së viktimave.
- 5. Motivet emocionale si xhelozia** që kanë ndikuar në përkeqësimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe në destabilizimin e gjendjes psikologjike të viktimave.

3.3

Historiku i dhunës ndaj viktimave dhe të mbijetuarave dhe roli i institucioneve përgjegjëse në mbështetjen e tyre përpara dhe pas ngjarjes

Në analizën e rasteve që lidhen me veprat penale të tjera objekt shqyrtimi, si vrasjet e mbetura në tentativë, plagosjet e rënda me dashje dhe vetëvrasjet e shkaktuara si pasojë e dhunës sistematike, konstatohet se shumica e viktimave kanë pasur një histori të mëparshme dhune. Në disa raste, kjo dhunë është identifikuar nga institucionet përkatëse, por nuk është trajtuar në kohën dhe me mjetet e nevojshme për të parandaluar përshkallëzimin e saj.

Ky fakt tregon se aktet e dhunës së rëndë nuk ndodhin në mënyrë të menjëhershme apo të izoluar, por janë rezultat i një procesi të vazhdueshëm të ushtrimit të dhunës fizike, psikologjike dhe emocionale. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, këto ngjarje mund të ishin parandaluar nëse do të ishte garantuar identifikimi i hershëm, reagimi i koordinuar dhe ndërhyrja efektive e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave të dhunës.

Në 3 nga 9 rastet, të mbijetuarat e krimeve⁵³ kishin raportuar më parë në polici. Po ashtu, gratë dhe vajzat që humbën jetën për shkak të vetëvrasjes kishin një histori të mëparshme dhune nga autorët, por të pa dokumentuar në organet proceduese⁵⁴. Njëra prej viktimave kishte raportur në polici dhe kishte qënë e pajisur me UM më parë⁵⁵, në këtë çështje autori i dhunës kishte qënë bashkëjetuesi i saj dhe jo autori i shkaktimit të vetëvrasjes.

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave – përfshirë strukturat e rendit, shërbimet sociale, organet e drejtësisë dhe qendrat e mbështetjes – kanë një rol thelbësor në identifikimin dhe ndërprerjen e ciklit të dhunës përpara se ajo të përshkallëzohet në ngjarje me pasoja fatale ose të parikuperueshme. Megjithatë, analiza e rasteve tregon se në pjesën më të madhe të tyre vërehet mungesë e theksuar e ndërhyrjes efektive dhe të koordinuar ndërinstitutionale, si dhe mosaktivizim në kohë i mekanizmave mbrojtës, përfshirë urdhrat e mbrojtjes dhe ndjekjen penale të autorëve të dhunës.

Mangësitë në funksionimin e sistemit të referimit të rasteve, mungesa e një mekanizmi të unifikuar për vlerësimin e riskut, si dhe kapacitetet e kufizuara të strukturave mbështetëse – të shoqëruara shpesh me mungesë burimesh njerëzore dhe financiare – krijojnë një ambient të pasigurt për viktimat, duke i ekspozuar ato ndaj rrezikut të përsëritjes së dhunës. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve të shqyrtuara, ky rrezik është materializuar në akte të rënda kriminale me pasoja të parikthyeshme.

Rastet e vetëvrasjes të shkaktuara nga ushtrimi i dhunës, presionit të vazhdueshëm, izolimit social apo shantazhit përfaqësojnë një dimension shtesë të dhunës me pasoja ekstreme. Edhe pse akti final ndërmerret nga vetë viktimat, këto raste përbëjnë pasojë të drejtpërdrejtë të dështimit institucional për të siguruar mbrojtje të menjëhershme dhe mbështetje për të tejkaluar situatën e rrezikut. Analiza e rasteve tregon se shumica e viktimave kishin një histori të hershme dhe të përsëritur dhune, e cila nuk ishte adresuar në mënyrë të duhur nga institucionet përkatëse. Ky fakt dëshmon se aktet e rënda të dhunës nuk ndodhin papritur, por janë rezultat i një procesi gradual përshkallëzimi dhe i mungesës së reagimit institucional të menjëhershëm dhe efektiv për identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve.

53. Këtu përfshihen rastet e vrasjes së mbetur në tentativë dhe rastet e plagosjes së rëndë me dashje.

54. Historia e dhunës ndaj viktimave në këto raste vërtetohet nga vetë të mbijetuarat ose nga thëniet e dëshmitarëve.

55. Viktima S.A kishte qënë më parë e pajisur me UM ndaj bashkëjetuesit të saj. Nga dëshmia e dhënë nga nëna e viktimës, ajo kishte tentuar edhe më parë të ndërmerre aktin e vetëflijimit për shkak të konflikteve që kishte patur me bashkëjetuesin e saj, ajo kishte mundur të mbijetonte si rezultat i ndërhyrjes së menjëhershme dhe trajtimit spitalor.

KREU IV

ROLI I BASHKIVE DHE INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE NË TRAJTIMIN E RASTEVE PARA DHE PAS NGJARJES

4.1

Përmbledhje mbi analizimin e informacionit të sjellë nga bashkitë mbi rastet e krimeve ndaj grave dhe vajzave gjatë vitit 2024

Bazuar në analizën e të dhënave dhe dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore për çështjet objekt shqyrtimi gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka adresuar kërkesa zyrtare ndaj të gjitha bashkive në të cilat viktimat kishin vendbanimin e tyre, me qëllim sigurimin e informacionit mbi masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe mbështetjen e tyre.

Për rastet në të cilat viktimat kishin raportuar më parë raste dhune pranë policisë, informacioni i kërkuar nga Avokati i Popullit konsiston në:

- ⊙ Referimin e këtyre rasteve pranë koordinatorit ose punonjësit përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- ⊙ Trajtimin e këtyre rasteve nga MKR-të përkatëse;
- ⊙ Njohjen e rrezikshmërisë së autorëve ;
- ⊙ Monitorimin e respektimit të Urdhrit të Mbrojtjes nga Kordinatori Vendor apo punonjësi përgjegjës pranë Bashkisë;
- ⊙ Mbajtja e kontakteve me viktimën;
- ⊙ Bashkëpunimin e koordinatorit vendor apo punonjësit përgjegjës me policinë sa i përket monitorimit të UMM/UM;
- ⊙ Shërbimet që iu janë ofruar viktimave etj.

Në lidhje me rastet në të cilat viktimat nuk kishin raportuar më parë pranë organeve të policisë, informacioni i kërkuar është përqendruar në të dhënat e disponuara nga bashkitë mbi gjendjen dhe kushtet socio-ekonomike të viktimave, si dhe mbi përfitimin e mundshëm të shërbimeve sociale nga njësitë e vetëqeverisje vendore.

Në rastet kur viktimat kishin lënë pas fëmijë të mitur, kërkesa për informacion është fokusuar në rolin e punonjësve përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve për ta. Janë kërkuar të dhëna mbi llojin e shërbimeve të ofruara, masat e ndërmarra për garantimin e mirëqenies së fëmijëve, si dhe identifikimin e subjekteve që ushtrojnë kujdestarinë ligjore ndaj tyre.

Për rastet në të cilat autorët e ngjarjeve kanë rezultuar me probleme të shëndetit mendor, është kërkuar informacion mbi vlerësimin e rrezikshmërisë së këtyre personave, masat e ndërmarra nga bashkitë në rastet e evidentimit të dhunës, si dhe mbi ekzistencën dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse për familjet që kanë në përbërje persona me çrregullime të shëndetit mendor.

REAGIMI INSTITUCIONAL NË LIDHJE ME RASTET QË KISHIN RAPORTUAR MË PARË

Analiza e të dhënave tregon se në një numër të kufizuar rastesh (pesë raste), viktimat kishin raportuar më parë episode dhune pranë organeve të policisë. Megjithatë, këto raste nuk janë ndjekur më tej nga Mekanizmat e Koordinuar të Referimit dhe nuk janë përfshirë në programet mbështetëse që ofrohen nga bashkitë.

Rezultatet tregojnë se bashkëpunimi ndërinstytucional është aktivizuar vetëm pas ndodhjes së ngjarjeve të rënda, kur koordinatorët vendorë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, janë angazhuar në ofrimin e mbështetjes për të mbijetuarat e krimeve. Viktimat janë pajisur me urdhra mbrojtjeje (UMM/UM) menjëherë pas ngjarjeve, si masë e menjëhershme për sigurimin e mbrojtjes dhe parandalimin e dhunës së mëtejshme⁵⁶ dhe bashkitë kanë ofruar ndihmë ekonomike, paketa ushqimore dhe higjieno-sanitare, si dhe bonus qeraje për të mbijetuarat⁵⁷.

Janë ofruar shërbime psikosociale dhe shëndetësore si dhe mbështetje për rehabilitimin e pasojave fizike dhe psikologjike të dhunës në bashkëpunim me OJF-të që operojnë në bashkitë përkatëse. Këto organizata kanë luajtur një rol kyç në ofrimin e ndihmës për viktimat, zhvillimin e fushateve ndërgjegjësuere dhe ngritjen e kapaciteteve të insitucioneve përgjegjëse⁵⁸.

Në kuadër të mbështetjes për viktimat e dhunës, janë ofruar shërbime psikosociale dhe shëndetësore, si dhe ndihmë për rehabilitimin e pasojave fizike dhe psikologjike të dhunës, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse (OJF) që operojnë në bashkitë përkatëse. Këto organizata kanë luajtur një rol thelbësor në ofrimin e mbështetjes për viktimat, zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe forcimin e kapaciteteve të insitucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e tyre⁵⁹.

Megjithëse Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon që viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilat nuk trajtohen në insitucione të përkujdesjes shoqërore, përfitojnë ndihmë ekonomike gjatë periudhës së vlefshmërisë së **urdrave të mbrojtjes** apo të **urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM/UM)**⁶⁰, në praktikë rezulton se kjo ndihmë jepet vetëm për rastet kur urdhri i mbrojtjes ka afat zbatimi mbi një muaj.

56. Megjithatë pajisja me UMM/UM pas ngjarjes, tregon për vonesë në reagimin e hershëm.

57. Megjithatë bazuar në dëshmitë e të mbijetuarave dhe familjarëve të tyre, ndihma e ofruar ka qenë afatshkurtër dhe e pamjaftueshme.

58. Në informacionin e sjellë nga Bashkitë Tiranë dhe Korçë parashtrohet se organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” ka kontribuar në mbështetjen e disa prej viktimave nëpërmjet medikamenteve për rikuperimin shëndetësor si dhe ka ofruar veshje dhe mjete shkollore për fëmijët e viktimave.

59. Në informacionin e sjellë nga Bashkitë Tiranë dhe Korçë parashtrohet se organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” ka kontribuar në mbështetjen e disa prej viktimave nëpërmjet medikamenteve për rikuperimin shëndetësor si dhe ka ofruar veshjeve dhe mjeteve shkollore për fëmijët e viktimave.

60. Neni 7 pika d e ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për më tepër, vlera e ndihmës ekonomike (9,900 lekë në muaj) mbetet nën nivelin e standardit të minimumit jetik, sipas raportit të Avokatit të Popullit të vitit 2021 “Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri⁶¹”.

Gjithashtu, është siguruar ndjekja gjyqësore e çështjeve nga përfaqësuesit e bashkive, ndërkohë që rastet janë mbajtur nën monitorim të vazhdueshëm. Në shumë raste, ofrimi i shërbimeve është iniciuar ose plotësuar nga OJF-të që veprojnë në nivel vendor, të cilat kanë kontribuar ndjeshëm në garantimin e mbështetjes së menjëhershme dhe afatgjatë për viktimat.

NË LIDHJE ME RASTET QË NUK KISHIN DENONCUAR PËRPARA NGJARJES

Pjesa më e madhe e viktimave nuk kishin raportuar më parë raste dhune ndaj autorëve të krimit, fakt që nxjerr në pah dobësitë e sistemit në identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme, si edhe mungesën e besimit të viktimave tek institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tyre⁶². Analiza e rasteve evidenton në mënyrë të veçantë sa vijon:

- ⊙ **Mungesë të informacionit paraprak:** Bashkitë shpesh nuk dispononin të dhëna mbi viktimat apo nivelin e rrezikshmërisë së autorëve, veçanërisht në rastet e autorëve me çrregullime të shëndetit mendor.
- ⊙ **Mungesë të strukturave të specializuara:** Nuk ka një rrjet të shërbimeve për trajtimin e dhunuesve me probleme të shëndetit mendor. Në praktikë, këta individë, në rastin më të mirë, referohen për trajtim afatshkurtër në spitale psikiatrike, të cilat janë të mbingarkuara.
- ⊙ **Reagim të vonuar:** Në shumë raste, ndërhyrja institucionale ka ndodhur vetëm pas kryerjes së krimit, me fokus në ofrimin e ndihmës emergjente dhe jo në identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme në funksion të parandalimit të përshkallëzimit.
- ⊙ **Vështirësi në aksesin ndaj shërbimeve:** Në disa raste, viktimat nuk figuronin të regjistruara pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, çka ka sjellë vonesa në përfshirjen e tyre në skemat e mbështetjes sociale.
- ⊙ **Mbështetje të pjesshme pas ngjarjes:** Pas ngjarjes, mbështetja e ofruar ka rezultuar e fragmentuar dhe shpesh e kufizuar vetëm në shërbim mjekësor,

61. Raporti i Avokatit të Popullit “Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri”, viti 2021, mund të aksesohet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>;

62. Bazuar në intervistat me të mbijetuarat dhe familjarët e viktimave një nga shkaqet e mosraportimit të dhunës është edhe mungesa e besimit tek autoritetet përgjegjëse.

këshillim psikologjik ose asistencë të përkohshme, pa një plan të integruar rehabilitimi afatgjatë.

- ⊙ **Raste me fëmijë të mitur – përfshirja e mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve**
- ⊙ Në rastet kur viktimat kishin fëmijë të mitur, përgjatë analizës është konstatuar:
- ⊙ **Ofrimi i shërbimeve pas ngjarjes nga Punonjësit për Mbrojtjen e fëmijëve,** shërbimet e ofruara kanë përfshirë:
 - Këshillim psikologjik për fëmijët
 - Mbështetje me ndihmë ekonomike
- ⊙ **Nevojë për një sistem më të strukturuar e të qëndrueshëm mbështetjeje,** veçanërisht për kujdestarët që mbeten me përgjegjësinë e rritjes së fëmijëve, shpesh në kushte të vështira psiko-sociale dhe ekonomike.
- ⊙ **Mungesë e ndërhyrjeve parandaluese** edhe në rastet kur institucionet kishin dijeni paraprake për situata dhune, veçanërisht në raport me autorë që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor
- ⊙ **Mungesë strukturash të specializuara** për trajtimin dhe rehabilitimin e autorëve të dhunës me çrregullime të shëndetit mendor.
- ⊙ **Vonesë në reagimin institucional** pas ngjarjeve. Në disa bashki mungon informacioni për shërbime të ofruara për fëmijët dhe familjet pas kryerjes së krimit
- ⊙ **Vështirësi për përfitim të bonuseve të qirasë** për shkak të mungesës së kontratave të rregullta ose refuzimi i pronarëve privatë për t'i formalizuar ato.

GJETJET MBI ROLIN E STRUKTURAVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Bazuar në analizën e rolit, funksioneve dhe përgjegjësive të institucioneve të vetëqeverisjes vendore në adresimin e dhunës me bazë gjinore, rezulton se mekanizmat vendorë të referimit vijnë të funksionojnë me kapacitete të pabarabarta dhe, në një numër të konsiderueshëm rastesh, të pamjaftueshme për të garantuar një reagim gjithëpërfshirës, të koordinuar dhe të qëndrueshëm. Këto pabarazi reflektohen si në mungesën e burimeve njerëzore të specializuara, ashtu edhe në kapacitetet e kufizuara financiare dhe organizative, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë, shpejtësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve në nivel vendor.

Shërbimet psikosociale, të cilat përbëjnë një komponent thelbësor të sistemit të mbrojtjes dhe rehabilitimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore, rezultojnë të

kufizuara si në shtrirje gjeografike, ashtu edhe në kapacitetet funksionale. Këto shërbime nuk ofrohen në mënyrë të barabartë dhe të aksesueshme në të gjithë territorin, duke krijuar pabarazi të dukshme midis zonave urbane dhe atyre rurale. Veçanërisht në zonat e thella dhe me infrastrukturë të kufizuar, mungesa e shërbimeve psikosociale përforcon izolimin e viktimave dhe pengon aksesin në mekanizmat e mbrojtjes, duke kufizuar ndjeshëm mundësitë për ndërhyrje të hershme, trajtim të vazhdueshëm dhe integrim social efektiv. Në këtë kontekst, mbështetja afatgjatë për gratë e mbijetuara nga krimet, si dhe për familjarët e viktimave të vetëvrasjeve të lidhura me dhunën, rezulton e fragmentarizuar dhe kryesisht e përkohshme, e orientuar më së shumti drejt ndërhyrjeve emergjente dhe jo drejt ndërtimit të mekanizmave të qëndrueshëm të rehabilitimit, riintegrit social dhe fuqizimit ekonomik.

Gjithashtu, vërehet mungesa e një mekanizmi të institucionalizuar për ndjekjen sistematike të rasteve me histori të përsëritur dhune, si dhe mungesa e skemave të dedikuara mbështetëse për kujdestarët ligjorë të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Këto boshllëqe strukturore dhe institucionale kufizojnë ndjeshëm kapacitetin parandalues të sistemit dhe reduktojnë efektivitetin e ndërhyrjeve në nivel vendor, duke krijuar kushte për përshkallëzimin e dhunës dhe përsëritjen e rasteve me pasoja ekstreme.

Në këtë drejtim, është e domosdoshme forcimi i mekanizmave të monitorimit, koordinimit dhe mbështetjes së integruar në nivel lokal, me synim ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm që garanton reagim të menjëhershëm, parandalim efektiv dhe rehabilitim afatgjatë të viktimave të dhunës me bazë gjinore.

4.2 Roli i institucioneve shëndetësore në identifikim, trajtim dhe parandalim

Megjithëse institucionet shëndetësore mbartin detyrimin ligjor për të ofruar ndihmë mjekësore, sociale dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje, si dhe për të evidentuar çdo rast dhune në dokumentacionin përkatës mjekësor dhe për t'i pajisur viktimat me raportet mjekoligjore përkatëse⁶³, analiza e të dhënave të mbledhura nga këto institucione tregon mungesë të një reagimi të strukturuar, të qëndrueshëm dhe të koordinuar ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

63. Neni 7/2 i Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, parashikon : Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore: a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje; b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse; c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës; d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Në lidhje me rastet objekt shqyrtimi, rezulton se shumica e viktimave janë trajtuar në institucionet spitalore vetëm pas ndodhjes së ngjarjeve të rënda, kur u është ofruar ndihmë mjekësore emergjente për plagët fizike apo traumat e shkaktuara. Ndërkohë, nga analiza e të dhënave rezulton se asnjë prej viktimave nuk ishte identifikuar apo trajtuar më herët nga shërbimet shëndetësore si viktimë e dhunës me bazë gjinore.

Kjo situatë evidenton mungesën e një mekanizmi funksional dhe efektiv për identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës, si dhe një përfshirje të pamjaftueshme të sistemit shëndetësor në rrjetin ndërinstitucional të parandalimit dhe mbrojtjes. Si pasojë, **kufizohet ndjeshëm mundësia për ndërhyrje të hershme, referim të strukturuar dhe parandalim të përshkallëzimit të dhunës**, duke rritur rrezikun për pasoja të rënda dhe ekstreme për viktimat.

Gjithashtu, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e institucioneve shëndetësore nuk disponojnë regjistra të posaçëm për evidentimin dhe gjurmimin e rasteve të dhunës ndaj grave, nuk plotësojnë kartela klinike individuale në përputhje me protokollat përkatëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe nuk pajisin viktimat me raportin e posaçëm mjekësor, i cili është thelbësor për ndjekjen e mëtejshme institucionale dhe vërtetimin e dhunës së ushtruar përpara gjykatës.

GJETJET MBI ROLIN E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Bazuar në analizën e kryer mbi rolin, kapacitetet dhe praktikën e institucioneve shëndetësore në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, konstatohet se këto institucione vijnë të përballen me vështirësi të konsiderueshme në identifikimin e hershëm dhe sistematik të rasteve të dhunës, si dhe në ushtrimin e një qasjeje proaktive dhe parandaluese. Këto vështirësi manifestohen veçanërisht në situatat kur viktimat nuk e raportojnë drejtpërdrejt dhunën e ushtruar, për shkak të frikës, varësisë emocionale apo ekonomike, si dhe të presionit social.

Njëkohësisht, sfida të veçanta evidentohen edhe në rastet ku përfshihen persona me çrregullime të shëndetit mendor, të cilat kërkojnë vlerësime të specializuara, ndërhyrje të koordinuara dhe një qasje të integruar ndërmjet shërbimeve shëndetësore, sociale dhe strukturave të tjera përgjegjëse, në funksion të parandalimit të përshkallëzimit të dhunës dhe garantimit të mbrojtjes së viktimave. Nga analiza e të dhënave rezulton se gjatë vitit 2024 institucionet shëndetësore kanë raportuar trajtimin e vetëm shtatë rasteve të dhunës në familje, kjo shifër nxjerr në pah një nivel tepër të ulët ndërhyrjeje dhe evidenton mangësi strukturore në kapacitetin e sistemit shëndetësor për të identifikuar, dokumentuar dhe referuar në mënyrë efektive rastet e dhunës. Veçanërisht problematike paraqitet fakti se në asnjë prej rasteve të trajtuara viktimat nuk janë pajisur me raportin e posaçëm mjekësor, pavarësisht detyrimit ligjor për lëshimin e këtij dokumenti menjëherë pas ndërhyrjes shëndetësore.

Paralelisht, analiza eidenton se koordinimi ndërinstytucional ndërmjet institucioneve shëndetësore, Policisë, Prokurorisë dhe gjykatave vijon të mbetet i dobët, i paformalizuar dhe i fragmentuar, në mungesë të protokolleve të qarta dhe funksionale për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e institucioneve për të reaguar në mënyrë të shpejtë, të koordinuar dhe efektive, veçanërisht në rastet me rrezik të lartë.

Si pasojë, cenohet jo vetëm mbrojtja reale dhe në kohë e viktimave, por edhe garantimi i sigurisë së kujdestarëve dhe familjarëve të tyre. Në këtë kontekst, mbetet e domosdoshme forcimi i rolit të institucioneve shëndetësore si hallkë kyçe në parandalimin e dhunës me bazë gjinore, përmes rritjes së kapaciteteve profesionale dhe institucionalizimit të mekanizmave të qëndrueshëm dhe funksionalë të koordinimit ndërinstytucional.

4.3

Pasojat e krimeve të rënda ndaj grave dhe vajzave përtej viktimave të drejtpërdrejta

Përtej viktimave të drejtpërdrejta, krimet e rënda ndaj grave, përfshirë femicidin, shoqërohen me pasoja të thella dhe afatgjata për një rreth më të gjerë personash, të cilët preken drejtpërdrejt nga këto ngjarje traumatike. Familjarët e viktimave, përfshirë fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, mbeten shpesh të anashkaluar nga vëmendja institucionale, pavarësisht se përballen me pasoja të rënda psikologjike, sociale dhe ekonomike.

Veçanërisht fëmijët që mbeten jetimë si pasojë e femicidit, si dhe ata që jetojnë me traumat e rënda fizike dhe psikologjike të nënave të tyre të mbijetuara nga krime të rënda, rriten të ekspozuar ndaj pasigurive të vazhdueshme, problemeve serioze emocionale dhe, në shumë raste, mungesës së një strukture të qëndrueshme kujdestarie dhe mbështetjeje. Këta fëmijë nuk janë vetëm dëshmitarë të dhunës, por edhe bartës të pasojave afatgjata të saj, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre emocional, arsimor dhe social.

Pavarësisht kësaj, mbështetja institucionale për familjarët e viktimave dhe për fëmijët e prekur nga femicidi mbetet e fragmentuar, e paqëndrueshme dhe e pamjaftueshme, duke reflektuar mungesën e një qasjeje të integruar dhe afatgjatë për adresimin e nevojave të tyre dhe për garantimin e mbrojtjes dhe rehabilitimit të plotë social⁶⁴.

64. Shih raportin e parë mbi femicidet përgatitur nga Avokati i Popullit, faqe 60, mbi mbështetjen financiare të fëmijëve të viktimave si dhe Raportin e Avokatit të Popullit "Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri", të vitit 2021, i cili gjendet në linkun: <file:///C:/Users/pc/Downloads/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>

KREU V

HETIMI DHE GJYKIMI I KRIMEVE NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE: VRASJET, TENTATIVAT PËR VRASJE, PLAGOSJET E RËNDA DHE SHKAKTIMI I VETËVRASJES

5.1

Roli i Policisë dhe Prokurorisë në Hetimin e Krimeve ndaj Grave dhe Vajzave dhe Identifikimin e Motiveve Gjinore

Roli i Policisë së Shtetit dhe i Prokurorisë në hetimin e krimeve ndaj grave dhe vajzave është thelbësor, jo vetëm për garantimin e drejtësisë për viktimat, por edhe për parandalimin e dhunës dhe adresimin e faktorëve strukturorë dhe individualë që e nxisin dhe e përforcojnë atë. Efektiviteti i ndërhyrjes së këtyre institucioneve ndikon drejtpërdrejt në nivelin e mbrojtjes së viktimave dhe në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Si hallka kyçe në zinxhirin e reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore, Policia dhe Prokuroria mbajnë përgjegjësi të posaçme për zhvillimin e hetimeve profesionale, të pavarura dhe të ndjeshme ndaj perspektivës gjinore. Kjo përfshin identifikimin dhe dokumentimin e saktë të motiveve gjinore, shmangien e paragjytimeve dhe stereotipeve gjinore, si dhe ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të nevojshme për trajtimin adekuat të këtyre krimeve.

Hetimi i rasteve të dhunës ndaj grave duhet të kryhet me një nivel të lartë profesionalizmi dhe me njohje të thellë të dinamikave komplekse të dhunës⁶⁵, të cilat shpesh karakterizohen nga marrëdhënie pushteti, kontrolli dhe varësie emocionale apo ekonomike. Në shumicën e rasteve objekt shqyrtimi në këtë raport, autorët janë persona me të cilët viktimat kanë pasur ose vazhdojnë të kenë marrëdhënie të afërta familjare apo intime, çka e bën të domosdoshme aplikimin e një qasjeje të specializuar hetimore për të kuptuar kontekstin e dhunës dhe për të identifikuar në mënyrë të qartë motivet gjinore që qëndrojnë në themel të këtyre veprave penale.

5.2

Analiza e Vendimeve Gjyqësore sipas veprave penale objekt monitorimi

Analiza e vendimeve gjyqësore përbën një komponent thelbësor për të kuptuar mënyrën se si sistemi i drejtësisë penale trajton krimet e rënda ndaj grave, përfshirë vrasjet, tentativat për vrasje, plagosjet e rënda me dashje dhe veprën penale të shkaktimit të vetëvrasjes. Kjo analizë mundëson vlerësimin e qasjes së gjykatave ndaj këtyre veprave penale, shqyrtimin e praktikës gjyqësore në raport me identifikimin

65. Raporti tematik i GREVIO për Shqipërinë i vitit 2024, lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve ndaj grave, evidenton se prokurorët dhe gjyqtarët shpesh nuk e kanë këndvështrimin gjinor të nevojshëm, nuk e kuptojnë plotësisht dinamikën e dhunës ndaj grave, dhe mund të kenë ndikime të paragjytimeve që pengojnë zbatimin e drejtë të ligjit.

dhe trajtimin e motiveve gjinore, si dhe evidentimin e tendencave në vendimmarrje, në llojin dhe masën e dënimeve, si edhe në arsyetimin ligjor të përdorur.

Për shkak të zgjatjes në kohë të procedimeve gjyqësore, një pjesë e konsiderueshme e çështjeve objekt shqyrtimi vijojnë të ndodhen në fazën e hetimit ose të gjykimit, duke kufizuar mundësinë për një vlerësim të plotë dhe përfundimtar të praktikës gjyqësore për të gjitha rastet e përfshira në raport.

Nga 18 rastet, objekt shqyrtimi vetëm 9 çështje kanë përfunduar në shkallë të parë, nga të cilat 2 çështje janë ankimuar dhe është dhënë vendimi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në vendimet gjyqësore të analizuara përfshihen kategoritë e mëposhtme të çështjeve:

Dy raste të vrasjes së grave, në të cilat autorët rezultojnë persona me probleme të shëndetit mendor, të cilët kanë vrarë nënat e tyre. Për këto raste, gjykatat kanë vendosur masën e sigurimit dhe trajtimin “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, në përputhje me vlerësimin e gjendjes mendore të autorëve.

Dy raste të vrasjes së mbetur në tentativë. Në njërin rast, babai qëlloi me armë gjahu vajzën e tij, pas përkeqësimit të marrëdhënieve familjare si pasojë e mospranimit të divorcit të saj nga bashkëshorti ⁶⁶. Duke qenë se autori u vetëvra menjëherë pas kryerjes së ngjarjes, gjykata vendosi pushimin e çështjes penale.

Në rastin tjetër, bashkëshorti tentoi të vriste bashkëshorten, duke i shkaktuar plagë të shumta në trup dhe në kokë. Për këtë vepër penale, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e dënoi autorin me 30 (tridhjetë) vjet burgim⁶⁷.

Dy raste të plagosjes së rëndë me dashje, ku në njërin prej rasteve, djali me probleme të shëndetit mendor plagosi nënën e tij, gjykata vendosi masën “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” për autorin. Në rastin tjetër, dy motra plagosën rëndë një vajzë të njohur prej tyre, për të cilin gjykata caktoi masa dënimi të ndryshme, në përputhje me rolin konkret të secilës në kryerjen e veprës penale ⁶⁸.

Dy raste të shkaktimit të vetëvrasjes. Në njërin rast, viktima ndërmori aktin e vetëflijimit së bashku me tre fëmijët e saj të mitur, duke u vetëmbytur në lumin Buna. Autori i veprës penale të shkaktimit të vetëvrasjes u dënua me

66. Vendimi nr.254, datë 19.02.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Në dëshmitë e dhëna përpara oficerit të policisë gjyqësore e mbijetuara e krimit K.Q, parashtron se nuk kishte patur debate me babain e saj në momentin e ngjarjes, por ai nuk e pranonte dot faktin e ndarjes së saj nga bashkëshorti dhe ndjente turp përballë opinionit publik.

67. Vendimi nr.2005 datë 28.07.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

68. Njëra nga bashkëautorët e cila u provua se kishte rolin kryesor në kryerjen e krimit u dënua me tre vite burg, por dënimi iu ul në dy vite, për shkak të pranimit të gjykimit të shkurtuar. Ndërsa motra e saj u dënua me tre vite shërbim prove, të reduktuara në dy vite nën të njëjtin mekanizëm lehtësues.

4 (katër) vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁶⁹, vendim i cili u la në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në rastin tjetër, autori i shkakimit të vetëvrasjes së bashkëshortes së tij u dënua me 10 (dhjetë) vjet burgim nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës për veprat penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, municionit dhe lëndëve shpërthyesë”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal⁷⁰. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁷¹.

Vendimet e analizuara janë dhënë nga gjykatat e rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër dhe Lezhë⁷², duke pasqyruar praktikën gjyqësore të këtyre gjykatave në trajtimin e krimeve të rënda ndaj grave. Në lidhje me kualifikimin juridik të veprave penale, analiza tregon se në asnjë nga rastet e shqyrtuara gjykatat nuk kanë ndryshuar kualifikimin ligjor të përcaktuar nga organi i prokurorisë.

Gjatë analizimit të kërkesave për gjykim dhe të vendimeve gjyqësore, është konstatuar se një pjesë e prokurorëve⁷³ dhe gjyqtarëve janë **referuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, duke e përdorur atë si një burim interpretimi për të forcuar arsyetimin ligjor dhe për të garantuar një standard më të lartë mbrojtjeje për të drejtat themelore⁷⁴. Megjithatë, përdorimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së nuk është ende i qëndrueshëm apo i njëtrajtshëm në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duke reflektuar nevojën për forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit juridik mbi rëndësinë e saj në praktikën gjyqësore.

Në lidhje me qëndrimin e autorëve gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjeve, rezulton se në rastet e vrasjeve, vrasjeve të mbetura në tentativë dhe plagosjeve të rënda me dashje, autorët në përgjithësi e kanë pranuar akuzën e ngritur ndaj tyre. Megjithatë, gjatë procesit gjyqësor u konstatuan përpjekje të vazhdueshme për të justifikuar veprën penale të kryer ose për të minimizuar pasojat e saj, duke relativizuar shkallën dhe ashpërsinë e dhunës së ushtruar.

69. Vendimi nr.713, datë 25.02.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

70. Vendimi nr.1109, datë 11.12.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

71. Njëra nga bashkëautorët e cila u provua se kishte rolin kryesor në kryerjen e krimit u dënua me tre vite burg, por dënimi iu ul në dy vite, falë pranimit të gjyqësorit të shkurtuar. Ndërsa motra e saj u dënua me tre vite shërbim prove, të reduktuara në dy vite nën të njëjtin mekanizëm lehtësues.

72. Rezulton se në 6 raste, vendimet kanë marrë formë të prerë.

73. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në arsyetimin e kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim, ndaj shtetasit A.Q i akuzuar për veprën penale të shkakimit të vetëvrasjes (neni 99 i KP) dhe përndjekjes (neni 121/a/2 i KP) shprehet se pavarësisht se legjislacioni ynë penal nuk e ka parashikuar përndjekjen përmes platformave online, jurisprudenca e GJEDNJ në çështjen “Volodina kundër Rusisë” (nr.2), faqe 52, ka theksuar se aktet e dhunës kibernetike në çështjen në fjalë ishin të mjaftueshme për të kërkuar një përgjigje penale nga ana e autoriteteve vendase. Publikimi i fotografive intime të saj kishin për qëllim poshtërimin dhe denigrimin e saj.

74. Këto referime shërbejnë për të harmonizuar praktikën gjyqësore vendase me standardet evropiane dhe për të siguruar që vendimet gjyqësore të jenë në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar.

Ndërsa në rastet e shkaktimit të vetëvrasjes, autorët në mënyrë të përsëritur nuk kanë pranuar përgjegjësinë për ndikimin e veprimeve dhe sjelljeve të tyre në përkeqësimin e gjendjes psiko-emocionale të viktimave, deri në ndërmarrjen e aktit të vetëfljimit. Në këto raste, evidentohet një tendencë e qartë për ta lidhur aktin e vetëvrasjes kryesisht me problematika individuale psiko-emocionale të viktimës, duke mohuar ose minimizuar rolin e dhunës, presionit dhe sjelljeve abuzive të ushtruara nga vetë autorët.

5.3 Monitorimi i seancave Gjyqësore

Monitorimi i seancave gjyqësore përbën një mekanizëm thelbësor për vlerësimin e respektimit të të drejtave procedurale të palëve, si dhe për analizimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor dhe standardet ndërkombëtare për administrimin e drejtësisë.

Në vijim të analizës së informacionit të përcjellë nga strukturat përgjegjëse dhe identifikimit të çështjeve që kishin kaluar në fazën e gjykimit, vijoi procesi i monitorimit të seancave gjyqësore edhe gjatë vitit 2025, me qëllim vlerësimin e mënyrës së trajtimit gjyqësor të rasteve të dhunës ekstreme ndaj grave.

Në këtë kuadër, u monitoruan gjithsej katër çështje gjyqësore, prej të cilave dy pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe dy pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këto çështje autorët u gjykuan në lidhje me veprat penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentativë, nenet 79/c dhe 22 i Kodit penal dhe “Shkaktimi i vetëvrasjes”, parashikuar në nenin 99 të Kodit Penal.

Në lidhje me çështjen në të cilën autori u gjykua për veprën penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, e mbetur në tentativë, rezultoi se organi i prokurorisë kishte kryer hetime të plota dhe të thelluara, ndërsa viktimja, së bashku me disa prej familjarëve të saj, mori pjesë aktive në procesin gjyqësor.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, u ripyet vajza e viktimës dhe e autorit, e cila, në deklaratimet e saj, shfaqti prirje për të minimizuar dhunën e ushtruar ndaj nënës, me qëllim lehtësimin e pozitës së autorit përpara trupit gjykues. Njëkohësisht, edhe vetë viktimja paraqiti qëndrime që relativizonin ashpërsinë e dhunës së përjetuar, duke tentuar të ndikojë në mënyrën e vlerësimit dhe trajtimit të rastit nga gjykata.

Ky qëndrim i palëve vë në pah kompleksitetin e rasteve të dhunës në familje dhe nevojën për një vlerësim të kujdesshëm gjyqësor, të mbështetur jo vetëm në deklaratimet e subjekteve të përfshira, por edhe në provat objektive dhe në kontekstin e mëparshëm të dhunës.

Ndërkohë, në një çështje tjetër, në të cilën i pandehuri u gjykua për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, u zhvilluan gjithsej dymbëdhjetë seanca gjyqësore. I pandehuri u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur privatisht dhe mbajti një qëndrim mohues ndaj akuzës së ngritur. Familjarët e viktimës morën pjesë aktive në seancat gjyqësore, duke shprehur në mënyrë të qartë kërkesën për dhënien e drejtësisë dhe për ndëshkimin e autorit në përputhje me ligjin, si dhe u përfaqësuan nga avokatë të zgjedhur privatisht gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Sa i përket shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u monitoruan gjithsej katër seanca gjyqësore. Këto seanca u zhvilluan në mungesë të trashëgimtarëve të viktimave, rrethanë e cila u evidentua në kuadër të procesit të monitorimit.

KONSTATIME NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E MONITORUARA

Rastet e monitoruara u trajtuan duke reflektuar një shkallë të kënaqshme ndjeshmërie ndaj kontekstit të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht përmes analizimit të rrethanave që lidhen me historikun e dhunës në marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe të pandehurit. Ky element është me rëndësi thelbësore për vlerësimin e rrezikshmërisë së situatës dhe për kuptimin e dinamikave të dhunës, të cilat shpesh karakterizohen nga cikle të përsëritura dhe përshkallëzuese.

Proceset gjyqësore u zhvilluan në përputhje me rregullat procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Gjatë shqyrtimit u evidentuan disa shtyrje të seancave gjyqësore, të cilat, megjithatë, nuk rezultuan të kenë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi procedimet përfunduan brenda një periudhe kohore nga katër deri në tetë muaj.

Akuzat e ngritura nga organi i prokurorisë rezultuan të mbështetura në provat e administruara dhe në rrethanat faktike të çështjeve, duke reflektuar një kualifikim juridik të përshtatshëm të veprave penale. Dënimet e dhëna nga gjykatat u vlerësuan si proporcionale me ashpërsinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale.

Nga monitorimi i kryer, nuk u konstatuan elemente që të tregonin ndërhyrje apo ndikim të faktorëve të jashtëm në zhvillimin dhe shqyrtimin e çështjeve gjyqësore. Megjithatë, ruajtja e kësaj pavarësie kërkon vijimësi në monitorim dhe vëmendje të shtuar institucionale, veçanërisht në çështjet që lidhen me dhunën me bazë gjinore,

të cilat për nga natyra e tyre janë komplekse dhe me ndjeshmëri të lartë shoqërore. Për autorët e veprave penale, ofrimi i ndihmës juridike falas gjatë procedimit penal është i garantuar nga legjislacioni në fuqi, ndërsa për viktimat e krimit dhe familjarët e tyre kjo formë mbështetjeje ofrohet vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj dhe pas ndjekjes së një procedure të veçantë ligjore, e cila lidhet me paraqitjen pranë gjykatës të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore falas⁷⁵.

Nga monitorimi i çështjeve të përfshira në këtë raport rezulton se, në asnjë prej tyre, viktimat e mbijetuara apo familjarët e viktimave nuk kanë përfituar mbështetje në formën e ndihmës juridike dytësore falas. Kjo situatë evidencën pengesa praktike dhe procedurale në aksesin real të viktimave ndaj kësaj të drejte, pavarësisht parashikimeve ligjore ekzistuese.

Mungesa e një aksesimi efektiv në ndihmën juridike dytësore falas krijon pabarazi të ndjeshme ndërmjet palëve në procesin penal dhe cenon parimin e barazisë. Në këtë kontekst, konstatohet se sistemi i drejtësisë penale mbetet ende i orientuar kryesisht drejt garantimit të të drejtave procedurale të të pandehurit, ndërkohë që mbrojtja dhe fuqizimi i pozitës së viktimave kërkon përmirësime të mëtejshme strukturore dhe procedurale.

GJETJET MBI ROLIN E ORGANEVE PROCEDUESE

Gjetjet që lidhen me rolin e strukturave të Policisë

Nga analiza e përgjigjeve institucionale, rezulton se reagimi institucional ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore vijon të paraqesë disa mangësi, të reflektuara në ndërhyrje të vonuara ose jo të njëtrajtshme nga strukturat e Policisë, si dhe në mungesë të një veprimi sistematik dhe proaktiv, të bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe parandalimin e përshkallëzimit të dhunës. Këto elemente tregojnë se, pavarësisht detyrimeve ligjore dhe rolit kyç që Policia ka në zinxhirin e mbrojtjes, ndërhyrja shpesh mbetet reaktive dhe e fragmentuar.

Një problematikë e veçantë lidhet me mungesën e monitorimit të strukturuar dhe të vazhdueshëm të rasteve me histori të përsëritur dhune, çka rrit ndjeshëm rrezikun për përshkallëzim deri në pasoja fatale. Në këtë kuadër, konstatohet edhe mungesa e mekanizmave të qartë, të specializuar dhe funksionale për identifikimin dhe parandalimin e vetëvrasjeve apo situatave të rrezikut ekstrem të lidhura me dhunën me bazë gjinore, duke kufizuar ndjeshëm kapacitetin e ndërhyrjes së hershme.

Po ashtu, evidentohet nevoja për forcimin e kapaciteteve profesionale të efektivëve të Policisë, veçanërisht në drejtim të identifikimit të rasteve me rrezik të lartë, përdorimit me efikasitet të lartë të instrumenteve të vlerësimit të rrezikut dhe zbatimit të standardeve të unifikuara të trajtimit të rasteve. Paralelisht, mbetet e

75. Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", neni 11, 12 dhe 19.

domosdoshme përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, administrimit dhe analizës së të dhënave, në mënyrë që informacioni i disponueshëm të përdoret në funksion të parandalimit dhe vendimmarrjes së informuar.

Gjetjet në lidhje me rolin e prokurorive dhe gjykatave

Analiza e praktikës së ndjekur nga prokuroritë dhe gjykatat në trajtimin e këtyre çështjeve evidenton se trajtimi institucional i këtyre çështjeve nuk garanton zbatimin e qëndrueshëm dhe të harmonizuar të standardeve të Konventës së Stambollit dhe të jurisprudencës përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Rezulton se organet proceduese nuk fokusohen në kryerjen e analizës së motiveve gjinore, ndërsa vlerësimi i historikut të dhunës në marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe autorit kryhet në mënyrë jo të thelluar dhe fragmentare.

Evidentohet mungesa e udhëzimeve specifike për gjykatat mbi trajtimin e krimeve të lidhura me motive gjinore, gjë që sjell mungesë unifikimi në praktikën gjyqësore dhe dallime të ndjeshme në cilësinë dhe përmbajtjen e vendimmarrjes.

Bashkëpunimi ndërinstitutional ndërmjet prokurorive, gjykatave, Policisë së Shtetit dhe shërbimeve mbështetëse për viktimat mbetet i fragmentuar dhe jo gjithmonë funksional, pa mekanizma të qëndrueshëm koordinimi.

Procedurat gjyqësore nuk garantojnë gjithmonë dëgjimin e sigurt dhe dinjitoz të të mbijetuarave dhe familjarëve të tyre, duke rritur rrezikun e riviktimizimit dhe duke cenuar respektimin e plotë të të drejtave themelore.

Nga ana tjetër, analiza tregon se hetimi dhe gjykimi i çështjeve të përfunduara janë realizuar brenda afateve të arsyeshme ligjore, megjithatë është e nevojshme që të merren masa shtesë nga organet proceduese me qëllim që këto çështje të trajtohen në afate sa më të shpejta kohore, për të parandaluar riviktimizimin e të mbijetuarave dhe familjarëve të tyre si dhe për të siguruar efektivitetin e hetimeve dhe përgjegjësinë e autorëve.

Në çështjet e përfunduara, masat e dënimit ndaj autorëve kanë qenë përgjithësisht në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore përkatëse, megjithatë, një analizë më e thelluar e motiveve gjinore do të mundësonte një përshtatje më efektive dhe proporcionale të masave ndëshkuese.

Analiza e praktikës gjyqësore tregon se në asnjë nga rastet e shqyrtuara gjykatat nuk kanë parashikuar, si masë plotësuese, detyrimin e autorëve për pjesëmarrje në programe rehabilitimi apo ndërhyrjeje të specializuara. Kjo qasje reflekton një përdorim të kufizuar të instrumenteve parandaluese të parashikuara nga kuadri ligjor dhe bie ndesh me detyrimin pozitiv të shtetit për të ndërmarrë masa efektive për parandalimin e përsëritjes së dhunës.

KREU VI

REKOMANDIME

6.1

Rekomandime të tjera në vijim të rekomandimeve të raportit të parë⁷⁶

Në raportin e parë të hartuar nga Avokati i Popullit mbi vrasjen e grave dhe vajzave, si dhe fenomenin e femicidit në Shqipëri për periudhën 2021-2023, u paraqitën një sërë rekomandimesh të përgjithshme dhe specifike, të orientuara drejt adresimit të boshllëqeve ligjore dhe institucionale në fushën e parandalimit të dhunës ekstreme ndaj grave, forcimit të mekanizmave të mbrojtjes së viktimave dhe përmirësimit të procedimit penal ndaj autorëve.

Këto rekomandime përfshinin, ndër të tjera, nevojën për hartimin e strategjive të posaçme për parandalimin e femicidit, forcimin e koordinimit ndërinstitutional, ngritjen dhe konsolidimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat dhe trashëgimtarët e tyre, si dhe shqyrtimin e mundësisë për përfshirjen e femicidit si vepër penale e veçantë në Kodin Penal.

Në vijim të raportit të parë, raporti aktual zgjeron spektrin e çështjeve objekt shqyrtimi, dhe fokusohet në analizën e rasteve të ndodhura gjatë vitit 2024. Gjetjet e këtij raporti evidentojnë se, pavarësisht ndërmarrjes së disa masave në sektorë të caktuar, një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të paraqitura në raportin e parë mbeten ende të pazbatuara ose janë zbatuar në mënyrë të pjesshme. Kjo situatë tregon për nevojën e një angazhimi më të qëndrueshëm institucional dhe të një qasjeje më sistematike në adresimin e fenomenit të femicidit dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.

Për këto arsye, rekomandimet e paraqitura në vijim nuk synojnë të përsërisin rekomandimet e formuluar në raportin e parë, por të shërbejnë si një përforcim dhe thellim i tyre, të ndërtuar mbi analizën e të dhënave, identifikimin e tendencave dhe vlerësimin e sfidave të reja të evidentuara gjatë vitit 2024.

Në këtë kontekst, ato synojnë forcimin e ndërhyrjes institucionale në mënyrë të koordinuar dhe efektive, adresimin e formave të tjera të rënda dhe komplekse të dhunës me bazë gjinore, si dhe garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të qëndrueshme ndaj të mbijetuarave dhe familjarëve të viktimave, duke vënë në qendër mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe nevojat specifike që burojnë nga këto raste.

76. Shih raportin “Vrasjet e grave dhe femicidi në Shqipëri 2021-2023”, faqe 61.

6.2 Rekomandime të përgjithshme

Në funksion të parandalimit të femicidit dhe formave të tjera të rënda të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe për garantimin e mbështetjes efektive për të mbijetuarat dhe familjarët e viktimave, rekomandohet ndërmarrja e masave të koordinuara dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet institucionale, si vijon:

- ⊙ **Kuvendi i Shqipërisë** duhet të përshpejtojë procesin e rishikimit dhe amendimit të legjislacionit civil dhe penal, me qëllim trajtimin e plotë dhe të integruar të të gjitha formave të dhunës ndaj grave, në përputhje me standardet dhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, përfshirë Komitetin CEDAW, GREVIO dhe mekanizmin e Rishikimit Periodik Universal (UPR);
- ⊙ **Rishikimi i Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**, me synim përfshirjen e të mbijetuarave nga krimet që lidhen me dhunën ndaj grave dhe të trashëgimtarëve të viktimave në kategoritë e veçanta të përfituesve, si dhe thjeshtimin dhe lehtësimin e procedurave për përfitimin e ndihmës juridike dytësore falas, me qëllim garantimin e aksesit real dhe efektiv të tyre në drejtësi;
- ⊙ **Forcimi i rolit dhe përgjegjësi të institucioneve qendrore dhe vendore** në zbatimin efektiv të legjislacionit për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, përmes ndërhyrjeve të koordinuara, mekanizmave të qartë përgjegjësie dhe monitorimit të vazhdueshëm, me qëllim ofrimin e mbrojtjes reale, të qëndrueshme dhe efektive për gratë dhe vajzat në rrezik;
- ⊙ **Përmirësimi i koordinimit ndërsektorial** ndërmjet institucioneve përgjegjëse, me synim unifikimin, harmonizimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave, në funksion të ndërtimit të politikave të bazuara në evidencë dhe forcimit të mekanizmave të parandalimit dhe reagimit institucional;
- ⊙ **Sigurimi i mbështetjes së vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse për të mbijetuarat nga krimet dhe trashëgimtarët e viktimave**, përmes ofrimit të asistencës ekonomike, mbështetjes psikologjike, ndihmës juridike dhe shërbimeve të tjera të nevojshme, në mënyrë që nevojat e tyre të adresohen në mënyrë të koordinuar, efektive dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut;
- ⊙ Ofrimi i mbështetjes së posaçme për të miturit e prekur nga femicidi ose nga krime të tjera të rënda të kryera ndaj nënave të tyre, përmes sigurimit të ndihmës ekonomike, mbështetjes psikologjike dhe asistencës juridike, si dhe përmes ndjekjes së vazhdueshme dhe të strukturuar të procesit të rehabilitimit të tyre, me qëllim adresimin e traumave të shkaktuara dhe garantimin e zhvillimit të tyre të shëndetshëm;
- ⊙ Rishikimi i vlerës së mbështetjes ekonomike për viktimat e dhunës në familje dhe për të miturit e prekur nga femicidi, si dhe mundësimi i aksesit paralel në

skemat e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje, në rastet kur këto subjekte përbëjnë kategori në nevojë dhe janë të pajisura me urdhër mbrojtjeje ose urdhër mbrojtjeje të menjëhershëm, me synim garantimin e një mbështetjeje reale dhe të qëndrueshme sociale;

- ⊙ Forcimi i mekanizmave për parandalimin e rasteve të vetëvrasjeve si pasojë e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale, përmes zhvillimit të politikave parandaluese, ndërhyrjeve të hershme, monitorimit të rreziqeve dhe rritjes së kapaciteteve institucionale për identifikimin dhe adresimin e këtyre rasteve;
- ⊙ Përfshirja sistematike e rasteve të vetëvrasjes së grave të lidhura me dhunën me bazë gjinore në analizat dhe raportimet institucionale, si dhe trajtimi i tyre si pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda të dhunës, me qëllim garantimin e një kuptimi të plotë të fenomenit dhe orientimin e politikave publike mbi baza të qëndrueshme evidencash;
- ⊙ Rishikimi dhe forcimi i standardeve të koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, me synim trajtimin efektiv dhe të integruar të rasteve të dhunës, si dhe ngritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e shërbimeve të reja mbështetëse dhe programeve rehabilituese;
- ⊙ **Marrja e masave për identifikimin e hershëm dhe adresimin në kohë të problematikave të shëndetit mendor tek autorët e dhunës**, përmes vlerësimeve profesionale të specializuara, ndërhyrjeve të përshtatshme terapeutike dhe mekanizmave të referimit ndërinstitucional, me qëllim uljen e rrezikut të përsëritjes së dhunës dhe forcimin e masave parandaluese;
- ⊙ **Kryerja e vlerësimeve të detajuara psiko-emocionale dhe e vlerësimit të rrezikut për sigurinë e viktimës përpara lirim të autorëve të dhunës nga institucionet e vuajtjes së dënimit**, me qëllim parandalimin e rrezikut të përsëritjes së dhunës dhe garantimin e masave mbrojtëse të nevojshme;
- ⊙ **Vendosja e mekanizmave të monitorimit për një periudhë tranzitore pas përfundimit të dënimit për veprat penale që lidhen me dhunën ndaj grave**, për personat e liruar nga burgu, përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përdorimit të masave mbikëqyrëse të përshtatshme;
- ⊙ **Forcimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të strukturave të policisë, prokurorisë, gjyqësorit, shërbimeve sociale dhe shëndetësore**, përmes trajnimeve të specializuara dhe programeve të vazhdueshme formimi mbi trajtimin e krimeve ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore;
- ⊙ **Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe sfidimi i normave patriarkale dhe stereotipeve gjinore që kontribuojnë në normalizimin e dhunës ndaj grave**, përmes fushatave informuese, edukimit publik dhe angazhimit të komunitetit, me synim parandalimin afatgjatë të kësaj forme dhune.

6.3 Rekomandime specifike

REKOMANDIME PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Rekomandimet e raportit të parë mbi vrasjet e grave dhe vajzave në Shqipëri synonin të kontribuonin në konsolidimin e kuadrit analitik dhe normativ për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke orientuar ndërhyrjet institucionale drejt forcimit të mekanizmave mbrojtës dhe parandalues. Megjithatë, analiza e rasteve të shqyrtuara në kuadër të këtij raporti evidenton se zbatimi praktik i këtyre rekomandimeve mbetet i pjesshëm, veçanërisht në sektorë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në identifikimin dhe menaxhimin e riskut.

Sistemi shëndetësor ka një rol kyç në identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës, dokumentimin e tyre përmes akteve mjekoligjore dhe raporteve të posaçme mjekësore si dhe referimin e rasteve pranë mekanizmave kompetentë ndërinstytucionalë. Gjetjet e raportit tregojnë se ky rol nuk është ushtruar në mënyrë sistematike dhe të unifikuar, duke krijuar boshllëqe në zinxhirin e mbrojtjes dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e riskut për përshkallëzim të dhunës.

Në këtë kuadër, bazuar në problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete, vlerësohet e nevojshme ndërmarrja e masave shtesë dhe plotësuese për forcimin e kapaciteteve institucionale të strukturave shëndetësore. Këto masa duhet të përkthehen në rekomandime të qarta dhe të zbatueshme, të orientuara drejt ndërhyrjes në kohë, standardizimit të praktikave të identifikimit dhe dokumentimit të dhunës, si dhe garantimit të një koordinimi efektiv me institucionet e tjera përgjegjëse. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe menaxhimit të rasteve kur persona me probleme të shëndetit mendor paraqesin rrezik të shtuar për jetën dhe sigurinë e kujdestarëve apo familjarëve të tyre, si më poshtë:

(i) Përforcimi i protokolleve të trajtimit dhe referimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore me vëmendje të veçantë tek rastet kur subjekte janë personat me probleme të shëndetit mendor, dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstytucional, veçanërisht në situatat kur:

- ⊙ konstatohet prania e shenjave fizike që krijojnë dyshime të arsyeshme për ushtrimin e dhunës;
- ⊙ viktimat refuzojnë të japin deklaratime apo të bashkëpunojnë, por ekzistojnë indicie të mjaftueshme profesionale që sugjerojnë se janë subjekt i dhunës;

(ii) Krijimi dhe formalizimi i mekanizmave të komunikimit të drejtpërdrejtë, përmes përcaktimit të pikave të dedikuara të kontaktit ndërmjet qendrave të shëndetit mendor dhe organeve të zbatimit të ligjit, përfshirë Policinë e Shtetit, prokuroritë

dhe gjykatat, në rastet e pacientëve që paraqesin rrezik të lartë. Ky mekanizëm synon mundësimin e ndërhyrjes së shpejtë dhe të koordinuar për garantimin e mbrojtjes së kujdestarëve dhe familjarëve të tjerë, si dhe parandalimin e përshkallëzimit të situatave me rrezik të lartë për jetën dhe sigurinë e tyre.

(iii) Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme dhe periodike për personelin

shëndetësor, me fokus të veçantë tek mjekët e familjes, mjekët e urgjencës dhe psikiatrit, të orientuara drejt:

- ⊙ forcimit të kapaciteteve profesionale për identifikimin e hershëm të viktimave dhe të autorëve potencialë të dhunës;
- ⊙ standardizimit të praktikave për hartimin dhe lëshimin e raporteve mjekësore të posaçme, të vlefshme për përdorim në procedurat gjyqësore dhe administrative;
- ⊙ garantimit të koordinimit efektiv ndërinstytucional për adresimin gjithëpërfshirës të nevojave të rasteve, në funksion të mbrojtjes së viktimës dhe parandalimit të rikthimit të dhunës.

REKOMANDIME PËR POLICINË

Duke ritheksuar nevojën për përsheptimin dhe intensifikimin e masave në zbatim të rekomandimeve të parashtruara në raportin e parë, si dhe duke marrë në konsideratë gjetjet e këtij raporti, rekomandohet avancimi i mëtejshëm i përpjekjeve institucionale, në mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme, në drejtim të:

- ⊙ **Forcimit të reagimit të menjëhershëm dhe profesional** ndaj çdo sinjali apo indicieje për ushtrimin e dhunës, përfshirë ushtrimin e kompetencave ligjore për veprim me iniciativë në rastet që paraqesin nevojë të menjëhershme për masa mbrojtëse;
- ⊙ **Përforcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional** ndërmjet Policisë së Shtetit, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve shëndetësore, me qëllim garantimin e një përgjigjeje të shpejtë, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore;
- ⊙ **Monitorimit sistematik të rasteve me histori të mëparshme dhune**, si dhe trajtimit me vëmendje të shtuar të rasteve ku autorët e dyshuar kanë precedentë kriminalë, në funksion të parandalimit të përshkallëzimit të dhunës;
- ⊙ **Marrjes së masave parandaluese për shmangien e vetëvrasjeve të shkaktuara nga dhuna**, përmes bashkëpunimit të strukturuar me institucionet arsimore, vendore dhe shëndetësore, duke synuar identifikimin e hershëm të faktorëve të riskut dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme;

- ⊙ **Zhvillimit të trajnimeve të specializuara për efektivët e Policisë së Shtetit**, me fokus identifikimin dhe vlerësimin e situatave me rrezik të lartë për vrasje dhe vetëvrasje, si dhe menaxhimin profesional të këtyre rasteve;
- ⊙ **Përmirësimit të sistemeve të mbledhjes, administrimit dhe analizës së të dhënave** për rastet e dhunës me bazë gjinore, me qëllim identifikimin e tendencave, boshllëqeve dhe mangësive në reagimin institucional në veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

REKOMANDIME PËR PROKURORITË DHE GJYKATAT

Në vijim të rekomandimeve të parashtruara në kuadër të raportit të parë, si dhe bazuar në gjetjet e këtij raporti lidhur me rolin e prokurorive dhe gjykatave në trajtimin e çështjeve penale që lidhen me krimet ndaj grave dhe vajzave, rekomandohet ndërmarrja e masave të mëposhtme për:

- ⊙ **Zhvillimin e trajnimeve të specializuara dhe të vazhdueshme për prokurorët dhe gjyqtarët**, me qëllim trajtimin e çështjeve të dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë femicidet dhe rastet e vetëvrasjeve të lidhura me dhunën, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe duke marrë në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me fokus të veçantë në interpretimin e veprave penale në kontekstin gjinor;
- ⊙ **Kryerjen e hetimeve të plota, efektive dhe në afate sa më të shpejta** duke garantuar vlerësimin e historikut të dhunës, analizën e motivit gjinor dhe identifikimin e faktorëve të riskut në secilin rast konkret;
- ⊙ **Hartimin dhe miratimin e udhëzimeve specifike për gjykatat**, mbi trajtimin e krimeve të lidhura me motive gjinore, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore dhe rritjen e cilësisë së vendimmarrjes;
- ⊙ **Monitorimin sistematik të praktikës dhe vendimeve gjyqësore**, si dhe publikimin e analizave periodike mbi tendencat, standardet e zbatuara dhe problematikat e evidentuara në trajtimin e këtyre çështjeve;
- ⊙ **Forcimin e koordinimit ndërinstucional me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera përgjegjëse**, për shkëmbimin efikas dhe në kohë të informacionit, si dhe për kryerjen e analizave gjithëpërfshirëse mbi secilën çështje;
- ⊙ **Prioritizimin e sigurisë dhe mbrojtjes së viktimave gjatë gjithë procesit hetimor dhe gjyqësor**, përmes garantimit të masave mbrojtëse efektive dhe të përshtatura sipas nivelit të riskut;

- ⊙ **Marrjen në konsideratë të nivelit të rrezikshmërisë së autorëve**, si dhe përshtatjen proporcionale të dënimeve ndaj tyre, duke përfshirë, kur është e aplikueshme, detyrimin për ndjekjen e programeve të rehabilitimit dhe trajtimit gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit;
- ⊙ **Zbatimin e masave procedurale që garantojnë dëgjimin e të mbijetuarave dhe familjarëve të tyre në mënyrë të sigurt**, duke parandaluar çdo formë riviktimizimi dhe duke respektuar dinjitetin, integritetin dhe të drejtat e tyre themelore.

REKOMANDIME PËR BASHKITË DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, si dhe duke marrë në konsideratë detyrimet dhe kompetencat që u ngarkohen institucioneve të vetëqeverisjes vendore në parandalimin, trajtimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, rekomandohet vënia në lëvizje dhe forcimi i mekanizmave institucionalë që nxisin:

- ⊙ **Fuqizimin funksional të mekanizmave vendorë të referimit (MKR)**, përmes sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe logjistike, me qëllim garantimin e trajtimit në kohë, të koordinuar dhe të integruar të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- ⊙ **Zgjerimin dhe diversifikimin e shërbimeve psikosociale në nivel vendor**, përfshirë krijimin e ekipeve të lëvizshme multidisiplinare për ndjekjen aktive të rasteve në komunitet, me fokus të veçantë në zonat rurale dhe në familjet me histori të mëparshme dhune;
- ⊙ **Sigurimin e mbështetjes afatgjatë dhe të qëndrueshme për gratë e mbijetuara nga tentativa për vrasje apo plagosje të rënda**, përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve të integruara për strehim, punësim, rehabilitim dhe riintegrim social;
- ⊙ **Ndërhyrjen e menjëhershme dhe të koordinuar në rastet e vetëvrasjeve të lidhura me dhunën**, duke garantuar ofrimin e shërbimeve mbështetëse për familjarët e viktimës, përfshirë ndihmën psikologjike, mbështetjen ekonomike, kujdesin për fëmijët jetimë dhe asistencën ligjore;
- ⊙ **Ndjekjen dhe mbikëqyrjen sistematike të rasteve me histori të mëparshme dhune**, përmes bashkëpunimit të strukturuar dhe të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit dhe institucionet shëndetësore, me qëllim parandalimin e rikthimit të dhunës dhe të përshkallëzimit të saj në vepra penale të rënda;
- ⊙ **Ngritjen dhe zbatimin e skemave mbështetëse për kujdestarët ligjorë dhe familjarët që jetojnë me persona me çrregullime të shëndetit mendor**, në funksion të menaxhimit të riskut, mbrojtjes së sigurisë së tyre dhe parandalimit të situatave me rrezik të lartë.

SHTOJCA

Raste Studimore

Në këtë pjesë të raportit paraqitet një analizë e thelluar e gjashtë rasteve të krimeve të rënda ndaj grave, të cilat përfaqësojnë disa nga ngjarjet më tronditëse të ndodhura në vendin tonë gjatë vitit 2024. Midis këtyre rasteve përfshihen: një rast feminicidi, dy raste të vrasjes së mbetur në tentativë, një rast i plagosjes së rëndë me dashje dhe dy raste të shkaktimit të vetëvrasjes.

Të gjitha rastet kanë si viktimë gra të cilat ishin në marrëdhënie të ngushtë familjare ose intime me autorët.

Përzgjedhja e këtyre rasteve synon të ilustrojë tiparet strukturore dhe dinamikat e dhunës me bazë gjinore si dhe të nxisë reflektim mbi përgjegjësinë institucionale dhe shoqërore në parandalimin e saj.

RAST STUDIMOR 1

“Analizë e rastit të vrasjes së shtetasës SH.I, nga bashkëshorti i saj, krimi që u pasua me goditjen për vdekje të autorit nga i biri”

HYRJE

Në muajin gusht 2024 shtetasja SH.I, u godit disa herë me sëpatë nga bashkëshorti i saj H.I, ku si pasojë e plagëve të marra gjeti vdekjen e menjëhershme. Nga informacioni i marrë në rrugë zyrtare dhe nga shqyrtimi i materialeve të çështjes rezulton se viktimë dhunohej fizikisht dhe psikologjikisht në mënyrë të vazhdueshme nga bashkëshorti i saj⁷⁷. Nuk rezulton që viktimë të kishte raportuar më parë pranë strukturave përgjegjëse në lidhje me dhunën e ushtruar ndaj saj. Ky rast sjell në vëmendje rastet të cilat edhe pse janë nën presion dhe dhunë të vazhdueshme nuk raportojnë dhe nuk kërkojnë mbështetje, duke theksuar nevojën për vënien në lëvizje të mekanizmave të cilët nxisin ndërjegjësimin, identifikimin dhe veprimin me iniciativë të policisë dhe strukturave të tjera përgjegjëse.

TË DHËNA MBI VIKTIMËN

Shtetasja SH.I, e moshës 67 vjeçe, e martuar dhe nënë e tre fëmijëve në moshë madhore, me arsim 4-vjeçar, në pension, nuk rezulton të ketë pasur aftësi të kufizuara të dokumentuara nga organet kompetente. Nga dëshmitë e dhëna gjatë hetimit nga të afërmit e viktimës, rezulton se ajo dhunohej në mënyrë të vazhdueshme nga bashkëshorti i saj.

77. Në shpjegimet e dhëna përpara organeve proceduese, i biri i viktimave ka pohuar se babai i tij e dhunonte në mënyrë të vazhdueshme viktimën, madje ai kishte ushtruar dhunë ndaj saj edhe një ditë përpara vrasjes.

TË DHËNA MBI AUTORIN

H.I, bashkëshorti i viktimës, i moshës 69 vjeç, i pa arsimuar, i pa dënuar më parë, nuk rezulton të ketë pasur aftësi të kufizuara të dokumentuara nga organet kompetente, por nga dëshmitë e të birit përpara organeve proceduese rezulton se kishte shqetësime që lidhen me shëndetin mendor. Ai njihej edhe në komunitet për karakterin e tij të dhunshëm.

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I NGJARJES

Viktima ishte zgjuar herët në mëngjes për t'i përgatitur të birit ushqimin që merrte me vete për në punë. Vetëm disa minuta pas nisjes së të birit për në punë, pas një debati për motive xhelozie, viktima u godit disa herë me sëpatë në trup dhe kokë nga bashkëshorti i saj, si pasojë e goditjeve të marra, ajo humbi jetën disa minuta pas ngjarjes.

Rrethanat që çuan në ngjarje:

- ⊙ Dhunë e vazhdueshme fizike dhe psikologjike e ushtruar nga autori
- ⊙ Karakteri i dhunshëm i autorit dhe mostrajtimi i problematikave që lidheshin me sjelljen agresive të tij
- ⊙ Xhelozia
- ⊙ Mosraportimi i dhunës dhe mungesa e mbështetjes për viktimën

Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj autorit

Çështja është në proces hetimi nga Prokuroria, ku në kushtet kur autori ka humbur jetën menjëherë pas ngjarjes do të kërkohet pushimi i çështjes ndaj tij.

Ndërkohë vijon të jetë në hetim çështja ndaj djalit të tyre për veprën penale “Vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike” parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal kryer ndaj babait të tij (autorit të vrasjes së SH.I).

ANALIZË SOCIALE

Reagimi i shoqërisë:

Ngjarja shkaktoi tronditje të thellë në komunitet, duke nxitur diskutime mbi dhunën në familje dhe nevojën për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave.

Stigma sociale:

Diskutimet mbi ngjarjen shpesh u fokusuan tek “hakmarrja” e të birit për nënën e vrrarë nga i ati, duke mos i kushtuar vëmendjen e nevojshme faktorëve, që ndikuan në krimin e dyfishtë dhe duke shpërfillur nevojën për ndërhyrje institucionale në identifikimin e rasteve dhe parandalimin e përshkallëzimit të dhunës.

Roli i mediave:

Media u fokusua kryesisht tek hakmarrja e të birit ndaj babait duke mos u thelluar në analizimin e historikut të dhunës ndaj viktimës dhe masat që mund të merreshin për parandalimin e ngjarjes.

RAST STUDIMOR II

“Vrasja e mbetur në tentativë e kryer nga babai ndaj të bijës për shkak të mospranimit të zgjidhjes së martesës nga ana e saj”

HYRJE

Në muajin maj 2024 shtetasja R.M, nënë e 2 fëmijëve në moshë të mitur, në proces divorci në momentin e ngjarjes, u godit me armë gjahu nga babai i saj, duke i rrezikuar seriozisht jetën. Nga informacioni i marrë në rrugë zyrtare dhe nga shqyrtimi i materialeve të çështjes rezultojnë se viktima nuk kishte raportuar më parë pranë strukturave përgjegjëse. Bazuar në shpjegimet e dhëna nga dëshmitarët dhe vetë viktima, autori e kreu krimin i shtyrë nga mospranimi i faktit se ajo kishte vendosur të ndahej nga bashkëshorti i saj.

TË DHËNA MBI VIKTIMËN

Shtetasja R.M e moshës 40 vjeçe, me arsim 8-vjeçar, nuk rezultojnë të ketë pasur aftësi të kufizuara të dokumentuara nga organet kompetente. Pas ndarjes faktike nga bashkëshorti dhe fillimit të procedurave për zgjidhjen ligjore të martesës, viktima ishte kthyer të jetonte pranë prindërve të saj, një vendim që nuk ishte mirëpritur nga babai i saj.

TË DHËNA MBI AUTORIN

B.M, baba i viktimës, i moshës 82 vjeç, me arsim 8-vjeçar, nuk rezultojnë të ketë pasur aftësi të kufizuara të dokumentuara nga organet kompetente. Ai njihej si njeri i qetë dhe nuk rezultojnë të ketë qenë i dënuar më parë.

PËRSHKRIMI I NGJARJES

Viktima ishte rikthyer në banesën e prindërve të saj prej një jave pasi kishte vendosur t'i jepte fund martesës me bashkëshortin e saj. Ky fakt ishte kundërshtuar nga babai i saj. Rreth orës 15:30, kur në shtëpi ndodhej vetëm autori dhe viktima, pa shkëmbyer asnjë diskutim të momentit autori kishte qëlluar me armë gjahu viktimën. Goditja u krye në distancë shumë të afërt duke shkaktuar plagë shumë të rënda tek viktima. Pas goditjes së vajzës së tij, autori u vetëvra duke përdorur të njëjtën armë.

Rrethanat që çuan në ngjarje:

- ⊙ Mospranimi i ndarjes së të bijës nga autori.
- ⊙ Mentaliteti patriarkal si faktor nxitës. Ngjarja tregon qartë ndikimin e thellë të mentalitetit tradicional patriarkal, ku zgjedhja e një gruaje për t'u divorcuar dhe për t'u rikthyer në familjen e saj të origjinës shihet si e papranueshme, madje si "turp" për familjen. Reagimi i dhunshëm i autorit ishte i motivuar kryesisht nga ky mentalitet.
- ⊙ Mungesa e ndërjegjësimit për rëndësinë e raportimit të dhunës.
- ⊙ Mungesa e mbështetjes pas divorcit.

Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj autorit

Çështja është në proces hetimi nga Prokuroria, ku në kushtet kur autori ka humbur jetën menjëherë pas ngjarjes do të kërkohet pushimi i çështjes ndaj tij.

ANALIZË SOCIALE**Reagimi i shoqërisë:**

Ngjarja shkaktoi tronditje të thellë në komunitet, duke nxitur diskutime mbi ndikimin e mentalitetit në rastet kur gratë zgjidhin martesën dhe rikthehen në familjen e tyre të origjinës.

Stigma sociale:

Diskutimet mbi ngjarjen shpesh u fokusuan tek ndikimi i mentalitetit sidomos tek të moshuarit, duke mos i kushtuar vëmëdjen e nevojshme faktorëve që ndikuan në krimin e dyfishtë.

Roli i mediave:

- ⊙ Reagimi i medias dhe komunitetit u përqendrua tek ngjarja në aspektin sensacional, ndërkohë që nuk u analizuan shkaqet e thella strukturore dhe sociale që çuan në këtë akt ekstrem.
- ⊙ Media u fokusua kryesisht tek rrethanat në të cilat ndodhi ngjarja duke mos u thelluar në analizimin e faktorëve që mund të kenë kontribuar në kryerjen e krimit dhe nevojën për mbështetje të grave dhe vajzave pas zgjidhjes së martesës.

RAST STUDIMOR III

“Analizë e rastit të vrasjes së mbetur në tentativë ndaj shtetasës E.SH”

HYRJE

Në maj 2024 shtetasi J.SH tentoi të vriste bashkëshorten e tij shtetasen E.SH pas një konflikti për motive xhelozie. Autori u vetëdorzua në polici menjëherë pas ngjarjes. Viktima arriti të mbijetojë nga plagët e marra pas trajtimit të gjatë mjekësor. Për muaj të tërë, viktima u përball me vuajtjet, që vinin nga dëmtimet e pësuar të cilat sollën edhe paaftësinë e pjesshme për punë.

TË DHËNA MBI VIKTIMËN

Shtetasja E.SH, e moshës 48 vjeçe, e martuar dhe nënë e dy fëmijëve, me arsim të mesëm, e punësuar përpara ngjarjes, nuk rezulton të ketë patur aftësi të kufizuara përpara ngjarjes. Nga dëshmitë e dhëna gjatë hetimit nga vetë viktima dhe të afërmit e saj, ndërmjet saj dhe bashkëshortit të saj kishte konflikte të vazhdueshme për shkak të xhelozisë, konflikte të cilat shoqëroheshin me dhunë fizike dhe psikologjike ndaj saj. Bashkia raporton se nga sistemi REVALB nuk rezulton se viktima të ketë qënë më parë e pajisur me UMM/UM.

TË DHËNA MBI AUTORIN

J.SH, bashkëshorti i viktimës, i moshës 52 vjeç, i martuar me dy fëmijë në moshë madhore, me arsim 8-vjeçar, i pa punësuar në kohën e ngjarjes. Nga të dhënat rezulton se autori ishte me precedent të mëparshëm kriminal për vrasje dhe dhunë në familje. Ai njihej për karakterin e tij të dhunshëm.

PËRSHKRIMI I NGJARJES

Ngjarja ndodhi në maj të vitit 2024 rreth orës 02:10 të natës, pas një konflikti të çastit mes palëve për shkaqe xhelozie. Autori e goditi më shumë se 20 herë me thikë viktimën në pjesë të ndryshme të trupit dhe në fytyrë me qëllimin për ti shkaktuar vdekjen, më pas mori në telefon të bijën për t'i treguar çfarë kishte ndodhur. Vajza mbërriti menjëherë në banesë dhe njoftoi ambulancën. Autori u vetëdorzua në polici dhe ndaj tij filloi procedimi penal për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare mbetur në tentativë.

Rrethanat që çuan në ngjarje:

Dhunë fizike dhe psikologjike e ushtruar nga autori në mënyrë të vazhdueshme; Mosmarrja e masave për përandalimin e dhunës nga strukturat përgjegjëse;

Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj autorit

Çështja është hetuar për veprën penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, mbetur në tentative (neni 79/c i Kodit Penal dhe neni 22 i Kodit penal). Pas përfundimit të hetimeve, çështja kaloi për gjykim ku prokuroria kërkoi dënimin e autorit me 35 vite burgim. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë vendosi dënimin e autorit në masën e kërkuar nga prokuroria. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe është në proces shqyrtimi.

ANALIZË SOCIALE

Reagimi i shoqërisë:

Ngjarja shkaktoi tronditje të thellë në komunitet, duke nxitur diskutime mbi dhunën në familje, ashpërsimin e dënimit ndaj autorëve dhe marrjen e masave për rehabilitimin e tyre gjatë qëndrimit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe pas daljes prej tyre.

Stigma sociale:

Diskutimet mbi ngjarjen shpesh u fokusuan te viktimat, duke injoruar faktorët kontribues dhe duke shpërfillur nevojën për mbështetje institucionale.

Roli i mediave:

Media luajti një rol të rëndësishëm mbi hedhjen dritë mbi faktorët që ndikuan në përshkallëzimin e dhunës ndaj viktimës. Informacioni i publikuar në media nxorri në pah edhe pretendimet e viktimës dhe vajzës së saj se ngjarja kishte qënë e paralajmëruar dhe se viktimat kishin kërkuar më parë mbrojtje në polici por ndaj autorit nuk ishte marrë asnjë masë⁷⁸.

78. <https://www.balkanweb.com/u-masakrua-me-thike-nga-bashkeshorti-flet-nga-trauma-edlira-shahu-me-tha-sonte-do-vdesesh-me-terhoqi-zvarre-per-flokesh-donte-te-me-qeronte/#gsc.tab=0>;

RAST STUDIMOR IV

“Analizë e rastit të vetëvrasjes së A.A dhe tre fëmijëve të saj nëpërmjet hedhjes në lumin Buna: Faktorët kontribues dhe pasojat sociale.”

HYRJE

Në maj 2024, shtetasja A.A, u mbyt në lumin Buna bashkë me tre fëmijët e saj të mitur, ishte një ngjarje që tronditi thellësisht opinionin publik shqiptar. Kjo ngjarje përbën një nga ngjarjet më të rënda të kësaj natyre të ndodhura ndonjëherë në vend. Viktima e ndërmori aktin e vetëfljimit duke u mbytur në lumin Buna bashkë me tre fëmijët e saj 9, 8 dhe 3 vjeç. Nga informacioni i marrë në rrugë zyrtare dhe nga shqyrtimi i materialeve të çështjes rezultoi se ngjarja ndodhi pas një periudhe të gjatë stresuese dhe abuzive në familje. Ky rast sjell në vëmendje ndikimin e dhunës në familje dhe faktorëve socialë në vendimet ekstreme, duke theksuar nevojën për ndërhyrje të shpejtë në identifikimin dhe mbështetjen e viktimave të mundshme.

TË DHËNA MBI VIKTIMËN

Shtetasja A.A, e moshës 39 vjeçe, e martuar dhe nënë e tre fëmijëve, e pa arsimuar, e pa punësuar përpara ngjarjes, nuk rezultoi të ketë pasur aftësi të kufizuara të dokumentuara nga organet kompetente. Nga dëshmitë e dhëna gjatë hetimit nga të afërmit e viktimës, rezultoi se ajo vuante nga ankthi dhe depresioni dhe trajtohej me medikamente. Nga të dhënat rezultoi se viktima ishte e njohur për natyrën e saj të qetë dhe tërhequr, ajo angazhohej në rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe në kryerjen e punëve të shtëpisë.

TË DHËNA MBI AUTORIN E SHKAKTIMIT TË VETËVRSJES

E.A, bashkëshorti i viktimës, i moshës 31 vjeç, i martuar dhe me tre fëmijë të mitur, me arsim të mesëm, i pa punësuar në momentin e ngjarjes, i pa dënuar më parë.

PËRSHKRIMI I NGJARJES

Aktivitetet para ngjarjes:

Më 2 maj 2024, pas takimit me kumatën e saj të cilës i tregoi vështërsitë që po kalonte, viktima mori fëmijët dhe u drejtua drejt urës së lumit Buna, duke i thënë kumatës se do të shkonte tek vëllai i saj për t'u qetësuar. Të nesërmen u mësua se viktima, së bashku me tre fëmijët, ishte hedhur në lumin Buna, duke i dhënë fund jetës së saj dhe të fëmijëve. Trupat u gjetën pas dy ditësh nga forcat RENEA.

Rrethanat që çuan në ngjarje:

- ⊙ Ushtrimi i vazhdueshëm i dhunës fizike dhe psikologjike nga ana e autorit ndaj viktimës, i cili krijoi një ambient familjar të pasigurt dhe stresues;
- ⊙ Rëndimi i gjendjes psiko-emocionale dhe marrëdhëniet e acaruar brenda familjes;
- ⊙ Mungesa e mbështetjes sociale dhe familjare për viktimën, duke e lënë atë të izoluar dhe pa rrugëdalje efektive.

Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj autorit

Çështja fillimisht është hetuar për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79/a i KP por pas kryerjes së hetimeve të plota mbi ngjarjen ka rezultuar se kjo akuzë nuk qëndronte pasi viktima e kishte kryer vetë aktin e vetëflijimit bashkë me tre fëmijët e saj të mitur.

Në këto kushte Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër i është drejtuar Gjykatës nëpërmjet kërkesës për gjykimin e çështjes me objekt “shkaktimin e vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i KP ndaj të pandehurit si dhe ka kërkuar pushimin pjesërisht të çështjes, regjistruar për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”.

Në lidhje me veprën penale “Shkaktim i vetëvrasjes” parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, prokuroria arriti të provojë ushtrimin e dhunës psikologjike dhe fizike ndaj viktimës, dhunë e cila kishte ndikuar në rëndimin e gjendjes psikologjike të viktimës duke e shtyrë atë në ndërmarrjen e aktit ekstrem. Pas pranimit të gjykimit të shkurtuar, prokuroria kërkoi dënim prej 6 vjetësh burg, në përfundim Gjykata e Shkallës së Parë e juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e dënoi autorin me 4 vite burgim. Autori e ankimoi vendimin pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e cila vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallë së Parë.

ANALIZË SOCIALE**Reagimi i shoqërisë:**

Ngjarja tronditi thellë opinionin publik dhe nxiti nevojën për reflektim dhe veprim konkret, duke nxitur diskutime mbi dhunën në familje dhe nevojën për mbështetje më të madhe për viktimat.

Stigma sociale:

Diskutimet mbi ngjarjen shpesh u fokusuan te viktima, duke injoruar faktorët kontribues dhe duke shpërfillur nevojën për mbështetje institucionale.

Roli i mediave:

Media luajti një rol të dyfishtë, duke informuar publikun, por edhe duke ushtruar presion mbi organet proceduese në lidhje me kryerjen e hetimeve të plota dhe gjithëpërfshirëse.

RAST STUDIMOR V

Vetëvrasja e një vajze të re pas publikimit të fotove intime në rrjetet sociale

HYRJE

Në prill 2024, S.A, një vajzë e moshës 27 vjeçare, i dha fund jetës së saj duke u hedhur nga tarraca e katit të katërt të banesës ku jetonte sëbashku me familjen e saj, pas publikimit të fotove intime të saj në rrjetet sociale. Viktima kishte një vajzë të moshës 2 vjeçare. Ajo ishte kthyer për të jetuar pranë nënës së saj për shkak të konflikteve dhe mosmarrëveshjeve me bashkëjetuesin e saj. Prej rreth dy javësh përpara ndodhjes së ngjarjes ajo kishte filluar punë si sanitare në shtëpinë e autorit.

TË DHËNA MBI VIKTIMËN

Shtetasja S.A, e moshës 27 vjeçe, me status civil e pa martuar, nënë e një fëmije të mitur, me arsim të mesëm, e punësuar përpara ngjarjes, nuk rezulton të ketë patur aftësi të kufizuara të dokumentuara nga organet kompetente. Sipas të dhënave nga familjarët e viktimës dhe mediat, S.A kishte shfaqur edhe më parë shenja të një gjendjeje të rënduar psikologjike, por nuk kishte marrë ndihmën e nevojshme. Dallohej për natyrën e saj të tërhequr dhe të rezervuar sa i përket ndarjes së problematikave që e shqetësonin.

TË DHËNA MBI AUTORIN E SHKAKTIMIT TË VETËVRSJES

A.Q, i moshës 39 vjeç, person me të cilin dyshohej se viktima kishte krijuar një marrëdhënie intime, ishte i martuar dhe me dy fëmijë, me arsim të mesëm, i pa punësuar në momentin e ngjarjes. i dënuar më parë. Nga të dhënat rezulton se autori është person më aftësi të kufizuara⁷⁹.

PËRSHKRIMI I NGJARJES

Disa ditë para vetëvrasjes, S.A, kishte pasur sjellje të pazakonta, ishte shumë e rënduar emocionalisht dhe nuk shprehej në lidhje me shqetësimin e saj. Më datë 12 shkurt 2024, ajo u vetëvra nëpërmjet hedhjes nga lartësia. Nga të dhënat rezulton se publikimi i fotove intime, mesazhet kërcënuese dhe shantazhi i drejtuar ndaj saj krijuan një presion të rëndë emocional i cili e shtyu të ndërmernte aktin e vetëflijimit.

Rrethanat që çuan në ngjarje:

- ⊙ Dhuna online dhe publikimi i fotove intime në rrjetet sociale

79. Nga të dhënat e policisë rezulton se autori ka problematika të shëndetit mendor të moderuara dhe çrregullime të sjelljes.

- ⊙ Presioni emocional dhe mungesa e mbështetjes
- ⊙ Mungesa e komunikimit dhe mbështetjes në familje
- ⊙ Mosreagimi në kohë i strukturave përgjegjëse

Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj autorit

Çështja është hetuar për veprën penale “Shkaktim i vetëvrasjes”, i parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal dhe “Përndjekje” parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimeve, çështja ka kaluar për gjykim. Gjatë gjykimit të çështjes kanë marrë pjesë trashëgimtarët e viktimës të cilët janë përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur privatisht prej tyre. Çështja vijon të jetë në gjykim

ANALIZË SOCIALE

Reagimi i shoqërisë:

Ngjarja tronditi thellë opinionin publik dhe ngjalli një debat të gjerë mbi ndikimin e rrjeteve sociale në kryerjen e krimeve online dhe nevojën për monitorimin e vazhdueshëm të rrjeteve sociale me qëllim identifikimin në kohë të formave të ndryshme të abuzimit dhe parandalimin e rasteve të tilla.

Ngjarja u pasua nga reagime të shumta në media dhe rrjetet sociale, ku një pjesë e opinionit publik u përqendruan në moralizim dhe jo tek shkaqet dhe pasojat e krimit.

Stigma sociale:

Në rastet kur vajzat vetëvriten pas publikimit të fotove intime në rrjetet sociale, stigma sociale luan një rol thelbësor dhe shpesh tragjik në përshkallëzimin e situatës drejt aktit ekstrem. Shoqëria shpesh e trajton viktimën si fajtores, duke e turpëruar dhe izoluar, në vend që të adresojë dhunën dixhitale dhe abuzimin ndaj saj. Ky stigmatizim përforcohet nga normat patriarkale dhe standardet e dyfishta morale, ku gratë dhe vajzat gjykohen rreptësisht për sjellje që shihen si “të papërshtatshme”, ndërsa autorët e shpërndarjes së materialeve komprometuese shpesh mbeten të pandëshkuar ose minimizohen.

Në raste si ato kur vetëvrasja ndodh pas publikimit të fotove intime, stigma dyfishohet: viktima gjykohet jo vetëm për përmbajtjen e materialeve, por edhe për “dobësinë” që tregoi duke i dhënë fund jetës. Kjo qasje është thellësisht problematike, pasi e vendos përgjegjësinë te viktima në vend që të drejtohet ndaj dhunës, abuzimit, dhe mungesës së mbështetjes që ndikuan në vetëflirimin e viktimës.

Roli i mediave:

Media informoi publikun për ngjarjen, por në disa raste nuk u respektua etika, duke publikuar detaje private dhe duke mos mbrojtur anonimitetin e familjes. Gjithashtu, mungoi theksi në analizën e faktorëve sistemikë që mund të kontribuonin në parandalimin e ngjarjes.

Ky rast përbën një thirrje për reflektim mbi ndikimin e dhunës online tek viktimat, faktorët që çojnë gratë dhe vajzat drejt vendimeve ekstreme, si dhe për nevojën emergjente për ndërhyrje të hershme, mbështetje psiko-sociale dhe edukim mbi shëndetin mendor.

Intervista me të mbijetuarat nga krimet dhe familjarët e viktimave

HYRJE

Në kuadër të këtij raporti, një pjesë thelbësore është zëri i atyre që janë prekur drejtpërdrejt nga krimet, gratë që kanë mbijetuar nga dhuna ekstreme dhe familjarët e viktimave që kanë humbur jetën si pasojë e saj. Intervistat e realizuara synojnë të nxjerrin në dritë përjetimet e tyre personale, sfidat me të cilat janë përballur gjatë kërkimit të drejtësisë dhe reagimin ndërinstitucional në drejtim të mbështetjes së tyre.

Këto dëshmi jo vetëm që japin një pasqyrë më të plotë të realitetit shoqëror dhe ligjor përballë dhunës me bazë gjinore, por gjithashtu tregojnë për boshllëqet sistematike që shpeshherë i lënë viktimat të pambrojtura. Nëpërmjet këtyre zërave, synohet të kuptohet më mirë thellësia e pasojave psikologjike, sociale dhe ligjore që shkaktohen nga këto krime, duke e bërë më urgjente nevojën për veprim të menjëhershëm në drejtim të fuqizimit të mekanizmave mbrojtës dhe mbështetës⁸⁰.

Analizë e Intervistës me të mbijetuarën e kimit E.SH, e cila i mbijetoi tentativës për vrasje nga bashkëshorti i saj- person me precedentë të mëparshëm kriminal

Kodi i rastit: E.SH

Data e intervistës: 13.06.2025

Personi i intervistuar: E mbijetuara e kimit

Kjo intervistë përfaqëson një dëshmi tronditëse të përjetimeve të një gruaje 49-vjeçare, e mbijetuar nga dhuna ekstreme me pasoja të rënda fizike dhe psikologjike.

80. Intervistimi i të mbijetuarave të krimeve apo familjarëve të viktimave ka qenë tepër i vështirë pasi trauma e thellë që ata mbartin i pengon të flasin hapur për përjetimet dhe sfidat e tyre, ndërsa frika, dhimbja dhe mungesa e besimit e bëjnë edhe më të ndërlikuar procesin e ndarjes së kujtimeve. Megjithatë, përpjekjet për të dëgjuar zërat e tyre dhe për të dokumentuar historitë e tyre mbeten thelbësore për të kuptuar plotësisht pasojat e këtyre ngjarjeve.

Analiza më poshtë synon të identifikojë mangësitë sistematike në parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore.

I. KONTEKSTI SOCIAL DHE EKONOMIK I VIKTIMËS

Viktima jeton në Tiranë, është nënë e dy fëmijëve në moshë madhore, aktualisht është në proces divorci. Punon me kohë të pjesshme duke u kujdesur për një fëmijë të mitur, ajo përballet me vështirësi të mëdha ekonomike dhe vështirësi në përballimin e jetesës.

Profili i saj përputhet me atë të shumë grave, të cilat pas dhunës, përballen me papunësi, varfëri dhe mungesë të strehimit të sigurt. Sistemi social nuk ka mekanizma të qendrueshëm për të ofruar mbështetje afatgjatë.

Ajo parashtron se ka aplikuar për shumë vende pune, por sipas saj nuk pranojnë ta punësojnë pasi paragjykohet për shkak të shenjave të dhunës (shenja të ngelura nga plagët në fytyrë dhe qafë).

II. NATYRA DHE HISTORIA E DHUNËS

Viktima është goditur disa herë me thikë në trup dhe kokë nga bashkëshorti, një akt që është vlerësuar nga gjykata si vrasje e mbetur në tentativë⁸¹.

Dhuna kishte qenë e vazhdueshme ndër vite, përfshirë dhunë fizike dhe psikologjike, viktima kishte raportuar më parë në polici dhe autori ishte dënuar me disa muaj burgim, ajo thotë se nuk është marrë asnjë masë nga policia në lidhje me monitorimin e rastit pas daljes së dhunuesit nga burgu.

Viktima pranon se nuk kishte dijeni për shërbimet në dispozicion dhe nuk kishte as besim se do të merrte ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme.

III. SFIDAT PAS NGJARJES

E intervistuar raportoi se ka pësuar dëmtime shumë të rënda si pasojë e dhunës ekstreme. Fillimisht, jeta e saj ka qenë e rrezikuar dhe më pas është përballur me vuajtje të shumta gjatë periudhës së rikuperimit nga plagët fizike. Ajo thekson se edhe aktualisht (rreth 1 vit pas ngjarjes) ka nevojë për fizioterapi, pasi pasojat që kanë lënë plagët kërkojnë kohë dhe trajtim të gjatë terapeutik.

81. Në lidhje me këtë vepër penale autori është dënuar me 30 vite burgim nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Përveç dëmeve fizike, e intervistuar ka përjetuar edhe pasoja të rënda psikologjike, duke theksuar se ka vuajtur shumë dhe vazhdon të ndjejë vështirësi emocionale. Situata e saj sociale dhe ekonomike është e rënduar, ajo jeton me qira dhe të ardhurat e pakta që merr përdoren për pagesën e saj, duke e vënë në vështirësi për mbijetesë.

Sipas saj, gjendja shëndetësore është vlerësuar nga komisioni përkatës, por nuk i është njohur e drejta për përfitimin e pagesës së paaftësisë për punë.

IV. REAGIMI I INSTITUCIONEVE PAS NGJARJES

E mbijetuara raporton se pas ngjarjes policia “bëri punën e saj”, por nuk ka kujtesë të qartë për reagimin fillestar për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore në të cilën ishte.

Ajo deklaroi se ka marrë shërbim mjekësor për një periudhë të gjatë, për shkak të plagëve shumë të rënda në fytyrë, qafë dhe trup. Pas ngjarjes, ajo është pajisur me urdhër mbrojtjeje (UM) dhe ka përfituar ndihmë ekonomike gjatë kohës që UM ka qenë në fuqi.

Ndihma institucionale ishte e kufizuar në ndihmë ekonomike përgjatë afatit të vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes dhe shërbim shëndetësor për rikuperimin nga plagët.

Ndihmë më e qëndrueshme është ofruar nga një organizatë joqeveritare, e cila e ka mbështetur nëpërmjet shërbimit psikologjik, medikamenteve mjekësore dhe pagesës së qerasë për disa muaj⁸².

Ajo apelon për vazhdimësinë e mbështetjes ekonomike dhe shëndetësore, duke theksuar rëndësinë e një ndihme të qëndrueshme për përballimin e situatës së saj.

V. REKOMANDIME NGA VIKTIMA

Viktima thekson nevojën për:

- ⊙ Mbështetje mjekësore dhe psikologjike të vazhdueshme;
- ⊙ Strehim të sigurt;
- ⊙ Ndihmë ekonomike deri në punësim;
- ⊙ Ndihmë ligjore për proceset gjyqësore;
- ⊙ Këshillon gratë të mos tolerojnë dhunën dhe të kërkojnë ndihmë sa më herët.

82. Raportohet se rasti është mbështetur pas ngjarjes nga Qendra “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”.

Kjo intervistë përfaqëson një rast tipik të dështimit të mekanizmave të hershëm të mbrojtjes, mosadresimit të plotë të nevojave nga institucionet pas aktit të dhunës dhe mungesës së strategjive afatgjata për rehabilitim dhe ri-integrim. Viktima përballet sot me pasoja të shumëfishta: fizike, psikologjike, ekonomike dhe sociale.

Rekomandohet që rasti të përdoret si bazë për:

- ⊙ Vënien në lëvizje të mekanizmave që mundësojnë mbështetjen afatgjatë të viktimave;
- ⊙ Ngritjen e një fondi të posaçëm për adresimin e nevojave emergjente dhe afatgjata të të mbijetuarave nga krimet përfshirë mbështetjen e fëmijëve dhe familjarëve të viktimave.

Intervistë me nënën e një vajze të re e cila u vetëvra si pasojë e shantazhit dhe publikimit të fotove intime në rrjetet sociale

Kodi i rastit: D.A

Data e intervistës: 27.08.2025

Vendi i Intervistës: Zyrat e Avokatit të Popullit

Personi i intervistuar: Nëna e viktimës

I. INFORMACION I DHËNË MBI VIKTIMËN NGA E INTERVISTUARA

Viktima ishte e moshës 27 vjeçe, nënë e një fëmijë 2 vjeçar nga një bashkëjetesë, të cilën e kishte ndërprerë prej rreth një viti. Pas largimit nga bashkëjetuesi, me të cilin kishte pasur një marrëdhënie të dhunshme, ajo ishte kthyer të jetonte me familjen së bashku me vajzën e saj të mitur.

Nëna e viktimës raportoi se gjatë shtatzënisë, vajza kishte tentuar të vetëhelmohej për shkak të konflikteve me bashkëjetuesin e saj. Ajo kishte arritur të mbijetonte falë ndërhyrjes intensive spitalore, por pas daljes nga spitali viktima nuk ishte asistuar me ndihmë profesionale të mëtejshme. Më vonë viktima ishte pajisur me urdhër mbrojtjeje (UM) ndaj partnerit për shkak të kërcënimeve që vazhduan pas largimit të saj nga banesa dhe zhvendosjes pranë familjes së origjinës.

II. NGJARJA QË PARAPRIU VETËVRASJEN

Sipas nënës së viktimës, në periudhën para ngjarjes vajza kishte filluar punë si sanitare në një banesë private. Pak ditë pas fillimit të punës, ajo u bë më e tërhequr dhe e mbyllur, gjë që përkon me momentin kur u përball me publikimin në rrjetet

sociale të videove komprometuese të saj. Nëna e saj, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore në atë kohë, nuk kishte arritur të kuptonte plotësisht gjendjen emocionale të vajzës. Ajo konfirmoi se nuk u kërkua ndihmë profesionale dhe vajza nuk ishte në kontakt me institucione të tilla në momentin e ngjarjes.

Familjarët ishin në dijeni për publikimin e pamjeve, por më vonë morën informacion mbi shantazhim apo kërcënimet e drejtpërdrejta që i ishin bërë viktimës nga autori i shpërndarjes së tyre.

III. NDËRHJRJA INSTITUCIONALE

Pas ngjarjes, familja u kontaktua nga strukturat e vetëqeverisjes vendore, por ndihma e ofruar ishte e përkohshme dhe e pamjaftueshme. E intervistuar shprehu bindjen se mungesa e ndërhyrjes së hershme institucionale, mungesa e aksesit në mbështetje psikologjike dhe sociale, si dhe mungesa e reagimit ndaj ekspozimit publik të vajzës kontribuan në përshkallëzimin e situatës dhe përfundimin tragjik.

IV. PASOJAT PSIKOLOGJIKE DHE EKONOMIKE

Ngjarja ka pasur pasoja të rënda psikologjike për familjen. Nëna parashtron se pas ngjarjes gjendja shëndetësore e vajzës së saj më të vogël u rëndua shumë, ndërsa ajo vetë ju nënshtrua një operacioni të vështirë (ndërhyrje në zemër).

Ajo parashtron se nuk ka marrë ndihmë psikologjike për përballimin e traumës. Familja përballet me vështirësi të theksuara ekonomike. Falë ndihmës së të afërmeve dhe ndërmjetësimit me strukturat përgjegjëse, ata kanë arritur të përfitojnë ndihma të kufizuara për përballimin e jetesës.

V. MBËSHTJETJA DHE NDËRHJRJA SIPAS KËNDVËSHTRIMIT TË FAMILJARËVE

Nëna e viktimës sugjeron se institucionet duhet të jenë më të vëmendshme dhe të ndërhyjnë sa më herët në raste të dhunës digjitale. Ajo thekson rëndësinë e edukimit të prindërve dhe familjarëve për të vëzhguar me kujdes sjelljen e fëmijëve, për të kuptuar sinjalet e izolimit apo të ndryshimeve emocionale.

Gjithashtu, apelon për ndërtimin e mekanizmave mbështetës më të fortë për të gratë dhe vajzat, viktimat të abuzimit digjital, përfshirë mbështetje ligjore, psikologjike dhe sociale.

LITERATURA

Referenca Kombëtare

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
4. Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur.
5. Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
6. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
7. Ligji nr. 121, datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.
8. Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Udhëzimi i Përgjithshëm nr.17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje”.
10. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030, dhe Plani i saj i Veprimit.
11. Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.
12. Raporti “Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020)”.
13. Raporti “Vrasjet e grave dhe vajzave (femicidi) në Shqipëri 2021-2023.
14. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit i vitit 2024.
15. Raporti i Avokatit të Popullit “Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri”, viti 2021.
16. Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit viti 2024.
17. Raport i Avokatit të Popullit mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020-shtator 2021.
18. Vrojtim Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri” INSTAT (2018).
19. Raporti i INSTAT-it “Burra dhe gra”, viti 2025.
20. Analizë e performancës vjetore 2024, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Referenca ndërkombëtare

1. Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 1769, datë 9.11.1993.
2. Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me Ligjin nr. 104/2012, datë 8.11.2012.

3. Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, “Krijimi i standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”.
4. Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, 2024.
5. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 35 mbi dhunën me bazë gjinore kundër grave, që përditëson rekomandimin e përgjithshëm nr. 19.
6. Building trust by delivering support, protection and justice (Ndërtimi i besimit përmes ofrimit të mbështetjes, mbrojtjes, dhe drejtësisë), Raporti i parë tematik vlerësues për Shqipërinë, shtator 2024.
7. Analysis of 2021 femicide and attempted femicide cases in Georgia (Analizë e rasteve të femicidit dhe tentativave për femicid në Gjeorgji në vitin 2021), përgatitur nga mbrojtësi publik në Gjeorgji, në kuadër të programit të përbashkët të OKB-së “Për barazi gjinore”, me mbështetjen financiare të Suedisë.
8. Defining and identifying femicide (Përkufizimi dhe identifikimi i femicidit), shqyrtim bibliografik, përgatitur nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), 2021.
9. Raporti i përbashkët të Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe UN Women, “Femicidet në 2024 - vlerësime globale të femicideve nga partnerët intimë dhe anëtarët të familjes”.
10. Raporti i UNODC dhe UN Women “Vrasja e grave dhe vajzave e lidhur me gjininë”, Vlerësime globale në lidhje me vrasjet e grave dhe vajzave nga partnerët intimë dhe anëtarët e familjes, viti 2022.
11. Statistical framework for measuring the gender-related killing of women and girls (also referred to as “femicide/feminicide”) (Kuadri statistikor për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë). Përgatitur nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, miratuar nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara në sesionin e 53-të, 28 shkurt – 2 mars dhe 4 mars 2022.
12. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, viti 2024.
13. Raporti për të drejtat Themelore i Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA).

Praktikë gjyqësore

1. Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
2. Vendime të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
3. Vendime të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

